



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

01 Nr. / Br. 319/22

Nr. Fiq. / Br. sh. - 1 -

Data / Datum 16. 12. 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

J u f t o n

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **29 dhjetor 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 nëntor 2022;
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë;
5. Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020;
6. Shqyrtimi i Draft – rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturave në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtrri;
8. Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt;
9. Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e listës për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023;
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026;
13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës të Komunës së Vushtrri me numër të protokollit Nr.236/20 i datës 26.11.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq Dega në Vushtrri;
14. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
15. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin e vendimit me numër të protokollit Nr.192/22 i datës 28.07.2022, për zhvillimin e projektit me bashkëfinancim;
16. Shqyrtimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023;
17. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR/ZA/TO:	Kuvendin e komunës
NGA/OD/FROM:	Melihate Basholli Latifi <i>Melihate Basholli Latifi</i> Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 14.12.2022

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **14 dhjetor 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të plotësohet me objektivat e synuara dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020.
*Për këtë pikë të rendit të ditës:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të hiqet nga rendi i ditës, në mënyrë që këtë kohë më shumë për ta diskutuar me grupet e interesit – bizneset.*

6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtri.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
9. Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
10. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të përmirësohet titulli i propozim – vendimit si në vijim <Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023 dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
13. Shqyrtimi i kërkesës për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq.
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ta hartojnë propozim – vendimin së bashku me parcelat e identifikuar dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E –IX- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRISË, MBAJTUR MË 24 NËNTOR 2022

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:20. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Faton Hyseni, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Refik Maloku, Gresa Muli, Galip Avdiu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mensur Kasumi, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Sylejman Mehollu, Spasoje Stefanoviq, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Blerina Shala dhe Nasuf Aliu.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallën e kuvendit, ka kuorum të mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit, falënderoj gjithë qytetarët e Vushtrrisë, shtabin emergjent për punën që ka bërë në ballafaqimin me situatën emergjentet nga të reshurat atmosferike që kanë mbretëruar këto ditëve të fundit, ku kësaj komuna i' a ka dal që të sanoj dëmet e konsiderueshme nga vërshimet, që kanë qenë më të mëdhatë në 50 vitet e fundit në Komunën e Vushtrrisë e këto vërshime mbahen mend në kujtesën kolektive në vitin e largët 1979, por edhe ato të vitit 2021. Andaj në këtë rast falënderoj të gjithë operatorët ekonomik lokal të Vushtrrisë të cilët me gjithë kapacitetin dhe makinerinë e tyre ishin në dispozicion, por falënderon edhe qytetarët që ju përmbajtën instruksioneve që i ka parashtruar shtabi emergjent. Më tej shtoi dhe sqaroi se në mbledhjen e kaluar të kuvendit kishte munguar për shkak se ka pasur një takim pune në Ambasadën e Francës, por me sa ka parë ai në atë mbledhje kishte ndodhur një keqkuptim lidhur me një pikë të rendit të ditës. Ai nuk donë të arsyeton epilogun e saj mbledhje, por tërhiqi vërejtjen tek juristët e komunës që të sqarojnë çdo dilemë për çdo pikë të rendit të ditës, fjala është për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, i cili është bërë temë debati dhe ka shkuar edhe më lartë dhe le të sqarohet edhe në institucionet tjera legale. Në rastin konkret nuk ka pasur nevojë të votohet me votë të fshehtë e as të kërkohen 2/3 e anëtarëve të kuvendit. Këto shpjegime ai i argumentoj me fakte propozim-buxheti është aprovuar nga kuvendi dhe bashkë

me buxhet është aprovuar edhe propozimi për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, ku janë ndarë edhe mjetet financiare, në vlerë prej 10,000 €, ndërsa statuti i komunës është aprovuar më vonë pasi që është aprovuar buxheti i komunës, dhe kësaj nuk ka pasur nevojë të bëhet një votim i tillë me 2/3 e anëtarëve të kuvendit. Në rastin konkret ka pasur nevojë të bëhet caktimi i parcelës, tek vendi i quajtur <lama e vacollëve> është ndarë një parcelë dhe ka marr shifër të veçantë dhe kjo është dashur të del në votim dhe të aprovohet me votim me shumicën e thjesht. Pastaj sqaroi se në kuadër të vendimit për aprovimin e buxhetit ku parashihet ndërtimi i këtij lapidarit, komuna ka mundur lirisht të filloj ndërtimin e lapidarit në fjalë, por me që ka dashur të jetë plotësisht transparent para kuvendit dhe qytetarëve, është sjellë në kuvend caktimi i parcelës për ndërtimin e këtij lapidari. Më tej njoftoj se formën për votimin e kësaj pike të rendit të ditës për ndërtim të lapidarit në fshatin Pasomë me votim të thjesht, do ta propozoj edhe sot në këtë seancë të kuvendit, dhe për këtë do ta marr edhe vlerësimin nga ana e Ministrisë të Pushtetit Lokal. Në fund sqaroi se në arsyetimin e këtij propozim-vendimi thuhet se lapidari për Adem Vocen do të ndërtohet në fshatin Pasomë me iniciativën e deputetit Ali Januzi.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të komunës-sqaroi se kuvendi, nuk ka bërë kurrfarë shkelje e as shmangje nga procedurat kur ka vendosur që votimin për lapidarin në fshatin Pasomë për heroin “Adem Voca” dhe atë sipas nenit 17 të statutit të komunës së Vushtrrisë. Ndërsa sa i takon buxhetit për këtë lapidar është e vërtet që mjetet për këtë projekt janë planifikuar në buxhetin e komunës për vitin 2022 ngritja e lapidarit në fshatin Pasomë, por nuk është përcaktuar se në cilën parcelë është planifikuar të ngritet ky lapidar. Andaj aprovimi i këtij vendimi duhet të bëhet sipas nenit 17 pika 11 ku thuhet: vendimi për ngritjen e lapidarëve, shtatoreve, pllakave përkujtimore, merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit të komunës. Votimi në të gjitha rastet bëhet në mënyrë të fshehtë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se sipas nenit 17 të statutit të komunës, me 2/3 e votave aprovohet ngritja-ndërtimi i lapidarëve, por jo edhe caktimi i lokacionit-parcelës, andaj në rastin konkret nuk ka pasur nevojë të shkohet me votim prej 2/3 dhe kësaj të qitet në lajthitje kuvendi. Në vazhdim lexoj para kuvendit, kërkesën e arsyetuar të banorëve të fshatit Pasomë për ngritjen e lapidarit në fshatin Pasomë për heroin <Adem Voca>, ku ceku se në kërkesën e banorëve tekstualisht potencohet vendi se ku do të ndërtohet dhe për këtë si kryetar i komunës ka autorizuar Drejtorinë e Urbanizimit dhe atë të Kadastrit për ti bërë matjet dhe për ti shikuar anën teknike të kësaj çështje. Ndër të tjera në arsyetimin e propozim vendimit ceke se ngritja e këtij lapidari do të bëhet në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m2, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë. Në statutin e komunës është përcaktuar se ndërtimi i lapidareve bëhet me 2/3 e anëtarëve të kuvende dhe kjo është bërë me qëllim që të ndalohet vërshimi i kërkesave për ngritjen e këtyre lapidarëve, ndërsa caktimi i lokacioneve për lapidarët bëhet me votim të thjesht.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të komunës-përsëriti që votimi për caktimin e lokacioneve për lapidarë dhe pllaka përkujtimore bëhet me 2/3 e anëtarëve të kuvendit dhe me votim të fshehtë, ndërsa votimi për ndarjen e buxhetit bëhet me votim të thjesht.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –kërkoj nga kryetari i komunës që mos ta shpërqendroj debatin sepse siç tha ai askush nuk është kundër ndërtimit të lapidarit për patriotin “Adem Voca” sidomos janë të pavërteta lajmet se anëtarët e LDK-së janë kundër atij lapidare, sepse si LDK nuk jemi kundër asnjë lapidare për heronjtë tanë pavarësisht cilave periudha ju takojnë ata. Në këtë rast po debatohet keqpërdorimi i kuvendit, ndërsa kryetari i komunës për një muaj rresht nuk dha asnjë sqarim për ato që kanë ndodhur në mbledhjen e kaluar. Lidhur me këtë çështjen e votimit ne kemi

edhe vlerësimin e dhënë nga zyra ligjore e komunë dhe shtoj se përderisa kryetari i komunës nuk i jep sqarimet e duhura lidhur me atë çështje, kërkoj dorëheqjen e kryesuese së kuvendit dhe mu për këto si LDK lëshojmë seancën e kuvendit në mënyrë demonstrative.

Në vazhdim disa nga anëtarët e grupit kuvendar të LDK-së lëshuan sallën e mbledhje së kuvendit në mënyrë demonstrative.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –kërkoj nga anëtari i kuvendit z.Adnan Lahu, që mos ta keqpërdor foltoren e kuvendit dhe pozitën e tij por edhe devijimin e vullnetit të qytetarëve sepse ai mund të flet vetëm si qytetar sepse atë ditë kur është votuar ajo pikë e rendit të ditës ai nuk ka qëndruar në sallën e kuvendit.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – në adresimin e tij para kuvendit deklaroi: Të dashur qytetarë të Komunës së Vushtrisë, të nderuar mysafir pjesëmarrës të kësaj seance të Kuvendit, Jemi rikthyer sot në këtë sallë të Kuvendit Komunal si institucioni më i lartë i institucioneve lokale bazuar në ligjet e Republikës, i cili është përgjegjës për pushtetin legjislativ lokal, pra, të miratoj statutin e komunës, rregullore, vendime dhe akte të ndryshme juridike me karakter obligativ për punën e komunës të cilat komuna, gjegjësisht kryetari dhe ekzekutivi ka për obligim t'i zbatojë. Po ashtu kuvendi konsiderohet tempulli i demokracisë ku lindin e ballafaqohen idetë dhe mendimet politike lokale, ku pajtohen por edhe ku ndahen mendimet e qëndrimet por që të gjitha në suaza të demokracisë dhe ligjeve në fuqi. Kuvendi është institucioni ku anëtarët përfaqësues politik të popullit marrin pjesë, debatojnë por edhe votojnë për çështje të caktuara sipas bindjes së lirë. Por, saktësisht një muaj më parë këtij institucioni i janë përdhosur këto vlera nga zyrtarët e partisë në pushtet që ushtrojnë pozita publike në ekzekutivin e komunës apo legjislativin e saj. E filluan me shpifje individuale dhe familjare të orkestruara dhe parapërgatitura pa as një argument ndaj asamblistëve të opozitës duke i bërë ato komplet jashtë rendit të ditës për çka debatohej në kundërshtim me rregulloren e punës së kuvendit, dhe nën paaftësinë infantile të kryesueses së Kuvendit për ta menagjuar seancën, situata kulmoj me veprën penale të ushtrimit të ndikimit nga ana e nënkryetarit tek asamblistët e partisë në pushtet të cilët bashkë më kryesuesen dhe para syve të saj në bashkëpjesëmarrje bënë veprën penale të votimit, për asamblistët që nuk ishin prezent në sallën e kuvendit. Këtu morri fund demokracia dhe u vendos autokracia. Autokracia vazhdojë me veprat penale të radhës edhe pas seance, duke fshirë pjesën e dytë të video seancës së kuvendit nga faqja e komunës, duke provuar të humbin gjurmët e veprës penale. Të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrisë me këto veprime të përfshirët në këtë akt, jo vetëm që e kanë shkelur ligjin dhe bartni përgjegjësi, por e kanë pashtruar edhe Kuvendin Komunal, vlerat e demokracisë, por edhe heroin dhe dëshmorin Adem Voca dhe familjen e ti, për të cilin kuvendi do duhej të votonte atë ditë me krenari dhe unanimitet, por ja që kështu nuk menduan edhe bashkëpartiakët e kryetarit të cilët nderimin për dëshmorët e kanë vetëm për vota në kohë fushate dhe për poena politik. Çka ndodhi tutje, të dashur qytetarë?! MAPL që mbikëqyr ligjshmërinë e vendimeve të kuvendit ka shpallur vendimin e paligjshëm duke konfirmuar zyrtarisht se është votuar për persona që nuk ishin prezent, kurse prokuroria e shtetit nga ajo çfarë kemi parë nga mediat ka urdhëruar policinë e Kosovës për fillimin e hetimeve për këtë rast. I vetmi person që ka përgjegjësin më të lartë politike në këtë komunë dhe nuk pati guximin politik as autoritativ ta thotë një fjalë të vetme, së paku një fjalë, është ky, kryetari i komunës Ferit Idrizi. Ky i cili në këtë rast e ka të përfshirë hiq më pak se vartësin kryesor, nënkryetarin e komunës të cilin e emëron vet. Ky është ai kryetari i 99 fijeve të telave të ndryshkur të demokracisë, që demokracinë po provon ta shndërroj në autokraci, duke i

lidhur telat me lidhje të shkurtër. Ky që për këtë situatë nuk kërkon falje publike, ky që nuk ndjen keqardhje, ky që nuk distancohet dhe nuk ndërmer veprime, ky që jo vetëm që nuk e thotë as edhe një fjalë, por nesër provon të përformoj në rolin e aktorit që luan viktimën, njeriun e mire dhe të pafajshmin! Por jo, ne do të jemi këtu për të ja prishur shfaqjen dhe për t' ja kujtuar gjërat edhe kur provon t'i heshtë, edhe kur provon t'i lë në harresë. Por jo ne këto gjëra nuk do ti harrojmë as nuk do ti lëmë të parashkruhen. E nderuar kryesuese ju tashmë e keni humbur jo vetëm respektin por edhe autoritetin mbi drejtimin e kuvendit. Ne nuk i kemi numrat për të ju dhënë atë çfarë meritoni, por shpresojmë që atë do ju jep ligji, kurse ne nuk do të qëndrojmë në këtë sallë ku shkelen ligjet, e rregulloret, ku kryhen vepra penale para syve tuaj dhe ju nuk provoni as t'i ndaloni. Thjeshtë një kryesuese si ti nuk mund të na përfaqëson dhe ofron kushte të punës për normalitet në këtë kuvend. Mirupafshim në rrethana të tjera.

Në vazhdim disa nga anëtarët e grupit kuvendar të LVV-së lëshuan sallën e mbledhje së kuvendit në mënyrë demonstrative

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –deklaroj se në cilësinë e kryesueses së kuvendit i ka respektuar të gjitha procedurat sipas ligjeve në fuqi, ku në rastin konkret për votimin e atij lapidari kishte themeluar komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit ku njëri nga anëtarët ishte edhe ai nga radhët e subjektet politik Lëvizja Vetëvendosje i cili ka qenë i detyruar ta kryej punën e tij.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-vlerësoi se nuk ka dëshirë të shohë kesi sekuencash në mbledhjet e kuvendit, dhe shtoj se këta që e lëshuan mbledhjen, që thirren në interesin qytetar e që e kanë gojën plotë demokraci, gjatë ditëve të vërshimeve, ku ishte gjendje e rënd për qytetaret opozita nuk ka ofruar asnjë lloj bashkëpunimi duke mos bërë të paktën një telefonatë për ditur se si është gjendja. Këta nuk janë që i mbrojnë interesin qytetar, dhe shtoi se anëtari i kuvendit z. Shkelzen Xhaferi përmes faqes portalit të tij Vupol, propagandon me fotot e kryetarit të komunës në teren, i cili në cilësinë e kryetarit të shtabit emergjent bënë përpjekje për të sanuar gjendjen e vërshimeve dhe mënjanimin e dëmeve, ndërsa bënë epitete fyese për kryetarin e komunës, kurse shefi i tij partiak kryetari i LDK-së, bënë thirrej fansave në facebook për ta mbështetur atë portal, ai u zotua se do të ta demaskoj atë portal, por edhe hilet që po i bënë edhe përmes prokurorisë. Pastaj shtoi shefi i grupit kuvendar të LDK-së i cili ka përfituar pronë dhe është njëri që përflitet, tani del dhe moralizon kjo kështu nuk shkon. Në vazhdim shtoj asnjëri nga shefat e grupeve kuvendare nuk ka treguar bashkëpunim, e vetmja që ka dalë në teren për ta vëzhguar gjendje ka qenë deputetja e Kuvendit të Kosovës znj. Rrezarta Krasniqi. Më tej duke ju referuar shefit të grupit kuvendar të LVV-së z. Sylejman Mehulli, shtoi se ai nuk mund të flet për dëshmoret sepse siç deklaroi ai ka dëshmorë nga familja e tij por asnjëherë nuk ka përfituar në emër ti tyre. Në fund tha se kësaj çështje do ti shkohet deri në fund, por nëse del se ka pasur gabime ata duhet të japin përgjegjësi juridike.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se në mbledhjen e kaluar të kuvendit, pjesëmarrës ishte edhe ai vet dhe në një formë ka qenë i implikuar në atë situatë, dhe pavarësisht të gjitha këtyre zhvillimeve, tashëm kjo lëndë ndodhet në instancat tjera, por për këtë çështje është ngritur edhe një kallëzim penal, për të cilin ai personalisht është krenar. Ti bësh dikujt kallëzim penal për ngritjen e një lapidari për një dëshmorë, nga dy njerëz që e kanë dëmtuar më së shumti këtë institucion në katër vitet e fundit, për të është nder dhe krenari. Në vazhdim ai lexoj një mesazh që ka dalë nga grupet dhe zyrtaret e LDK-së ku thuhet se: po ju njoftojmë se në emër degës së LDK-së në Vushtri, kemi ushtruar kallëzim penal, ndaj zyrtarëve të lartë të Komunës së Vushtrrisë në

Prokurorinë Speciale për keqpërdorimin dhe shkatërrim të pronës komunale. Andaj këta mendojnë se me lapidar shkatërrohet prona komunale dhe kjo është fatkeqësi, këta nuk e kanë qëllimin këtu, por këta e dinë që janë të inkriminuar dhe se kohëve të fundit kanë filluar denoncimet përmes kallëzimeve penale, sepse siç thotë populli këtyre ”iu është sosur bishti”. Pastaj shtoj se i vjen keq që disa anëtarë të kuvendit po bien pre e disa provokimeve e që nuk kanë qenë pjesë e këtyre gjireve. Shefi i grupit kuvendar të LVV-së, ka keqpërdor imagjinon nga 45 €, dhe kur këtë e ka bërë çfarë është në gjendej të bëj në rastet tjera. Fatkeqësia tjetër është që LDK-në si njëri nga subjektet më të vjetra në Kosovës ta përfaqësoj një njëri i cili ka keqpërdor detyrën zyrtare skajshmërisht në katër vitet e fundit, ku i kanë dhënë 17 hektar tokë në mënyrën më të keqe të mundshme, prokuroria dhe hetuesia as që janë marr me atë lëndë, lëndën e kanë marr në duart e tyre por nuk kanë vepruar, dhe mund ta shikoni veprimin e ish-kryetarit të komunës se si i bën me dorë anëtarit të kuvendit, dhe ushtron ndikim për përfitim personal-material, ndërsa vlera apo dëmi për ngritjen e lapidarit ka qenë zero. Në nenit 17 paragrafi 6 të statutit të komunës thuhet: Kuvendi i Komunës merr vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarëve, shtatoreve dhe pllakave përkujtimore, lidhur me këtë pyeti zyrtarin e zyrës ligjore se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si merren vendimet, dhe shtoj se ky ligj përcakton se vendimet e kuvendit merren me shumicën e anëtarëve që votojnë, dhe në rastin konkret kemi pasur caktim të lokacionit nuk kemi pasur vendim për ndërtim ose ngritje të lapidarit sepse ky vendim është marr në kuadër të vendimit për miratimin e buxhetit të komunës për vitin 2022 pjesë e të cilit ka qenë edhe ndërtimi i lapidarit për patriotin <Adem Voca>. Më tej duke ju adresuar zyrës ligjore dhe udhëheqësit të saj, shtoi se në të kaluarën kur partia e tij ishte në pushtet në komunë, ky zyrtarë asnjëherë nuk kishte ngritur zërin për shkeljet që kanë ndodhur nga ish qeverisja dhe nuk kishte dërguar asnjë shkresë në organet e drejtësisë, lidhur me dëmtimin-shkatërrimin e pronës komunale që kishte ndodhur në Parkun Industrial në Lumadh nga ish kryetari i komunës së Vushtrrisë. Pastaj përsëriti se ish kryetari i komunës së Vushtrrisë ka shpërndarë në kularët edhe grupet e LDK-së mesazhe propagandistike për gjoja shkatërrim të pronës komunale, nga zyrtarët udhëheqës të komunës, e që në realitet vetë Xhafer Tahiri është i inkriminuar në shkatërrimin e pronës komunale. Tutje shtoi se grupi kuvendar i LDK-së është dal nga salla e kuvend sepse nuk kanë guxim të ballafaqohen dhe potenco i ish-drejtori i LDK-së Shkelzen Xhaferi duhet të tregoj se si e ka bërë pagesën e ushqimit në fushatë zgjedhore në vlerë prej 2000 €, dhe sa kompani i ka thirr pas fushatës për ti marr mjete financiare, ndërsa shefi i grupit kuvendar i LDK-së ka nënshkrua marrëveshje interne për 1 hektarë e 20 ari pronë. Lidhur me veprimet e tij në mbledhjen e fundit të kuvendit që ka të bëj me lapidarin e Adem Voces, deklaroi se ai e ka bërë atë veprim dhe ka bërë për interes të përgjithshëm dhe pa asnjë kundërvlerë për nderimin e heroit Adem Voca, dhe nëse në veprimet e tij ka përgjegjësi ai është i gatshëm të bartë vet atë. Më tej deklaroi se është ndaluar politika dhe veprimet siç ai i quajti të xheparoshëve dhe politika e korrupsioni nga ish qeverisja është prerë-këputur. Qeveria e Ferit Idrizi është e qartë dhe e pastër si kokrra e lotit, nuk ka më politikanë të korruptuar në komunë dhe ceku se asgjë nuk e frikëson nga askush, sepse është i pastër në tërësi, lidhur me keqpërdorimet nga ish qeverisja e kaluar paralajmëroj se ka përgatitur kallëzim penale dhe të njëjtin do ta dërgoj në prokurori. E kanë dëmtuar buxhetin për 170,000.00 € duke i punësuar 150 persona me qëllim që të rritet portali i tyre vupol. Në fund tha dhe u zotua se nuk do të zbrapset deri në fund dhe do ti ndjek deri në fund ata që kanë keqpërdor nga ish qeverisja komunale, do ti demaskoj të gjitha këto portale që po shpifin dhe po propagandoj me qëllë të etiketimit që po tentohet tu bëhet bartësve kryesor të komunës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit – konstatohet se në sallën e kuvendit në momenti që po diskutohej ishin 18 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrë vendime të plotfuqishëm.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore të komunës-tha se asnjëherë nuk e ka përzier punën e tij profesionale me partinë politike, dhe shtoi se në momentin që është ngritur dyshimi nga Drejtoria e Kadastrit për kontrata të dëmshëm ai ka vlerësuar dhe ka tërhequr vëmendjen për parandalimin e zbatimit të kontratave të dëmshme për komunën. Lidhur me votimin e vendimit për caktimin e lokacionit për lapidarin e patriotit Adem Voca, përsëriti se votimi duhet të bëhet me 2/3 konform statutit të komunës i cili ka marrë aprovimin nga ana e MAPL-së, e të cilin jemi të obliguar ta zbatojmë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –tha se nuk ishte e nevojshme që grupi kuvendar i LDK-së dhe LVV-së disa nga anëtarët e tyre ta lëshojnë mbledhjen. Pastaj vlerësoi se kur është interesi i përgjithshëm, duhet ti ulim flamujt partiak dhe të rreshtohemi në të mirën e përgjithshme. Ai shtoi se çështja e këtij lapidari për patriotin Adem Voca, është bërë problem pa pasur kurrfarë nevojë, dhe kjo po bëhet në mënyrë të mbrapshtë, sepse në atë pronë nuk ka kurrfarë kontesti, dhe potencoi se për figurën e Adem Vocës, duhet të flasim historianet dhe Akademia e Shkencave. Në vazhdim ai parashtrij para kuvendit një historik të shkurtër dhe të lavdishëm për figurën e Adem Vocës, si një patriot i vërtet, dhe vlerësoi se është e turpshme që dikush po tenton të njollosojë njerëz në emër të veprës së këtij heroi. Tutej vlerësoi se dyshon që dikush nga Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të gjelozisë pse ai e ka propozuar ndërtimin e këtij lapidari po tenton që në formë të ndryshme ta pengojë këtë proces. Në vazhdim ai paraqiti duke lexuar një kërkesë të komandanti Gani Lahu, për financimin e një libri “Rrezet e Lirisë” për luftën e UÇK-së, e që kërkojë që kjo kërkesë të futet në rendit të ditës dhe të aprovohet, vlera e kërkesës është 7500 €. Në vazhdim ai paraqiti para kuvendit një ekspozitë të librit, që lidhet me luftën e UÇK-së në ZOSH të Shalës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit – njoftoi se kanë para vetës kërkesën e z.Gani Lahut të njëjtën e kanë shqyrtuar bashkërisht me kryetarin e komunës, dhe janë dakord që mbështetet kjo kërkesë por duhet të gjendet modaliteti i duhur ligjor.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e DKRS-së-njoftoi se e kanë shqyrtuar kërkesën në fjalë, dhe mendon se në vitin e ardhshëm ta realizojnë këtë kërkesë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se ndjenë keqardhje që grupet kuvendar LDK e LVV, pjesa dërmuese e tyre lëshuan seancën, sepse siç deklaroi kemi nevojë për debat të brendshëm, sepse duhet ta analizojmë punën e kuvendit në përgjithësi respektin ndaj këtij institucioni dhe kryerjen e obligimeve individuale të secilit nga ne, betimin që kemi dhënë për të ruajtur nivelin institucional dhe ligjor në shërbim të qytetarëve. Menaxhimi i drejtimi i kuvendit, respektimi i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, statutit të komunës dhe rregullores së punës të kuvendit si dhe akteve tjera ligjore në veçanti nga kryesuesja e kuvendit e cila është e thirrur ligjërisht që të sigurojë në çdo rast dhe në secilën mbledhje të kuvendit kushte për zhvillimin normal dhe të pa penguar të punimeve të kuvendit dhe konform e njëjta mundet dhe ka obligim ligjor të ndërmarë veprime konkrete në sigurimin e kushteve optimale për punën e papenguar të kuvendit. Në këtë drejtim secili deputet ka obligim t'i respektojë këto rregulla dhe forma ligjore. Mendon se Vushtrria në përgjithësi ka një traditë të mirë të punës në kuvendin e komunës, ka traditën e respektit të ndërsjellët pozitiv/opozitë, ka traditën e kulturës institucionale, madje mendon se kuvendit paraqet një *retrovizor* të demokracisë lokale. Çka në të vërtetë po tentohet të kultivohet në këtë kuvend, a duhet dhe a mundet të menaxhohet, nga kush dhe si duhet të menaxhohet gjithnjë duke respektuar obligimet dhe përgjegjësitë ligjore për secilin nga ne. Duhet të dimë dhe të kuptojmë se seancat e kuvendit janë aspekti më i rëndësishëm i jetë politike kuvendare lokale, shumica nga ne kemi qenë apo jemi

anëtarë të komiteve obligative dhe në komisione të ndryshme, ku hartohen politikat e qeverisjes komunale, diskutohen dokumentet e rëndësishme, hartohet buxheti, aprovohet statuti, rregulloret por edhe aktet tjera, propozohen pika të ndryshme por vetëm seanca e kuvendit ka fuqinë ligjore për miratim ose jo të këtyre pikave propozimeve apo akteve tjera. Andaj përgjegjësia e secilit prej neve është e madhe e nganjëherë edhe sfiduese, vetëm institucioni i seancës shpreh legjitimitetin dhe solemnitetin dhe mesazhin politikë. Deputetët e përdorin foltoren e kuvendit për të shpërfaqur bindjet, aftësitë dhe kreativitetin karshi vijës së qytetarëve, për parimet që mbrojnë dhe për të respektuar kontratën me zgjedhësit, por sa shfrytëzohet ky instrument në të mirën qytetare ai ka pasur rastin të evidentojë e vërej modele shumë pozitive të punës në këtë kuvend gjatë këtij mandati por edhe modele negative. Megjithatë rasti i fundit në zhvillimet në seancën e fundit të kuvendit thotë dhe e pranon se është një alarm dhe në kufijtë e skandalit por edhe domethënës për demokracinë dhe cilësinë e jetës kuvendare të Vushtrrisë. Në këtë rast ka vërejtur një disponim negativ të subjekteve politike opozitare, lidhur me procesin e votimit për lapidarin në fshatin Pasomë LDK e LVV, e sidomos Lidhja Demokratike, që përmes portaleve që mbajnë linja private e partiake të tyre, kanë lansuar lajmin kinse në kuvendin e Komunës së Vushtrris ka ndodhur skandal, pa e deshifruar drejt se kjo akuzë e pabazë e pa faktuar drejt i drejtohet familjes ku bëjnë pjesë edhe ata vetë i drejtohen shtëpisë së përbashkët që kemi e ajo quhet Kuvendi i Komunës Vushtrri. Ai ndan bindjen dhe mendimin se nuk i ka bërë nder as vetës e as subjektit të vetë kjo qasje sepse propozimi ka qenë për ngritjen e lapidarit për patriotin “Adem Voca” historinë e lavdishme të të cilit e ka prezantuar para kuvendit deputetit i nderuar Ali Januzi. Puna e kuvendit të komunës monitorohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, por puna e kuvendit mbikëqyret edhe përmes transmetimit direkt në faqen zyrtare të komunës. Votimin e pikave të rendit të ditës morën pjesë disa deputet, por pamjet zyrtare nga seanca tregojnë se votimi mbetet akt formal dhe institucioni i seancës edhe më formal dhe kjo nuk është ajo që e dëshirojmë dhe nuk duhet të përsëritet. Në fund tha se meqë pjesa më e madhe e anëtarëve të kuvendit nga partitë opozitare lëshuan mbledhjen, propozoi që të merret një pauzë prej pesë minutash për konsultim se a duhet të vazhdojë kjo mbledhje e kuvendit apo jo, pasi që duhet të jenë edhe deputetët e opozitës për ballafaqim në kuvend sepse kemi edhe një kallëzim penal ndaj zyrtarëve të lartë udhëheqës të komunës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –vlerësoi se pasi që kemi kuorum të mjaftueshme mund të vazhdojë mbledhja e kuvendit.

Faton Hyseni, anëtari i kuvendit-tha se pas që kemi kuorum mund të vazhdojë mbledhja, ndërsa opozita ka të drejtë të bëjë veprimet politike për të cilat mendon se janë të duhura.

Behar Duraku, anëtari i kuvendit-tha se është i papranueshëm fakti se me çfarë gjërash tek ne bëhet politike, ku disa nga anëtarët e kuvendit nga LDK dhe LVV lëshuan mbledhjen, për një pikë që është shumë fisnike dhe kjo është e nonsens dhe e papranueshme. Andaj para qytetarëve sqaroi se grupi i anëtarëve të LDK-së që po qëndron në sallë, ishin të njëjti që votuan seancën e kaluar për aprovimin e vendimit për lapidarin e patriotit “Adem Voca”, dhe ata që tani dolën jashtë, ata ishin jashtë edhe kur u votua për lapidarin. Prandaj ta bësh politikën kur e dëmton interesin e qytetarit kjo është e papranueshme. Veprim politik kundër interesit qytetar është devijim i vullnetit të zgjedhësve dhe anashkalim i interesit të përgjithshëm.

Bekim Zabërgja, anëtari i kuvendit-përsëriti çështjen e rivotimi për vendimin për parkun industrial në fshatin Lumadh, pasi siç ka konstatuar edhe komisioni për këtë çështje janë gjetur një mori shkeljesh të legjislacionit në fuqi që i referohen kësaj fushe. Për këtë problematik kemi pasur edhe opinionet e zyrës ligjore të komunës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Po ashtu kemi pasur edhe raportin e komisionit të ngritur për çështjen e zonës ekonomike që ka konstatuar një mori

shkeljesh në procesin e kontratave dhe dhënies të pronës në shfrytëzim. Pastaj ai potencoi pikat e vendimit që ishin dakorduar të gjithë anëtarët e kuvendit që për çështjen e parkut industrial t'i drejtohem MAPL-së e po ashtu të kjo çështje të orientohet në organet e drejtësisë. Opinioni i Agjencisë Kundër Korrupsion kërkon që bëhet rishqyrtimi, revokimi apo shfuqizimi i vendimit të kuvendit të komunës për parkun industrial në Lumadh. Andaj kërkoj sqarime nga kryetari i komunës dhe nga kryesuesja e kuvendit se përse nuk e kanë sjellë në rend të ditës propozimin për shfuqizimin e vendimit nr,81/21 për parkun industrial në Lumadh.

Agron Përçuku, anëtari i kuvendit-tha se një grup i anëtarëve të grupit të LDK-së janë prezent në mbledhje dhe do të jenë sa herë që e kërkon interesi qytetar. Mandej shtoi se është shqetësues deklarimi i shefit të grupit kuvendar të LDK-së Adnan Lahu i cili thotë se kishte marr pjesë në votimin e lapidarit Adem Voca, edhe pse ai atë ditë ka ikur nga seanca e edhe tani iku nga mbledhja. Atë ditë janë dal nga mbledhja edhe disa anëtarëve LDK-së me qëllim të dështimit të atij procesi. Tutje shtoj se është shetuese paraqitja problematike e Adnan Lahut në këtë mbledhje, dhe shtoj se ai nuk e përfaqëson në tërësi LDK, ai përfaqëson një grup të ngushtë në LDK për interesat e tij personale. Edhe më shqetësuese është fakti që disa portale të rrejshme të afërt me disa individ brenda LDK-së që po tentojnë të degradojnë zyrtar publik në komunë, jo vetëm të qeveris komunale por edhe të disa përfaqësuesve të qytetarëve në kuvend. Nga foltorja e kuvendit bërë thirrje që kuvend të nxjerr një deklaratë që të i'u bëj thirrje organeve të hetuesisë që të hetohen të gjitha portalet e rrejshme dhe faqet që janë të hapura në rrjetet sociale sidomos në facebook, e që përmes tyre po tentojnë të degradojnë përfaqësuesit e zgjedhur nga populli.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” (sa edhe janë të pranishëm në sallën e mbledhjes) aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 tetor 2022;
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;
4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë;
5. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me aktivitetet për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i kërkesës së Klubit të Hendbollit “Vushtrria” (femrat) për përkrahje financiare;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Planit të Punën të Kuvendit për vitin 2023;
10. Shqyrtimi i Deklaratës të kuvendit për thirrje organeve të hetuesisë që të hetojnë disa portale dhe faqe të rreme në rrjetet sociale;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;
12. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 tetor 2022;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 tetor 2022.

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e Raportit të Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë;

Katarina Palushi, përfaqësuese e UN-HABITATIT-paraqiti sqarime hyrëse të përgjithshme lidhur me Raportin e Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) të Komunës së Vushtrrisë.

Pas prezantimi dhe shqyrtimit të këtij raporti, kuvendit pas votimit me 19 vota “për” sa janë të pranishëm në sallën e mbledhje u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.

2. Qëllimi i miratimit të këtij raporti është qasje në agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara, për të mundësuar lokalizimin e objektivave që lidhen me zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunës së Vushtrrisë.

3. Ndër objektivat kryesore të agjendës 2023 të lokalizuara e që mëton t'i zbatojë Komuna e Vushtrrisë janë: zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj; fund-urisë; arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i të ushqyerit; promovimi i bujqësisë së qëndrueshme; sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë, në të gjitha moshat; sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë; të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat; nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme; punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë; si dhe sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Vlerësimit Vullnetar Lokal (VVL) i Komunës së Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij raporti obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit të performancës dhe grantit të bazuar në performancë për vitin 2021;

Islam Latifi, zyrtar në DSHP- duke ju adresuar anëtarëve të kuvendit parqiti një ekspozitë lidhur me raportin e performancës ku dekaltoi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bashkëpunim me komunat dhe donatorët, kanë përmbyllur procesin e vlerësimit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës dhe Grantit të Performancës, sipas performancës së komunave dhe kanë publikuar raportin për vitin 2021. Ky raport përmban sistemin i cili ka 19 fusha dhe 119 tregues dhe Grantin e Performancës i cili bazohet në 28 tregues. Raportimi i të dhënave dhe vlerësimi i tyre për herë të dytë u realizua përmes Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në këtë sistem kishin qasje të gjithë zyrtarët raportues të komunave, koordinatorët e performancës, kryetarët e komunave dhe zyrtarët vlerësues të Ministrisë. Krahas raportimit, sistemi ofroi mundësinë e bashkëngjijtes së dokumenteve referuese për të dhënat e raportuara, me qëllim të dokumentimit të të dhënave, si dhe një proces komunikimi në mes të komunave dhe Ministrisë, duke lënë gjurmë në secilën fazë të vlerësimit të të dhënave. Të dhënat e ofruara shërbejnë për të parë trendet e zhvillimit të komunave nga viti në vit, në mënyrë që prioritetet vijuese të shtrihen në mbështetje të sektorëve më pak të organizuar. Veç kësaj, rezultatet e raportit shërbejnë si mjet vetëkontrolli për punën e administratës komunale, për të rritur kapacitetet dhe për të reflektuar në përgjegjshmërinë e zyrtarëve publik. Për më tepër, raporti informon qytetarët për pritjet e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve nga institucionet dhe të zgjedhurit e tyre lokal. Raporti nxjerrë përfundimet e përgjithshme për shkallën e të arriturave të komunave dhe jep rekomandimet përkatëse për përmirësimin e shërbimeve në bazë të rregullave juridike në fuqi apo standardeve të kërkuara qeverisëse. Komuna e Vushtrrisë nuk është kualifikuar për grant të performancës për shkak të mospërbushjes së tri kritereve nga 4 kritere minimale të përcaktuara në Rregullat e Grantit për Performancë. Kriteret që nuk janë plotësuar janë; ligjshmëria e vendimeve të kuvendit, shkalla e ultë e shpenzimit të buxhetit të investimit kapitale e cila nuk e arrin vlerën apo kriterin e përcaktuar prej 75% dhe raporti i auditorit i kualifikuar. Shkalla e shpenzimit të buxhetit të investimit kapitale për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020 është vlerësuar 68%. Pra raporti që e keni para jush përveç përshkrimit të qëllimit të këtij sistemi, përmban në vete edhe informatat për trendet e performancës së Komunës së Vushtrrisë ndër vite, konkluzione për arritjet më të larta dhe më të ulta, si dhe rekomandimet se ku duhet të kemi përkushtim më të madh për rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Në bazë të analizave të përgjithshme dhe specifike, si dhe gjetjeve nga ky hulumtim, Komunës së Vushtrrisë i rekomandohet që të punojë me përkushtim më të madh në këto aspekte:

- Sa më shumë përfshirje të punësuarve me aftësi të kufizuara, si dhe sipas përkatësisë gjinore, në institucionet komunale;
- Rritjen e sipërfaqeve të shesheve publike dhe hapësirave të gjelbra në m² për kokë banori;
- Rritja e % së vendbanimeve për furnizim me ujë të pijshëm;
- Ligjshmëria e kontratave për shërbime të veçanta;
- Rritjen e % të vendbanimeve me trajtim të ujërave të zeza;
- Rregullimi i numrit të popullatës e cila përfiton nga skema sociale.
- Hartimi i Planit Lokal për Veprim në Mjedis,
- Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal,
- Diskutimi në kuvend i Raportit të auditorit të brendshëm,

- Përmbushja e standardeve minimale të konsultimeve publike, si dëgjimet për KAB dhe buxhet komunal
- Miratimi me kohë i buxhetit vjetor,
- Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit,
- Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim,
- Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme).

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me aktivitetet për implementim të reformës në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë;

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për pagesën e komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;

Ferit Idrizi- kryetari komunës-sqaroi se fjala është për komisionet e formuara nga Kuvendi Komunal. Më tutje theksoi se këto komisioni duhet të paguhet sipas legjislacionit në fuqi. Ekzekutivi do t'i paguaj përmes këtij vendimi komisionet e formuara nga kuvendi.

Bekim Zabërgja –anëtar i kuvendit- tha se ka një sqarim tek çështja e komisionit për verifikimin e pronave, thuhet që janë 6 mbledhje theksoi se mund të jetë ndonjë gabim teknik ose ndonjë lëshim. Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokal paguhet më së paku për 25 mbledhje të mbajtura. Me tutje theksoi se komisionit për verifikimin e pronave ka me shume pune, vetëm për Parkun Industrial janë 13 procesverbale dhe ka shqyrtuar 3000 faqe. Me tutje kërkoi që të paguhet çdo procesverbal 30 euro siç është paraparë e jo vetëm 6 mbledhje. Tutje shpjegoi se komisioni për verifikimin e pronave është kompleks, dhe në ditët në vijim do të ketë në shqyrtim mbi 80 kontrata që janë të natyrës tepër të ndërlikuar dhe për këtë kërkohet mund dhe punë, andaj kërkoi që ky komision të ketë një pagesë të dalluar nga komisionet tjera.

Ilmi Azemi – anëtar i kuvendit-kërkoi që të shtohet edhe një pike në këtë vendim, kryesuesi i komisionit duhet ta dorëzon numrin e takimeve në sekretarinë e kuvendit dhe pastaj sekretaria i procedon në drejtoritë përkatëse.

Hava Mlinaku- drejtoresh e administratës- tha se kane vendosur qe 6 takime janë vendosur si një lloj tavani. Ndërsa me tutje theksoi se komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal i duhet 25 takime këtu mund te hyj edhe komisioni për verifikimin e pronave ndërsa komisionet tjera me 6 takime mund te vijne në një përfundim. Mirëpo theksoi se kuvendi mund të vendos për tavanet e takimeve.

Shpëtim Zhegrova nënkryetar i komunës-tha, sa i përket tavanit të takimeve nuk duhet të vendoset tavan i takimeve, sepse ka komisionet që nuk ju mjaftojnë 6 takime. Kërkoi që komisionet të paguhet në bazë të procesverbaleve që dorëzohen në sekretarinë kuvendit por jo të mbahet më shumë se një takim në muaj.

Bekim Zabërgja –anëtar i kuvendit-tha, komisioni për verifikimin e pronave është komision specifik dhe nuk mund te mbaj vetëm një mbledhje në muaj ,sepse mbesin pa zgjidhur shumë probleme të Vushtrrisë për një kohe të gjatë. Me tutje theksoi se nëse kërkohet të mbahet vetëm një mbledhje në muaj ai tërhiqet nga ky komision.

Hava Mlinaku- drejtoresh e administratës-sqaroi se ky vendim është në fuqi deri sa të hyjnë në fuqi rregullorja për pagesën e komisioneve dhe komiteteve.

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit-tha se këtij propozim vendimi i shtohet edhe një pike e veçantë që kryesuesi i komisionit të dorëzoi raportin e punës (procesverbalin) në sekretari të kuvendit dhe më tej procedohet për pagesë në drejtoritë kompetente.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 20 vota “për” sa edhe ish-in të pranishëm në sallën e mbledhje u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim, lejohet kompensimi i anëtarëve të komisioneve të formuara nga kuvendi, që nga data 1.1.2022, deri në hartimin e rregullores për komitetet dhe komisionet e kuvendit.

2. Lartësia e kompensimit për çdo takim caktohet në shumën prej 30€ për anëtar të komisionit, në bazë të procesverbalit për mbajtjen e takimit.

3. Pagesa e anëtarëve të komisioneve mund të bëhet deri në gjashtë (6) takime, për çështjen për të cilën janë formuar, përjashtim bën Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokalë, i cili duhet të paguhet për së paku njëzet e pesë (25) takime.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 të këtij vendimi do të merren nga kategoria paga dhe mëditje dhe kategoria e subvencioneve në Zyrën e Kryetarit.

5. Kryesuesi i komisionit obligohet që të dërgojë në Sekretarinë e Kuvendit procesverbalin-raportin e punës lidhur me takimet apo mbledhjet dhe shqyrtimin e çështjeve që janë objekt i punës së komisioneve.

6. Kompensimi i këtyre komisioneve do të bëhet konform legjislacionit në fuqi.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

8. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Klubit të Hendbollit “Vushtrria” (femrat) për përkrahje financiare;

Alban Bajrami, anëtar i kuvendit: kërkoi që të përkrahtë ky K.H. ”Vushtrria” për femra. Theksoi që ky klub kërkoi fillimisht t’i paguhet borxhi që i ka komuna në shume prej 5000 euro ,si shpërblim për sukseset e arritura bazuar ne rregulloren në fuqi ,pjesa tjetër prej 10000 i ndihmon klubit të mbijetoj dhe të vijoj garat dhe sukseset e mëtejme. Presim nga qeveria komunale që të realizoi plotësisht kërkesën e K.H. Vushtrria” për femra, duke kryer kështu një obligim ligjor dhe moral për një klub që i ka dhënë e vazhdon të jap aq shume për qytetin tonë.

Imi Azemi- anëtar i kuvendit- tha sa i përket shumes prej 5000 euro, nuk është diskutabile besoi që është në procedim të pagesës. Ndërsa shumës prej 10000 ka nevojë shumë të madhe për përkrahje direkte K.H. ”Vushtrria “femrat”. ftoi që t’i jepet mbështetje propozimit pasi qe vihet në pikëpyetje ekzistenca e këtij klubi.

Ferit Idrizi- kryetari komunës: theksoi se e mbështet plotësisht, por të kemi parasysh që 5000 € kanë mbetur borxh nga qeveria e kaluar. Propozoi që 5000 eurot që ti ndahen menjëherë, ndërsa për pjesën tjetër kërkoi mirëkuptimin e të gjithëve pas që nuk ka buxhet. Për vitin e ardhshëm të kemi parasysh që të kemi një diferencë për klube që arrijnë rezultate.

Ilmi Azemi – anëtar i kuvendit: kërkoi që të përkrahet ky klub nga qeveria komunale dhe nga të gjithë asamblastët sepse është në gjendje shumë të ranë, pas që klubi ka shumë borxhe dhe nga kjo situatë do të vështirësohet edhe vet ekzistenca e klubit.

Shpëtim Zhegrova- nënkryetar i komunës- tha, secili nga qeveria komunale dhe anëtarët e kuvendit janë te gatshëm të ndihmoj jo vetëm K.H. "Vushtrria", po edhe klubet e tjera të Komunës së Vushtrrisë. Secila nga klubet janë në një situatë jo të mirë. Nga raportet e auditorit ka pasur vërejtje për mënyrën e ndarjes së këtyre subvencioneve, nuk janë në harmoi me ligjin sepse ndarjet për OJQ dhe klube sportive behën në baze të thirrjes publike që bëhet nga Drejtoria e Kulturës. Kërkoi mirëkuptimin nga anëtarët e kuvendit që mos të merren vendime që nuk mund të zbatohen, sepse këto vendime po mbetën në sirtarin e komunës. Më tutje tha, në fillim të vitit të ardhëm publikohet thirrja publike për klube sportive dhe për OJQ andaj mos të merren vendime që nuk janë në harmoi me ligjin.

Ismet Gashi zyrtar ligjor- tha, se çdo ndarje mbi 500 euro duhet t'i nënshtrohet thirrjes publike, është e rregulluar me rregulloren komunale dhe rregulloren 04/2017 mbi kriteret standarde dhe procedurat e financimit të OJQ-ve. Mbi 500 euro pa thirrje publike nuk mund të ndahen nga Komuna, me përjashtim 5000 euro ndahen me rregulloren për dekorata dhe arritje të sukseseve.

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit- tha, në baze të sqarimeve këto 5000 euro ju takojnë sipas rregullores që ka nxjerr Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndërsa pjesa tjetër duhet të zbatohet me thirrje publike për vitin e ardhshëm.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 20 vota "për" sa edhe ishin të pranishëm në sallën e mbledhje u vendos me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë **24 nëntor 2022**, ka shqyrtuar kërkesën e Klubit të hendbollit "Vushtrria" – femrat, të parashtruar më datë 10.11.2022, për ofrimin e përkrahjes financiare në vlerë prej 15,000.00 €, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, të lartcekurve i parashtron këtë:

Përgjigje në kërkesë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që t'i përmbush obligimet ndaj klubit në fjalë, në vlerë financiare prej 5,000 €, detyrime që rrjedhin nga Rregullorja për Dekorata, lidhur me kompensimin e shpërblimit për sportet kolektive, pasi që Klubi i hendbollit "Vushtrria" F është shpallur kampion i Kosovës për periudhën 2020/2021.

Pjesa tjetër e kërkesës në vlerë prej 10,000.00 €, të procedohet për zbatim sipas thirrjes publike për klubet dhe OJQ-të për vitin 2023, konform legjislacionit në fuqi që i referohet rregullimit të kësaj fushe.

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të japë përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra ta njoftojë Klubin e hendbollit “Vushtrria”- femrat.

9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Planit të Punës të Kuvendit për vitin 2023;

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit- theksoi, se ky komision përbehet nga 5 anëtar ,kryesuese e këtij komisioni është kryesuesja e kuvendit ,ndërsa anëtarët e tjerë propozohen nga kuvendi. Kërkoj nga anëtarët e kuvendit te merret parasysh ligji për barazi gjinore.

Mentor Hasani -anëtar i kuvendi: nga PDK-ja propozohet Arlind Gogolli.

Behar Duraku -anëtar i kuvendit: nga LDK-ja propozohet Alban Bajrami.

Ali Jonuzi -anëtar i kuvendit: nga LVV-ja propozohet Nurten Çerkezi-Gjyshinca.

Faton Hyseni anëtar i kuvendit: propozoi Mensur Kastratin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 20 vota “për” sa edhe ishin të pranishëm në sallën e mbledhje u vendos me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2023, në përbërjen si në vijim:

1.1.Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit;

1.2.Arlind Gogolli, anëtar i kuvendit;

1.3.Alban Bajrami, anëtar i kuvendit;

1.4.Nurten Çerkezi-Gjyshinca anëtare e kuvendit;

1.5.Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda një afati të arsyeshëm dhe të hartojë draftin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, dhe të njëjtin duhet t’ia propozojë Kuvendit të komunës për aprovim në mbledhjen e muajit dhjetor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë

10. Shqyrtimi i Deklaratës të kuvendit për thirrje organeve të hetuesisë që të hetojnë disa portale dhe faqe të rreme në rrjetet sociale;

Agron Përçuku anëtar i kuvendit- tha se propozimi i tij ishte të behet një deklaratë pasi qe shumica nga anëtar e kuvendit jemi atakuar me deklarata te rrejshme nga disa portale te rrejshme te cilat nuk janë të regjistruara. Me tutje tha qe dëshiron t’i drejtohet kuvendit dhe hetuesisë për këto portale dhe te merren masa ndaj tyre. Zakonisht ne te kaluarën është formuar komision te behet deklaratë dhe ajo deklaratë është votuar ne kuvend dhe ka shkuar ne organet te cilat ju jemi drejtuar.

Kuvendi vendosi që të formoj një komision për deklarate për portalet e rrejshme .

Mentor Hasani -anëtar i kuvendi: nga PDK-ja propozohet Zojë Hajrizi.

Alban Bajrami -anëtar i kuvendit: nga LDK-ja propozohet Agron Përçuku.

Arlind Gogolli- anëtar i kuvendit: propozoi Bekim Zabërgjen.

Kuvendi me 20 vota “për” e emëroj komisionit për hartimin e Deklaratës të kuvendit për thirrje organeve të hetuesisë që të hetojnë disa portale dhe faqe të rreme në rrjetet sociale.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-lexoj tekstin e deklaratës së kuvendit:

Deklaratë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me anë të kësaj deklarate dënon tendencat denigruese të disa faqeve të rrejshme në rrjetet sociale të afërta me disa subjekte politike në Vushtrri ,përmes gjuhës denigruese, shpifjeve dhe plasimit të lajmeve të rrejshme ndaj zyrtareve publik dhe përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve. Kërkojmë nga ana e organeve të drejtësisë të zhvillojë hetime për këto portale dhe faqe të tjera të rreme në rrjete sociale siç janë “Vupol”, “Ballkan web”, “Vushtrri Zgjohu” dhe rrjete të tjera të ngjashme.

Vushtrri 24.11.2022

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit: theksoi, se e ka dëgjuar me vëmendje deklaratën dhe se erdhi në përfundim se kuvendi nuk mund të konstatoi se cilat janë ato portale.

Agron Përçuku anëtar i kuvendit : theksoi, së thirrja për organet e drejtësisë nëpërmjet kësaj deklarate nuk është për mediat që janë të regjistruara në vendin adekuat. Më tutje tha se janë disa portale ose faqe që janë të rrejshme, nuk jemi kundër mediave që janë të regjistruara dhe kanë lirinë e shprehjes. Por janë disa faqe që po mundohen të denigrojnë secilin përfaqësues të zgjedhur nga populli. Andaj kërkoi që mos të ketë keqkuptime se jemi kundër mediave për fjalën e lirë.

Bekim Zabërgja –anëtar i kuvendit: tha, se çështja është për faqe facebooku që veprojnë në mënyrë ilegale. Veprimtaria e tyre nuk ushtrohet në baze të ligjit të gazetarisë. Organeve të hetuesisë duhet t’i drejtohet me emër. Më tutje tha se nuk mund t’i drejtohet prokurorisë dhe gjykatës pa objekt të lëndës.

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit: shtroi pyetje si konstatuam ne se këto portale janë të rrejshme?

Ismet Gashi zyrtar ligjor: tha, deklarata nëse dërgohet në pakurori duhet të përcaktohet me emër dhe mbiemër se na kush dyshohet se po i bene shpifjet përndryshe kjo mund të merret si deklaratë që dënohen ato të cilat dezinformojnë.

Ferit Idrzi-kryetar i komunës: tha se janë shumë të qarta ato që u kërkuan. Ka portale, faqe të rrejshme që denigrojnë tërë kohën. Askush nuk është kundër media që janë të regjistruara dhe që informojnë, andaj nuk keni pse të hezitoni, më tutje kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që deklarata të adresohet si kërkesë që policia t’i përcjell këto faqe të rrejshme kryesisht nga facebook.

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit: tha, se në kuadër të policisë është njësi për krime kibernetike dhe kjo është punë e këtij njësi, andaj kuvendi nuk e di se çfarë pune mund të kryej me këtë deklaratë. Ata duhet të konstatojnë nëse këto media që i keni cekur janë të rrejshme.

Shpëtim Zhegrova- nënkryetar i komunës- tha, nuk jemi duke tentuar as ne si qeveri komunale as anëtarët e kuvendit të bëjmë gjyqin e asnjë medie që është zyrtare. Nuk besojmë asnjë nga zyrtaret që është duke u frikuar nga mediat se çka postojnë ,le të postojnë atë çka është dhe do ti përgjigjemi vazhdimisht mirëpo portale në një far forme që janë të rrejshme dhe regjistrohen

brenda ditës dhe postojnë lajme të rrejshme dhe etiketojnë secili nga ne pa asnjë baze duhet ti drejtohem policisë se krimeve kibernetike nga kuvendi sepse është dyshim i bazuar sepse ata janë duke operuar në mënyrë ilegale sepse të hyjsh në ARBK-ë që është vend ku regjistrohen bizneset e caktuara p.sh Vushtrria Online është biznes që është i regjistruar dhe ka emër dhe adresë. Përderisa njerëz të caktuar postojnë lajme të rrejshme. Më tutje tha se mendon që duhet dikush ti zbuloj duhet t'i drejtohem në këtë formë që të zbulohen këto portale. Përderisa nuk janë të regjistruara nuk kemi as ku ti paditim sepse nuk jemi në dijeni se kush janë.

Agron Përçuku anëtar i kuvendit: tha se kjo mund të shkojë edhe si thirrje e jo si deklaratë për organet e drejtësisë. Më tutje tha se ai personalisht është atakuar shumë që ka dalë në mbrojtje të qytetarëve, theksoi se ka dalë në mbrojtje të qytetarëve edhe në vitin 2021 edhe në atë kohë ka pasur njerëz përgjegjës që nuk ka ndalur dhe ata kanë qenë drejtorë bashkë me mua. Sot jam atakuar sepse ju kam dalë qytetarëve në ndihim. Kam të drejtë të shkojë edhe si individ por kam kërkuar sepse kam parë që janë ataku edhe shumë nga koleget.

Melihate Basholli-Latifi –kryesuese e kuvendit- tha se edhe ajo ka pasur sulme të tilla dhe i ka zgjedhur personalisht. Nëse ju jeni të pajtimin e procedojmë si thirrje për hulumtim.

11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;

Shpëtim Zhegrova- nënkryetar i komunës- tha se edhe në seancën e kaluar ka qenë propozim-vendim për caktim të lokacionit për ndërtimin e lapidarit. Ndërsa për ngritjen e lapidarit është ndarë buxheti. Merret vendimi në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku është e përcaktuar saktë forma e marrjes së vendimeve, prandaj nëse ka shkelje ministria e kthen, vendimin si të kundërligjshëm.

Ali Januzi –anëtar i kuvendit- tha se para disa ditëve ka qenë në këtë vend së bashku me Nexhat Merofcin dhe e kanë caktuar lokacionin. Më tutje theksoi se lapidari do të ndërtohet tek shtëpia e Adem Voces në oborrin e tij. Tutje shprehu shqetësimin për këtë çështje që është bërë kaq e madhe deri në këtë masë, sa që një pjesë e LVV-së dhe LDK-së nuk pranuan që të qëndronin në sallën e kuvendit . Sot do të vendoset për një lapidar për një figurë të madhe historike që e meriton. Është fat i mirë që e kemi një Adem në Shalë e një Adem në Prekaz të Drenicës kjo vetëm e pasuron historinë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 20 vota “për”, 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m², me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, kurse me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destinimit (kulturës) të kësaj parcele në elaboratin kadastral.

3.Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 265/22 i datës 27.10.2022, që lidhet me të njëjtën çështje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

5k. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:39.

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUCITRN

DATË	9.12.2022
PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
NGA/OD/FROM:	Melihate Basholli - Latifi  Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft – Plani i Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2023

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Draft – Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, i cili është në fazën e konsultimit publik deri më 26 dhjetor 2022.

Njëherazi, më datë 13.12.2022 (e martë) nga ora 10:00 në sallën e kuvendit të komunës do të organizohet konsultim publik.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

**DRAFT-PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR
VITIN 2023**

Dhjetor, 2022

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Qëllimi.....	5
Janar.....	6
Shkurt.....	7
Mars	8
Prill.....	9
Maj	10
Qershor	11
Korrik.....	12
Gusht	13
Shtator.....	14
Tetor	15
Nëntor.....	16
Dhjetor	17

HYRJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët, si dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit për Politikë dhe Financa apo Kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Kuvendi i komunës siguron kushte të punës për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit të komunës, krijon hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë mbledhjeve, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së tij, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Miratimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Lokal, etj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij dhe akteve tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapa të realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit, të bazuara në përgjegjësitë që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2023, ku Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë planifikon t'i mbajë dhjetë (10) mbledhje të rregullta, gjashtë prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, në të cilat do të trajtohen çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të saj. Përveç tjerash, Kuvendi i komunës trajton edhe këto çështje:

- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit;
- Miraton çështjet tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas statutit apo rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese, sipas ligjeve në fuqi;
- Themelon komitetet këshillëdhënëse dhe trupa tjera ad-hoc sipas nevojës;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të komunës sipas ligjit;
- Organizon takime buxhetore me qytetarë, lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës;
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit komunal.

QËLLIMI

Plani vjetor i punës i Kuvendit të komunës ka për qëllim që t'i ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke ju ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, në ç'rast ata do ta kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2023, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me këtë plan janë paraparë dhjetë (10) mbledhje të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, urgjente, solemne, siç parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimin Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Dinamika e Planit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit, të miratuara në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2023.

Kryesuesja e Kuvendit mund të mbajë takime mujore ose sipas nevojës me shefat e grupeve kuvendare të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës së Kuvendit.

Për përmbushjen e planit të punës, ekzekutivi ju ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës, sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës, të përcaktuara me këtë plan do të përkujdesen: Kryetari i komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës të Kuvendit, kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me ekzekutivin e komunës, i cili duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2023.

Plani i Punës i Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga Kuvendi.

**PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2023**

JANAR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5.1.2023
2.	Raport për punën njëvjeçare të Komitetit për Komunitete për vitin 2022	Komiteti për Komunitete		5.1.2023
3.	Të ndryshme			

SHKURT

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim-vendim për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i komunës	Komisioni vlerësues për ndarje të subvencioneve	3.2.2023
2.	Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		3.2.2023
3.	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		3.2.2023
4.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022	Komandanti i stacionit policor në Vushtrri		3.2.2023
5.	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022	Kryetari i komunës		3.2.2023
6.	Të ndryshme			3.2.2023

MARS

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022	Kryetari i komunës		3.3.2023
2.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		3.3.2023
3.	Propozim-vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës	Drejtoria për Arsim		3.3.2023
4.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023	Drejtoria për Arsim		3.3.2023
5.	Të ndryshme			3.3.2023

PRILL

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5.4.2023
2.	Informatë lidhur me ndërtimin në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Inspektive		5.4.2023
3.	Raport i Komisionit të aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave “Uniteti”	Drejtoria për Shërbime Publike, Komisioni i aksionarëve		5.4.2023
4.	Raport i punës njëvjeçare i Ndërmarrjes regjionale ujësjellësi “Mitrovica”	Drejtoria për Shërbime Publike		5.4.2023
5.	Raport për punën njëvjeçare të NPL “Përparimi”	Drejtoria për Shërbime Publike, Komisioni i aksionarëve		5.4.2023
6.	Të ndryshme			5.4.2023

MAJ

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Komisioni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave	2.5.2023
2.	Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore 2024 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.5.2023
3.	Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		2.5.2023
4.	Të ndryshme			2.5.2023

QERSHOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.6.2023
2.	Informatë për shfrytëzimin e pasurisë së komunës	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.6.2023
3.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë	Drejtoria për Administratë		2.6.2023
4.	Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		2.6.2023
5.	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2022/2023	Drejtoria për Arsim		2.6.2023
6.	Të ndryshme			2.6.2023

KORRIK

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2023	Kryetari i komunës		3.7.2023
2.	Raport gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2023
3.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2023	Komandanti i stacionit policor		3.7.2023
4.	Pasqyrat financiare për vitin 2023 dhe raporti i auditorit	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2023
5.	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.7.2023
6.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit dytë të vitit shkollor 2022/2023	Drejtoria e Arsimit		3.7.2023
7.	Të ndryshme			3.7.2023

GUSHT

MUAJ I PUSHIMEVE

SHTATOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2024	Kryetari i komunës		1.9.2023
2.	Propozim - Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		1.9.2023
3.	Raporti i sistemit për matjen e performancës në ofrimin e shërbimeve komunale	Koordinatori për performancë i Komunës së Vushtrrisë		1.9.2023
4.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar-qershor 2023	Kryetari i komunës		1.9.2023
5.	Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		1.9.2023
6.	Rishikimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		1.9.2023
7.	Të ndryshme			1.9.2023

TETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.10.2023
2.	Informatë lidhur me zbatimin e Hartës zonale komunale	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.10.2023
3.	Informatë për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		3.10.2023
4.	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2022/2023 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2023/2024	Drejtoria për Arsim		3.10.2023
5.	Informatë nëntëmujore lidhur me zhvillimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë teatrin, bibliotekën dhe muzeun	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		3.10.2023
6.	Informatë lidhur me zbatimin dhe efektet e Planit për rimëkëmbje ekonomike	Kryetari i komunës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	3.10.2023
7.	Propozim – vendim për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrisë për vitin 2024	Kryesuesja e Kuvendit		3.10.2023
8.	Të ndryshme			3.10.2023

NËNTOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, zhvillimin e bizneseve, si dhe statistikat lidhur me stimujt komunal në hapjen e vendeve të reja të punës	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural		2.11.2023
2.	Informatë lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		2.11.2023
3.	Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		2.11.2023
4.	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		2.11.2023
5.	Të ndryshme			2.11.2023

DHJETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Aprovimi i Draft-Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024	Kryesuesja e Kuvendit		10.1.2023
2.	Draft-Plani i punës i Kryetarit të komunës për vitin 2024	Kryetari i Komunës		
3.	Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë	Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		10.1.2023
4.	Të ndryshme			10.1.2023

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITËR

Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik:
“Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023, më datë
13.12.2022, ora 10:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi / Institucioni	Numri i tel.	Nënshkrimi
1	Jeton Sahin	Vushtrri	045-401-330	Sahin
2	Bujar Këllayev	Vushtrri	044-114628	Këllayev
3	Arifind Gogolli	Vushtrri	041-304822	Gogolli
4	Alban Bajrami	Vushtrri	045-445-755	Bajrami
5	NEHAT SADIKU	VUSHTRRI	044 222 112	Sadiku
6	Donjetë Latifi	Pestovë	044-106219	Latifi
7	Nurten Çetani-Gjyshinca	Vushtrri	044-475-774	Çetani
8	Liridon Krasniqi	VUSHTRRI	044986649	Krasniqi
9	Vlora Frashiqi	Vushtrri	044480-173	Frashiqi
10	Shajpe Gashi	Vushtrri	044156-413	Gashi
11	Amren Mehari	VUSHTRRI	044-437-227	Mehari
12	Melihatë Boshulliqi	Vushtrri	044 355 110	Boshulliqi
13				
14				
15				

16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



NJOFTIM
PËR KONSULTIM PUBLIK

Komisioni për hartimin e Draft–Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e ka vënë për konsultim publik: Draft–Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023.

Konsultimi publik do të zgjas nga data 25 nëntor 2022 deri më 26 dhjetor 2022.


Andaj ju bëjmë ftesë qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve se më datë 13.12.2022 (e martë) do të organizohet konsultimi publik në sallën e kuvendit në objektin e Komunës së Vushtrrisë me fillim në ora 10:00.

Ju inkurajomë të merrni pjesë në takim dhe mirëpresim propozimet, sugjerimet, dhe vërejtjet eventuale gjatë këtij konsultimi publik.

Për gjithë kontributin tuaj paraprakisht ju falënderojmë!

Po ashtu propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e juaja mund t'i dërgoni në adresat elektronike:

melihate.basholli.latifi@rks-gov.net; alban.n.bajrami@rks-gov.net; arlind.gogolli@rks-gov.net;
nurten.gjyshinca.cerkezi@rks-gov.net; mensur.kastrati@rks-gov.net; kuvendi.vushtrri@rks-gov.net



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel. 038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Zyra e Kryetarit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i punës për vitin 2023

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe Kuvendit,

Të bashkëngjitur keni Planin e Punës së Kryetarit – Qeverisë Komunale për vitin 2023 i cili është në fazën e diskutimit publik deri më 26 dhjetor 2022.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Kryetari i Komunës

**PLANI I PUNËS
I KRYETARIT TË KOMUNËS – QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2023**

DHJETOR 2022

Hyrje

Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, që janë me interes për komunën dhe qytetarët. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen po ashtu edhe në bazë të planit të tij të punës, i cili është dokument bazë për punën njëvjeçare të kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale.

Përgjegjësitë e kryetarit të komunës:

- Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
 - Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës;
 - Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
 - Ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
 - Emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
 - Emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave; organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
 - Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin e komunës;
 - Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
 - Raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës;
 - mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti çënon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve dhe
- Aktivitetet tjera që i caktohen me statut.

Hartimi i këtij plani është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave dhe prioriteteve të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të v. 2023, për të iu ofruar shërbime sa më cilësore qytetarëve dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët pa dallim.

Natyrisht se gjatë përmbushjes së këtyre objektivave ka sfida dhe vështirësi të cilat mund të paraqiten gjatë punës sonë, por me një angazhim të përbashkët dhe përkushtim mund të arrihen rezultate të dëshirueshme

Ky Plan i punës paraqet prioritetet e Kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2023 dhe jep përmbledhje të objektivave, aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e atyre objektivave respektivisht aktiviteteve. Po ashtu, përcakton edhe treguesit, si dhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, por i cili përgjatë vitit 2023 do të mund të evoluojë varësisht prej nevojave e kërkesave të qytetarëve.

Objektivat gjatë vitit 2023

Buxheti

Menaxhim efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës si dhe angazhim i shtuar në rritjen e të hyrave vetanake buxhetore;

Transparencë dhe llogaridhënie në shpenzime të buxhetit të komunës

Realizimi i të hyrave të planifikuara buxhetore si dhe të gjitha formave dhe mundësive të burimeve tjera të të hyrave;

Raportimi i rregullt në kuvendin e komunës (çdo 3 muaj) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore e sipas nevojës edhe sipas kërkesës së kuvendit;

Realizimi me kohë i projekteve kapitale sipas planifikimit; angazhimi për shpenzim 100 % të mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale sidomos mjeteve te grantit qeveritar por edhe nga të hyrat buxhetore;

Ekonomi, Bujqësi

Përkrahja për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme si dhe startupet me qëllim të rritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik;

Organizimi i praktikës së punës për të rinjtë te bizneset e komunës;

Përkushtimi për hapjen e mundësive si dhe për gjetjen e donatorëve për investime në komunë në veçanti në sektorin e bujqësisë;

Investimet në bujqësi përmes subvencionimeve me qëllim të rritjes së prodhimit të bujqësore dhe përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, rritjes së vetëpunësimit, modernizimit të bujqësisë përmes organizimit i trajnimeve dhe këshillimeve profesionale si dhe subvencionimit të bujqve;

Mbrojtja e pyjeve nga prerësit ilegal;

Arsimi

Gjithpërfshirja në arsim, ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie përkatësisht ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe ngritja e sigurisë dhe luftimi i dukurive devijante në shkolla;

Shëndetësia

Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, kujdesin parësor shëndetësor mbrojtjen sociale dhe familjeve të pastrehë, fëmijë pakujdes prindor si dhe të moshuarit;

Urbanizmi

Zbatimi i kriterëve ligjore si dhe nevojave të qytetarëve në fushën e urbanizëm; vendosja e rendit dhe ligjit në të gjitha ndërtimet;

Angazhimet për funksionalizmin e parkut industrial në Lumadh, për aq sa lejojnë mundësitë ligjore

Kujdesi për ambient të pastër,

Shërbime publike

Përfundimi i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe stacioneve të pompimit në vendbanimet, në tërë territorin e komunës

Vazhdimi në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve në zonat rurale,

Menaxhimi më i mirë i mbeturinave duke marrë për bazë planin tani më të aprovuar për menaxhimin e mbeturinave,

Mbështetje Ndërmarrjes Publike Komunale "Përparimi" në zgjerimin veprimtarive që do të mund të kryej

Ndërtimi i parqeve në hapësira publike

Shqyrtimi i mundësive për gjetjen e lokacionit për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve;

Menaxhimi i pronës komunale

Shfrytëzimi racional, i drejtë dhe i ligjshëm i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim me qëllim zhvillimit ekonomik dhe të krijimit të të hyrave buxhetore;

Ndërmarrja e masave për lirimin e pronave komunale të uzurpuara;

Bashkëpunimi me kuvendin

Raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës (çdo 3 muaj) lidhur me të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas nevojës edhe sipas kërkesës së kuvendit,

Propozimet për miratim të rregulloreve, vendimeve etj. për miratim në kuvend si dhe zbatimin e tyre,

Bashkëpunimi me institucionet qendrore

Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror veçanërisht me qeverinë dhe ministrinë e linjës në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë me rastin e marrjes së vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët,

Intensifikimi i bashkëpunimit me organet e nivelit qendror në implementimin e projekteve të cilat janë parapare të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës në veçanti projektet dy apo tri vjeçare;

Kulturë rini sport

Promovimi përkatësisht avancimi i aktiviteteve kulturore, të rinisë dhe në lëmin e sportit,

Përmirësimi i infrastrukturës së terreneve sportive;

Ofrimi i mbështetjes përmes subvencioneve i klubeve sportive, dhe OJQ-ve tjera organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, si dhe kategorive tjera.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Bashkëpunimi me shoqërinë civile në aspektin e krijimit të mundësive për pjesëmarrje në proceset e vendim marrjes në komunë;

Bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare,

në marrjen e vendimeve me rëndësi dhe interes për komunën dhe qytetarët,

Angazhime tjera për çështje me rëndësi dhe interes për qytetarët për mirëqenie dhe jetë më të mirë të tyre.

Në vijim të këtij plani janë paraqitur në mënyrë të detajuar planifikimet sipas drejtorive komunale.

BUXHETI DHE FINANCAT

Nr	Drejtori a	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Ecuri	Pjesëmarrësit tjerë	Ndërlidhja me
1	Drejtori a për Buxhet dhe Financa	1. Hapja e vitit fiskal dhe përgatitjet për startimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2023.	1. Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	1. Janar/2023		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

2	2. Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta personat: nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe certifikuesi për periudhën 2023.	2. Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	2. Janar/2023	Sipas planit të rrjedhës së parasë së gatshme	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
3	3. Pasqyrat financiare për buxhetit për vitin 2022	3. Plotësimi më efikas dhe dorëzimi i PVF	3. Janar/2023		
4	4. Përgatitja e rrjedhës së parasë për të gjitha programet për vitin 2023	4. Plotësimi i formularëve të rrjedhës së parasë në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF.	4. Janar/2023		
5	5. Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2022	5. Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2022	5. Shkurt-Mars/2023		
6	6. Përgatitja e Raporteve tremujore për vitin 2023	6. Implementimi i raporteve në Kuvend dhe Ministri	6. çdo tre muaj		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

7	7. Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve të pa kryera nga v 2022 (proj.investuese)	7. Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve	7. Shkurt-Mars/2023			
8	8. Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB	8. Përmbajtja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	8. Çdo muaj/2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
9	9. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë.	9. Përgatitja e informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetor	9. Çdo tre muaj/2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
10	10. Prezantimi i Qarkores 01/2024 kufijve të par buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2024 konform qarkoreve të marra nga MEF-i	10. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2023	10. Maj - Qershor/2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
11	11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të	11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventual të buxhetit të rishikuar për	11. Qershor/2022			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

		rishikuar për vitin fiskal 2023	vitin fiskal 2023				
12		12. Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	12. Përgaditja e formularve lidhur ndryshimet buxhetore	1 2. Qeshor- Korrik/ 2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
13		13. Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashtëmujorin e parë për vitin fiskal 2023	13. Raportimi informatës lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	1 3. Qershor/ 2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
14		14. Informatë për realizimin e investimeve kapitale, realizimi i projekteve të parapara me planin dinamik të shpenzimeve.	14. Përgaditja e informatës lidhur me shpenzimet buxhetore	1 4. Korrik/ 2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
15		15. Shqyrtimi i rregullores së tatimit në pronë për vitin 2024	15. Dorëzimi në MEF	1 5. Korrik/ 2023			
16		16. Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2024 konform qarkores nga MEF-i	16. Evidentimi i të gjitha kërkesave të drejtorive për vitin fiskal 2024.	1 6. Shtator/ 2023			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

17	17. Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2023	1 7. Dhjetor /20 23	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
----	--------------------------------------------------------------	---------------------------------	---------------------------------------------

EKONOMI BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Nr	Prioritetet	Aktivitetet e planifikuara	Koha e implementimit	Buxheti €	Akterët implementues të projektit
1	Hartimi i planeve dhe raporteve për drejtorinë e EBPZHR	Hartimi i planit të punës për vitin 2023. Hartimi i raportit të punës për vitin 2022	Janar 2022	-	Drejtoria e EBPZHR
2	Regjistrimi i bizneseve në kuadër të ARBK-Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Shqyrtimi i kërkesave për aplikim për regjistrim të bizneseve, procedimi në Ministrinë gjegjëse, shpërndarja e Certifikatave. Shqyrtimi i kërkesave për ndryshime në Certifikatë të biznesit, procedimi i lëndës në Ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për ndryshime dhe aprovime. Shqyrtimi i kërkesave për shuarje të biznesit, procedimi i lëndës në Ministrinë gjegjëse, njoftimi i palës për miratim. Vërtetime sipas nevojave të palëve.	Janar-dhjetor		QKB
3	Hartimi i propozim vendimeve, shqyrtimi dhe përgjigja në kërkesa, hartimi i marrëveshtjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit etj.	Hartimi i të gjithave akteve dhe vendimeve në kohë të duhur. Shqyrtimi dhe përgjigja e të gjitha kërkesave në afat brenda kornizave ligjore. Përfaqësimi në institucione shtetërore (gjykata, ministri)	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e EBPZHR
4	Përgatitja e projekteve-paramasave.	Hartimi i propozim projekteve-paramasave, shpalljeve me të gjitha aktet përcjellëse	Janar-qershor	-	Drejtoria e EBPZHR

5	Shërbime për fermerë	Rexhistrimi dhe ndryshimet eventuale të fermerve në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të fermave në EFR. Aplikimi i fermerve për subvencione të shpallura nga MBPZHR, digjitalizimi me ELPIS, pranimi i dokumentacionit, dorëzimi në AZHB. Angazhimi në Programin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR për fermerë Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për fermerë.	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e EBPZHR
6	Ngritja e komisioneve, hartimi i raporteve për nevoja të Komunës dhe MBPZHR	Planifikimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore- raportimi. Formimi i komisionit për procesin e korrjes së drithrave, përcjellja e procesit – raportimi.	Janar - dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EBPZHR
7	Bashkëpunimi me OJQ dhe akterë tjerë	Vazhdimi i bashkëpunimit me OJQ me të cilat jemi duke bashkëpunu si dhe angazhimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me OJQ vendore dhe ndërkombtare	Janar-dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EBPZHR
8	Mbrojtja dhe menaxhimi i pyjeve	Mbulimi i terreneve me roje adekuate të pyllit(6 terene), Damkosja e drunjtëve të prerë. Kontrolle permanente e terreneve. Regjistrimet e rregullta dhe të veçanta të terreneve. Pastrimi i pyjeve dhe mbikëqyrja e pastrimit. Mbrojtja nga prerjet ilegale dhe zjarret. Kontrolle në vend shitje me asistim të organeve të rendit- konfiskimet.	Janar-dhjetor		

Projekte të planifikuara

Lloji i investimit	Vlera e planifikuar (65%)	Participimi i fermerëve (15%)	Totali i investimit
Furnizimi me pajisje bujqësore për fermerë	100,000.00	10,000.00	110,000.00
Furnizimi me inventar për zyre	1,000.00		1,000.00
Furnizimi me teknologji informative	1,200.00		1,200.00

Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap-Silnica	50,000.00		50,00.00
Iber-Lepenc pagesa 50% e ujitjes	45,000.00		45,000.00
Subvencionimi i Qumeshtit	45,000.00		45,000.00
Subvencionimi i Deleve dhe Dhive	15,000.00		15,000.00
Subvencionimi i Bleteve	45,000.00		45,000.00
Projekti me bashkefinancim	80,000.00		80,000.00
Startap	120,000.00		120,000.00
Projekt me IRW	80,368.00		80,368.00
Gjisej	582,568.00.00	10,000.00	592,568.00

ARSIMI

Prioritetet kryesore në të cilat mbështet plani i punës i DKA-së:

- Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësim nxënie efektive;
- Organizimi dhe mbajta e garave të ndryshme;
- Mbikëqyrje dhe monitorim i vazhdueshëm në të gjitha institucionet e nivelit parauniversitare, lidhur me përkrahjen dhe rritjen e përgjegjësisë;
- Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë dhe zbatimi i KK-së;
- Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me të gjithë palët në interes të zhvillimit të arsimit;

Objektiva 1. Mjedis shkollor i përshtatshëm për mësimdhënie dhe mësim nxënie efektive

Nr	Aktivitetet	Financuar ne euro	Afati zbatimit	Bartësit e aktiviteteve	Ndërlidhja me aktet tjera
1	1.1.Furnizim me dru për ngrohje	20.1312.00	Prill- Gusht	• DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA
2	1.2. Furnizim me gaz natyror	2,000.00	Mars-Gusht	• DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA
3	1.3.Furnizim me inventar për shkolla	6,899.00	Maj-Tetor	• DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa	PZHKA

4	1.4.Furnizim me kamera në qytet dhe shkolla	2,000.00	Qershor-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
5	1.5.Furnizim me libra për biblioteka te shkollave	1,000.00	Korrik-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
6	1.6.Furnizim me lodra për fëmije	1,000.00	Qershor-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
7	1.7.Furnizim me lule	900.00	Shkurt-Qershor	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
8	1.8.Furnizim me material për mirëmbajtje te shkollës	22,534.00	Shkurt-Shtator	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
9	1.9.Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri	7,100.00	Qershor-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
10	1.10.Furnizim me pelet	21,200.00	Mars-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
11	1.11.Furnizim me enë për kuzhinë	2,300.00	Korrik-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
12	1.12.Furnizim me produkte tekstili (çarçaf, batanije, jastëk ,tepih ,perde)	5,200.00	Qershor-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA

13	1.13.Furnizim me ushqim dhe pije	22,7307.00	Prill-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
14	1.14.Furnizim me veshmbathje(man tele ,përparëse ,kapela ,maska, veshje për festa për nx .dhe papuçe për punëtores)	6,900.00	Korrik-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
15	1.15.Furnizime tjera për zyre	3,700.00	Mars-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
16	1.16.Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ	3,100.00	Shkurt-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
17	1.17.Furnizimi dhe montimi i klimave	14,850.00	Maj-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
18	1.18.Furnizimi dhe montimi i logove për shkolla	200.00	Maj-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
19	1.19.Furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënës në oborret e shkollave	3,400.00	Korrik-Shtator	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
20	1.20.Furnizimi me gjeneratorë dhe inventar	11,800.00	Shkurt-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA

21	1.21.Furnizimi me kositëse të barit	1,050.00	Mars-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
22	1.22.Furnizimi me material pedagogjik	16,000.00	Qershor-Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • DKA • Drejtoria e prokurimit • Drejtoria për Buxhet dhe Financa 	PZHKA
8. Pranimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve	8.1 Inspektimi, testimi dhe nënshkrimi i pranimit të materialeve, punëve dhe shërbimeve; 8.2 Parashtron kërkesë te Drejtori i drejtorisë ose Menaxheri i Prokurimit në rast nevojë për formimin e komisioneve për pranim; 8.3 Mban evidence për pranimin e mallit dhe i proceson të dhënat në sistem; 8.4 Mban shënime mbi dërgesat e mallit si dhe shpërndarjen e tij 8.5 Bënë dorëzimin e dokumentacionit me protokoll në drejtim të zyrtarit të pasurisë me qëllim të regjistrimit të pasurisë	Gjatë tërë vitit	Zyrtari i pranimit	
9. Mirëmbajtja e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në lokalet e ndërtesës së komunës si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit në objektin e komunës, pastërtisë dhe nyjave sanitare.	9.1 Ndërrimi dhe riparimi i stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar; 9.2 Kujdesi për funksionalitetin e sistemit të ngrohjes/ftohjes 9.3 Mirëmbajtja e inventarit nëpër zyra; 9.4 Kujdesi për funksionalitetin e gjeneratorit dhe ashensorit 9.5 Kujdesi për furnizimin me mjete higjienike për nevoja të objektit të komunës	Gjatë tërë vitit	Operatori teknik-Mirëmbajtësi	

Qendra e Shërbimit për Qytetar

Qëllimi kryesor(Objektivat)	Aktiviteti(Detyrat)	Afatet
1. Pranimi i të gjitha kërkesave/ankesave të parashtruara nga qytetarët/bizneset dhe grupet e interesit.	1-1 .Pranimi dhe regjistrimi i lëndve në sistem 1.2 Pranimi dhe skanimi i të gjitha lëndve të parashtruara nga palët drejtuar institucionit të Komunes 1.3. Informimi i duhur mbi procedurat që duhet të ndjekin palët me rastin e paraqitjes së kërkesës 1.4 Dhenja e ndihmës palës me rastin e paraqitjes së kërkesës, 1.5 Njoftimi i palës përmes telefonit mbi ecurinë e lëndës (për marrjen e vendimit apo plotësimin e lëndës)	Gjatë gjithë vitit
2. Përdorimi dhe respektimi i akteve ligjore dhe nenligjore në mënyrë të drejtë dhe të sakte.	1 Përdorimi dhe zbatimi i ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031 2 Përdorimi dhe zbatimi i udhëzimit administrativ për QSHQ-te 2011/03 3 Zbatimi i rregulloreve të brendshme komunale	Gjatë gjithë vitit

<p>3.Percjellja e kerkesave /lendëve tek drejtoritë perkatëse permes sistemit dhe permes dorëzimit fizik, gjatë vitit 2023 do të përpiqemi që dorëzimi fizik të eliminohet , do te përdoret vetëm në raste kur është e domosdoshme.</p>	<p>3.1 Regjistrimi i lendeve ne librat e protokollit sipas Drejtorive/zyreve perkatëse. 3.2 Dorezimi i lendve tek drejtorit/zyret perkatëse. 3.3.Pranimi i post s dhe shpërndarja e saj tek zyrtaret pergjigjes 3.4 shpërndarja e materialt zyrtar tek zyrtaret pergjigjes 3.5 dergimi i shkresave tek palet permes postës dhe personalish sipas nevojës.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit</p>
<p>4 Protokolimi i të gjitha dokumenteve komunale me nje protokol unik te gjeneruar nga sistemi i softuerit.</p>	<p>4.1 Protokollimi i te gjitha dokumenteve komunale me numer protokollit nga sistemi i softuerit 1.2 Skanimi i te gjitha dokumenteve te protokoluara</p>	<p>Gjatë gjithë vitit</p>

Zyra për të drejtat e njeriut

Nr .	Qellimi kryesor(Objektivat)	Aktiviteti(Detyrat)	Afati	Bartës	Buxheti
1..	Mbrojta e te drejtave te njeriut dhe barazia gjinore dhe mos diskriminim	<ul style="list-style-type: none"> - Vizita nëpër të gjitha institucionet publike dhe private më qëllim të verifikimit: a janë të mbrojtura të dy gjinitë sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte. Sa respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi - Huluntim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit - Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimorë te grave 	Janar -Dhjetor	Zyrtarja për Barazi Gjinore, zyra e personelit ,Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	
2.	Avancimi i pozitës shoqërore se femrës në vendimmarrje.	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi fushatave vetëdijes se kundër trafikimit më qenie njerëzore . - Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë me fokus të veçantë për gratë e nivelit të ulët të shkollimit dhe atyre të kanë qen ngjatë pa punë - Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë 	Punë kontinuele gjatë vitit vijues	Zyrtarja për Barazi Gjinore	
3.	Inkurajimi i femrave në punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	<ul style="list-style-type: none"> - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndër marrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të aftësive dhe teknikave të prodhimit. - Mbështetja e përpjekjeve për të forcuar të drejtat ligjore të grave të prone - Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë - Inkurajimi i femrave vetushqyese në punësim dhe femrave që do te duhej të promovohen dhe personave me aftësi te kufizuar. 	Punë permanente për gjatë gjithë vitit.	Zyrtarja për Barazi Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	
4.	Përgatitja e një data baze, statistikore për buxhetimin gjinore në Komunën e Vushtrrisë duke përfshirë punësimin mbrojtjen shëndetësore , pjesëmarrjen në politikë dhe pozita vendimmarrëse	<ul style="list-style-type: none"> - Vizita nëpër të gjitha institucionet publike dhe private më qëllim të verifikimit: a janë të mbrojtura të dy gjinitë sipas ligjit, a kanë kontrata a marrin rrogë njësoj, për punën e njëjte. Sa respektohet pushimi i lehonisë i garantuar me ligjin në fuqi 	Janar-Dhjetor	Zyrtarja për Barazi Gji Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve nore,zyra e personelit ,Punëdhënësit Qendra për punësim dhe aftësim	

5.	Vetëdijesimi në zonat rurale për të drejtat trashëgimorë	<ul style="list-style-type: none"> - Hulumtim i shkaqeve të braktisjes së shkollës nga nxënësit në komunën e Vushtrrisë, verifikimi i rasteve të nxënësve shkollimi i të cilëve varet nga pagesa e një bilete autobusi - Inicim i Seancave pa pagës me Psikologun për nxënës që e braktisin shkollën, ose që kanë potencial për ta braktisur - Vizita në shkolla të komunës, ligjërata dhe aktivitete të ndryshme 	Zyrtarja për Barazi Gjinore , Drejtoria e Arsimit , Drejtoret e shkollave Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Punë Psikologu i Shkollës NJKDNJ, ZBGJ	Ka filluar procesi, është në vazhdimësi	
6.	Inkurajimi i femrave në punësim dhe femrave që do të duhej të promovohen dhe personave me nevoja të veçanta.	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e raporteve statistikore të pjesëmarrjes së femrave, gjithashtu edhe raporti mbi kualifikimin e tyre. - Organizimi i debateve, seminare trajnime. - Avokimi për njohjen dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të grave; - Mbështetja e ndërmarrësisë së grave nëpërmjet trajnimit të aftësive dhe teknikave të prodhimit. - Mbështetja e përpjekjeve për të forcuar të drejtat ligjore të grave të prone 	Zyrtarja për Barazi Gjinore Komuna Enti për punësim Qendra për punë sociale	Punë permanente për gjatë gjithë vitit.	
7.	Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	-	Drejtoria për Mirëqenie Sociale Enti për Punë Psikologu i Shkollës	Permanent	
8.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Zyrtares për Barazi Gjinore dhe OJQ të grave të komuniteteve përmes aktiviteteve të përbashkëta	- Organizimi i 4 takimeve gjatë vitit me temë "Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të grave të komunitetit serb, turk, rom, ashkali etj në 4 tema specifike" aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.	Punë Kontinuele gjatë vitit	Zyrtarja për Çështje Gjinore. ZKK OJQ-ve	2.400,00
9.	Organizimi fushatave vetëdijesuese kundër trafikimit të qenie njerëzore .	<ul style="list-style-type: none"> - 4 fushatave vetëdijesimi për parandalimin e trafikut të qenie njerëzore - Identifikimi i numrit të personave të trafikuar - Identifikimi Nevojave të tyre primare - Adresimi i këtyre kërkesave Institucioneve përgjegjëse 	Maj – Nëntor Ne bashkëpunim me OJQ dhe KVLR	Policia e Kosovës Zyrtarja për Barazi gjinore, Zyrtarja për Mbrojtjen e Femijes, QPS Gjykata	2.000,00

10	Shënimi i ditëve të rëndësishme	4 Shkurt Dita Nderkombetare kundër kancerit Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas, 8 Marsit	Datat e percaktuara	Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	1000
		21 Marsi Dita nderkombetare e luftes kundër Diskriminimit Racor 21 Mars, Dita nderkombetare e personave me sindrom Doën		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	100 200
		8 Prill Dita Nderkombetare e Romeve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	100
		9 Prilli Dita Nderkombetare e kushtetutës		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		1 Qershori Dita Nderkombetare e fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore/Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		12 Qershor Dita Nderkombetare kundër shfrytëzimit të punëve të rënda të fëmijëve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		23 Qershor Dita Nderkombetare e shërbyesve Civil		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		12 Gusht Dita Boterore e rinise		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut dhe mbrojtjen e fëmijëve.	
		27 Gusht Dita nderkombetare e të zhdukurive		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	
		2 Shtator Dita boterore e trashëgimisë		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut	

		15 Shtator Dita Nderkombetare e Demokracise		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		21 Shtator, Dita Nderkombetare e paqes		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		1 Tetor Dita Nderkombetare e personave te moshuar		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		10 Tetor Dita Boterore e shëndetit mendo		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		11 Tetor Dita Boterore e çikave		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		15 Tetor Dita e Shkopit te bardhe		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		16 Tetor Dita e mundësive te barabarta		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		18 Tetor, Dita Nderkombetare Kunder Trafikim		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		19 Nentori Dita nderkombetare per parandalimin e abuzimit te femijeve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		20 Nentor Pervjetori i konventës nderkombetare per te drejtat e femijeve		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		25 Nentori Dita nderkombetare kundër dhunës ndaj grave		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		1 Dhjetori Dita boterore e luftës kundër HIV/AIDS		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		5 Dhjetor Dita nderkombetare e vullnetareve		Zyrtarja për Barazi Gjinore	

				Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		10 Dhjetor Dita Nderkombetare e te Drejtave te Njeriut		Zyrtarja për Barazi Gjinore/Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
		20 Dhjetor Dita Boterore e Solidaritetit Njerzor		Zyrtarja për Barazi Gjinore Zyrtarja per te Drejtat e Njeriut	
11.	Fuqizimi i Bashkëpunimit mes Komunës dhe OJQ përmes aktiviteteve te përbashkëta	Organizimi i 4 takimeve gjate vitit me temë “Përkrahja dhe bashkëpunimi i OJQ-ve të grave të komunitetit serb, turk, rom, ashkali etj në 4 tema specifike“ aspektet dhe bashkëpunimi i me ngushtë me OJQ.	Gjatë gjithë vitit	Zyrtarja për Çështje Gjinore. ZKK OJQ-ve	2.400,00

SHËRBIME PUBLIKE

	Aktiviteti	Periodha	Ne bashkëpunim
1	Përgatitja e dokumentacionit dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale	Janar-Mars	Policinë e Kosovës
2	Zotimet e mjeteve për inicim të procedurave të tenderimit për projektet që do të menaxhohen nga DSHP	Janar – Tetor	DBTH, Drejtoria e Prokurimit
3	Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik dhe i kanaleve të hapura	Mars-Prill	Kompania „Uniteti”
4	Analiza e rrjedhës së qarkullimit të mjeteve motorike në bazë të senseve (kaheve) të lëvizjes në të gjitha rrugët e qytetit,	Mars-Prill	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, SHMT
5	Plani i Aktiviteteve për shënimin e muajit të higjienës	Mars-Prill	Drejtoria për Inspektime, KRH “Uniteti” dhe OJQ.
6	Plani komunal i veprimit për efijencë të energjisë	Mak - Qershor	DSHP në bashkëpunim me Agjencinë e Kosovës për efijencë të energjisë
7	Hartimi i dokumentacionit teknik për mirëmbajtjen e varrezave	Prill-maj	
8	Mirëmbajtja (mirëmbajtja verore – plani i fshirje – larjes së rrugëve në qytet, mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve, mirëmbajtja dimërore)	Mars	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim
9	Përgatitja e dokumentacionit teknik për mirëmbajtjen e ndriçimit publik	Shkurt-mars	
10	Përgatitja e dokumentacionit teknik për sinjalizimin horizontal dhe vertikal		

11	Eliminimi i deponive ilegale	Shkurt- Mars	Drejtoria për Shërbime Publike, Uniteti
12	Analiza teknike e fraksioneve të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Shkurt- Mars	DSHP, Uniteti.
13	Përgatitja e dokumentacionit teknik për tenderim – paramasat dhe paralogarit për Shërbimet tjera kontraktuese (ndërtimet e rrugëve me kubza betoni, ndërtimi i trotuareve, parqet dhe sheshet)	Mars-Prill	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa si dhe Drejtoria për Prokurim
14	Hartimi i planit të mobilitetit-lëvizshmërisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion	Mars-Qershor	Spektori për komunikacion (DSHP), Policia e Kosoves, UN - HABITATI
15	Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për sigurinë në komunikacion në territorin e Komunës së Vushtrrisë, harmonizimi i saj me Ligjin për Sigurinë në Komunikacion, Ligjin për Rrugët, Ligjin për transportin etj.	Prill-Qershor	Drejtorinë e Inspeksioneve, Policinë e Kosovës
16	Punë të ndryshme administrative për përgatitjen dhe organizimin e kompanive për transportin publik gjatë vitit shkollor	Gusht	Kompanitë transportuese
17	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive për Riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve motorike të K. Komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim
18	Implementim i proceseve - Analizës teknike për ndarjen e mbeturinave në burim	shtator	Ndërmarrjen Uniteti, Qendrën për Paketim të mbetjeve të riciklueshme, OJQ-te
19	Përgatitja e dokumentacionit për Sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve të Komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim
20	Përgatitja e dokumentacionit për furnizimin me derivate lëndë djegëse dhe vajra për vetura për mjetet motorike të Komunës	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim
21	Implementimi i objektivave të Planit komunal pesë vjeçar të menaxhimit të mbeturinave	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	KRM “Uniteti”
22	Dekorimi i hapësirave në qytet	Nëntor-Dhjetor	Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa si dhe Drejtoria për Prokurim

KULTURE RINI SPORT

Nr	Objektivat	Aktivitetet	Periudha e planifikuar për realizim	Bartësit e aktiviteteve
1.	Vazhdim i pasurimit të bibliotekës së qytetit	Organizimi i kampanjës me qëllim të pasurimit të bibliotekës me libra	Janar – dhjetor 2023	DKRS dhe OJQ e Klube letrare
2.	Ofrimi i mundësive për leximin e titujve të rinj edhe për lexuesit nga bibliotekat e terrenit.	Shpërndarja e librave që janë në numër të madh të ekzemplarëve nga biblioteka amë në ato të terrenit.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
3.	Përkrahja e autorëve të rinj	Organizimi i promovime të ndryshme të librave, qoftë të krijuesve shkencorë, qoftë të atyre të rinj.	Janar – dhjetor 2023	DKRS Klubet letrare në Vushtrri
4.	Zbulim i librave të rrallë në fushën e publikimeve	Organizimi i muajit ku do bëhet zbulimi i librit të rrallë në nivel komune, veçanërisht nëpër shkolla të komunës	Janar – mars 2023	DKRS DKA
5.	Pasurimi i bibliotekave me tituj të rinj	Hartimi i listës së librave të kërkuara nga lexuesit dhe e librave mungesë për bibliotekën amë dhe ato në teren.	Janar – qershor 2023	DKRS Klube letrare Profesorë të shkollave fillore dhe të mesme
6.	Hulumtimi i materialit të "Luftës së Fundit 1998-1999"	Punë hulumtuese në bashkëpunim me familjarët e dëshmorëve, martirëve dhe shoqatat e dala nga lufta.	Janar-dhjetor 2023	DKRS
7.	Hulumtimi i kulturës materiale	Vazhdimi i punës hulumtuese në fushën e kulturës materiale të luajtshme dhe të paluajtshme.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
8.	Rrethimi i oborrit të objektit të Muzeut të Vushtrrisë, gjegjësisht Monumentit –Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit.	kufizimi i oborrit të Muzeut	Janar – mars 2023	DKRS

9.	Hapja dhe funksionimi i objektit të Muzeut të Vushtrrisë.	gjatë vitit 2023 planifikohet të përgatiten ekspozita të përhershme dhe të përkohshme.	Janar-dhjetor 2023	DKRS
10	Kthimi i eksponeve arkeologjike të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike në Kalanë e Vjetër të Vushtrrisë, të cilat ruhen në Institutin Arkeologjik të Kosovës.	në mungesë të një objekti për ruajtjen dhe ekspozimin e tyre ato janë ruajtur në Institutin Arkeologjik të Kosovës, por meqenëse tani Vushtrria ka objektin e muzeut, ekspozitetet në fjalë duhet ti kthejmë dhe ekspozojmë në vendin e gjetjes.	Mars-shtatorë 2023	DKRS Institutit Arkeologjik i Kosovës.
11	Blerja e eksponeve të identifikuar gjatë vitit 2022	Përmes blerjes së eksponeve të identifikuar gjatë vitit 2022, përpos që do shpëtohen ekspozitetet e ekspozuara në terrene të ndryshme, në veçanti deponitë e metalit, etj, edhe do pasurohet Muzeu i Vushtrrisë.	Janar- dhjetor 2023	DKRS
12	Përgatitja e ekspozitës të përhershme "oda tradicionale".	Improvizimi dhe prezantimi i "odës" me elementet përcjellëse (shtroje, mbuloje dhe pajisje tradicionale).	Janar-qershor 2023	DKRS
13	Përgatitja e ekspozitës të përhershme "dhoma qytetare".	Improvizimi dhe prezantimi i "dhomës qytetare" me elementet përcjellëse (shtroje, mbuloje dhe pajisje tradicionale).	Janar-qershor 2023	DKRS
14	Përgatitja e ekspozitës së përhershme "dhoma e oxhakut (kuzhina tradicionale).	Improvizimi dhe prezantimi i "dhomës së oxhakut (kuzhina tradicionale)".	Janar-qershor 2023	DKRS
15	Përgatitja e ekspozitës etnologjike	Prezantimi i pasurisë etnologjike, siç janë: veshje, shtroje e mbuloje, punëdore, etj.	Janar-qershor 2023	DKRS
16	Përgatitja e ekspozitës të teknologjisë.	Prezantimi i pasurisë të sektorit të teknologjisë së vjetër.	Janar-qershor 2023	DKRS
17	Organizimi dhe funksionalizimi i dhomës për persona me nevoja të veçanta.	Realizimi i aktiviteteve të ndryshme edukative me personat me aftësi dhe nevoja të veçanta	Qershor dhjetor 2023	DKRS

18	Përgatitja e ekspozitës arkeologjike dhe historike”	Prezantimi i pasurisë arkeologjike dhe historike.	Prill nëntor 2023	DKRS;
19	Pasurimi i bibliotekës shkencore të muzeut me tituj të ri shkencor	Vazhdimi i punës në pasurimin i bibliotekës së muzeut me literature shkencore e profesionale.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
20	Krijimi i Etno-parkut	Organizimi i etno-parkut në oborrin e muzeut (Monumenti “Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit”), ku do të ekspozohen objekte të ndryshme kulturore nga arkeologjia dhe etnologjia.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
21	Pasurimi i sektorit të videotekës dhe fototekës së muzeut.	Hulumtimi i fotografive dhe videove të vjetra me rëndësi historik e kulturore.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
22	Botimi i një katalogu dhe fletëpalosjeje	Përgatitja e një katalogu dhe fletëpalosjeje të ekspozateve muzeale për vizitorë, ku do të prezantohen eksponatet më të vlefshme dhe më interesante të cilat i ka Muzeu.	Janar – dhjetor 2023	DKRS
23	Hulumtimi i artizanateve	Vazhdimi i punës në hulumtimin i zejtarive të cilat u trashëguan dhe vazhdojnë të mbesin gjallë edhe sot.	Janar – dhjetor 2023	DKRS;
24	Pasurimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	Organizimi i vizitave të muzeut nëpër shkolla fillore dhe të mesme me qëllim të promovimit të trashëgimisë dhe mbledhjes së ekspozateve nga terreni në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit dhe shkollave.	Mars – Qershor 2023	• DKRS
25	Hulumtimi dhe arkivimi i kulturës shpirtërore	Vazhdimi i punës në hulumtimin e kulturës shpirtërore.	Janar – dhjetor 2023	• DKRS
26	Pranimi dhe ruajtja e materialit arkivor	Pranimi dorëzimi i regjistraturave arkivore	Janar – dhjetor 2023	DKRS
27	Ndarja e lëndës arkivore në njësi	Regjistrimi i lëndës arkivore	Janar-dhjetor 2023	DKRS

28	Klasifikimi I lëndës arkivore	Vendosja e tiketave me mbishkrim	Mars-nëntor 2023	DKRS
29	Sistemi i lëndës arkivore	Vendosja në raftë	Qershor-dhjetor 2023	DKRS
30	Vizita në Suedi	Njohuri në lidhje me digjitalizimin e Arkivit	Mars - qershor 2023	DKRS
31	Digjitalizimi I Arkivit	Vendosja e dokumenteve në formë elektronikë	Qershor-dhjetor 2023	DKRS
32	Mirëmbajtja e dokumenteve	Kontrolli i lëndëve arkivore Brenda dhe jashtë Arkivit	Gjatë vitit 2023	DKRS
33	Shërbimi ndaj publikut	Verifikim të lëndëve	Janra-dhjetor 2023	DKRS
34	Përmes përkujtimit të 17 shkurtit, ditës së shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, si data më e rëndësishme në historinë e shtetit tonë synojmë të mbajmë të freskëta kujtimet për sakrificat e popullit tonë për arritjen e kësaj dite.	- Homazhe - Program artistik - Hapja e ekspozitës me piktura - Marshi i pavarësisë - Program artistik për të rinjë - Orë letrare - 17 Shkurt-Manifestim i Ditës së Pavarësisë së Kosovës Turne i hapur në Pingpong	17 shkurt 2023	Komuna e Vushtrrisë DKRS Shoqatat e dala nga lufta Organizatrat rinore Klubet sportive
35	Me qëllim të krijimit dhe lehtësimit të kushteve të punës për bibliotekën do të synojmë që të bëjmë digjitalizimin e bibliotekës	Krijimi i programit digjital	Mars- nëntor 2023	DKRS"
36	Përgatitja e shfaqjes teatrale	Ka karakter edukativ. Do të reprizohet disa herë për ta parë të gjitha shkollat Një Shfaqja teatrale për fëmijë	Mars-qershor 2023	DKRS
37	Përkujtimi i "Epopesë së UÇK-së"	-Homazhe -Program artistik -Gara në pikturë -Gara sportive shkollore Sesion apo tryezë shkencore me të rinjë, veçanërisht me nxënësit, me qëllim të njoftimit për heroizmin e familjes Jashari	5,6 dhe 7 mars 2023	DKRS Shoqatat e dala nga lufta Shkollat e mesme të ulëta dhe të larta

		5, 6 dhe 7 Mars Epopeja e UÇK-së		
38	Shënimi i "Ditës së Gruas" – 8 Marsit	-Program artistik -Orë letrare me poetet femra -Ndeshje hendbolli, volejbolli në konkurrencën e femrave -Dita e Gruas	8 mars 2023	DKRS Klubet sportive të femrave
39	Shënimi i "Ditës Botërore të Ujit"	-Fushatë vetëdijësuese për ruajtjen e ujit -Dita Botërore e Ujit	22 mars 2023	Organizatrat rinore
40	Orë letrare	-Organizim me anëtarët e bibliotekës -Orë letrare me lexues -Gara e recituesve -Dita e Bibliotekës	24 mars 2023	DKRS
41	Shfaqja teatrale	-Shfaqja premierë dhe reprizimi- i saj disa herë -Shfaqje komediale premierë për të rritur	Prill – dhjetor 2023	DKRS
42	Shënimi i "Ditës Botërore të Shëndetit"	-Fushatë vetëdijësuese për shëndet më të mirë	7 prill 2023	Drejtoria e Shëndetësisë DKRS Organizatrat rinore Shkollat e mesme të ulëta dhe të larta
43	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare të Çlirimit të të burgosurve"	-Tryezë e rrumbullakët me historianë dhe të përvuajtur nëpër burgje	11 prill 2023	DKRS Historianët Shoqata e të burgosurve politik Organizatrat jo qeveritare
44	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve të Kulturës"	Për nder të "Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve të Kulturës" më 18 prill, do të organizohen vizita monumenteve të kulturës në qytet dhe rrethinë.	18 prill 2023	DKRS Muzeu Historik Etnografik i Vushtrrisë
45	Shënimi i "Ditës së Tokës"	-Gara me piktore të rijnë	22 prill 2023	DKRS Organizatrat rinore

46	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare të Librit"	-Kampanjë vetëdijësuese nëpër shkolla Organizimi i një tryeze për rëndësinë e librit	23 prill 2023	DKRS Organizatrat rinore Shkollat fillore dhe të mesme
47	Organizimi i manifestimit "Zëri më i mirë" - Vushtrria 2023	-Selektimi i të rinjve me aftësi këndimi -Organizimi i finales dhe shpallja e fituesve	25 prill - 9 maj 2023	DKRS
48	Organizimi i vizitave edukative- studimore.	Organizimi i vizitave edukative dhe studimore me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në Vushtrri dhe rrethinë, me qëllim që nxënësit ti njohin më mirë pasuritë e vendit të tyre.	Maj-nëntor 2023	<ul style="list-style-type: none"> • DKRS • DKA
49	Shënimi i "Ditës ndërkombëtare të punëtorëve" 1 Maji	-Koncert muzikor -Zhvillimi i aktivitetit në ndonjërin nga bukuritë natyrore që ka Vushtrria -Promovimi i bukurive natyrore të qytetit	1 maj 2023	DKRS Organizatrat rinore
50	Përkuajtimi i masakrës së Studimes "Studimja 99"	-Homazhe -Akademi përkuajtimore në Studime -Turne memorial në shah "Studimja '99" -Masakra e Studimes (2 Maji 1999)	2 maj 2023	Institucionet komunale Shoqatat e dala nga lufta e UÇK
51	Shënimi i "Ditës së Evropës" – 9 Maj	-Turne në Futboll të Vogël -Gara në ese Gara në pikturë	9 maj 2023	SHPKFSSH Zyra për integritet Evropiane DKRS
52	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare të Muzeve"	-Për nder të "Ditës Ndërkombëtare të Muzeve" më 18 maj do të organizohet një aktivitet me nxënës në lokalet e muzeut (psh. pikturimi i objekteve muzeale nga nxënësit, etj.	18 maj 2023	DKRS Organizatrat rinore
53	Përkuajtimi i masakrës së Vushtrrisë "22 Maji"	Homazhe -Akademi përkuajtimore - Masakra e 22 majit (1999)	22 maj 2023	Shoqatat e dala nga lufta

54	Rujtja e Ambientit	-Pastrimi i shkollave, rrugëve, objekteve të ndryshme -Aksioni ta pastrojmë Kosovën	24 maj 2023	DKRS Organizatrat rinore Shkollat fillore dhe të mesme
55	Përkujtimi i masakrës së Familjes Gërxhaliu	-Homazhe -31 maj, Masakra ndaj familjes së Selatin Gërxhaliut.	31 maj 2023	DKRS Shoqatat e dala nga lufta e UÇK
56	-Dita Botërore kundër duhanit	-Kampanja vetëdijësuese me të rinjë Gara në pikturë		DKRS Organizatrat rinore
57	Shfaqja e dramës, Premierë	Do të ketë karakter edukativ, arsimor, social etj.	Qershor-dhjetor 2023	DKRS
58	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve" (1 Qershor)	-Festivali për fëmijë" -Turne në Basketboll, grupmoshat e Reja -Gara pikturë me fëmijë në shesh -Karnavali me personazhet e filmave vizatimorë -Interpretimi i pasurive muzeale nga fëmijët	1 qershor 2023	DKRS Shkolla e muzikës "Tefta Tashko Klubet sportive shkollat fillore
59	Përvjetori i themelimit të "Muzeut Historik-Etnografik (09.06.2005)"	Me rastin e përvjetorit të themelimit të "Muzeut Historik-Etnografik", muzeu në bashkëpunim me DKRS-në do të organizoj aktivitet me piktorë profesional për shënimin e kësaj ditë.	9 Qershor 2023	DKRS
60	Shënimi i "Ditës Botërore për dhuruesit të gjakut" (14 qershor)	-Dhurimi i gjakut në sheshin e qytetit Promovimi i vullnetarizmit	14 qershor 2023	DKRS Spitali Organizatrat rinore Qytetarët
61	Shënimi i "Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë" (17 qershor)	Homazhe -Parakalim përgjatë sheshit -Program kulturo-artistik -Hapja e ekspozitës -Orë letrare -Gara sportive shkollore Mbrëmje rinore me të rinj	17 qershor 2023	Shoqatat e dala nga lufta Organizatrat rinore SHPKF SSH

62	Manifestimi "Takimet e Poeteshave Shqiptare"	-Hapja e konkursit -Përzgjedhja e poezive -Pritja e poeteshave -Vizitë objekteve të trashëgimisë kulturore -Ora e madhe letrare -Shpallja e fitueseve	Qershor ose shtator 2023	DKRS Poetet Juria
63	Shënimi i "Ditës kundër narkotikeve"	-Kampanja vetëdijësuese me rini -Turne ne pingpong me karakter shtetëror per grupmoshat U-18 (Femra dhe meshkuj). Gara është e futur edhe ne kalendarin vjetor te garave te FPPK	26 qershor 2023	DKRS Organizata rinore FPPK KPP "Hasan Prishtina"
64	Shënimi i Ditëve të Diasporës	-Program Kulturo-artistik -Orë letrare -Vizitë trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Vushtrrisë -Organizimi i panairit artizanal	Korrik 2023	DKRS Organizatet rinore Klubet sportive
65	Organizimi i "Muajit të pikturës"	-Organizimi i muajit të pikturës me artistët e riinjë	Gusht 2023	DKRS Organizatet rinore Artistët
66	Shënimi i "Ditës ndërkombëtare të Rinisë"	-Koncert me rini -Kinema verore -Ekspozitë pikturash	12 gusht	DKRS Organizatet rinore
67	Shënimi i "Ditët e Rinisë"	Aktivitetet rekreative sportive Dita e Rinisë	Shtator	DKRS KVRL Organizatet Rinore
68	Shënim i "Ditës së Dëshmorëve të Kombit" për Komunën e Vushtrrisë	- Homazhe - Akademi përkujtimore - Hapja e ekspozitës me fotografi - Turneu Tradicional ne Hendboll "Jeton Tërstena-TOTA"	1 shtator 2023	DKRS Shoqatat e dala nga lufta Organizatet rinore Klubet sportive
69	Shënimi i "Ditës Botërore pa Makina" (22 shtator)	-Kampanjë për ruajtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit të biçikletave	22 shtator 2023	DKRS Organizatet rinore

70	Promovimi i patates	Organizimi i Festivalit të Patates	Tetor	DKRS DEBPZHR
71	Shënimi i "Ditës së Flamurit" 28 Nëntori	Homazhe - Program kulturo-artistik - Ekspozitë kushtuar 28 nëntorit - Garë në piktura - Garë në ese - Aktivitete sportive Basketboll, Hendboll, Futboll - Pingpong	28 nëntor 2023	DKRS Shoqatat e dala nga lufta Organizatrat rinore Klubet dhe OJQ
72	Shënimi i "Ditës Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar"	- Me rastin e shënimit të "Ditës Ndërkombëtare e Aftësisë së Kufizuar" më 3 dhjetor, do të organizohet turniri i futbollit, vizite trashëgimisë kulturore dhe muzeut, etj	3 dhjetor 2023	Shoqata e të Shurdhërve-Dega Vushtrri DKRS
73	Ruajtja dhe mbrojtja e monumentit të trashëgimisë kulturore	Restaurimi dhe rinovimi i objektit ish-Arkivi i vjetër i qytetit	Shtator	DKRS
74	Ubifikimi i gjytetit të Strocit	Gërmime arkeologjike në gjytetin e Strocit	Qershor Tetor	DKRS Instituti Arkeologjik i Kosovës
75	Promovimi i turizmit malor në Komunën e Vushtrrisë	Vizita në terrenet malore së bashku me klubet e ecjes me qëllim të njohjes së bukurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore në rrethinën e Vushtrrisë.	Mars Tetor	DKRS
76	Shpallja e "Sportistit të vitit 2023"	Organizim i ngjarjes ku do të shpallet sportisti i vitit	24 dhjetor 2023	• Sportistët nga Komuna e Vushtrrisë

GJEODEZI KADASTËR DHE PRONË

Aktivitetet që kanë për qëllim realizimin e prioriteteve

Nr.	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Kostoja	Pjesëmarrësit	Ndërlidhja
1	Drejtoria Gjeodezi e Kadastër	Shpronësim i pronave për realizimin e projekteve	Zhvillimi i procedurave të shpronësimit	Afati permanent	Ndikimi financiar nuk është përcaktuar me buxhet	Pjesëmarrësit tjerë Ministria e Financave	Ndërlidhja me realizimin e projekteve
Prioritet nr. 1 Shpronësimi							
prioritet nr. 2 Uzurpimet							
2		Objektivat Mbrojtja e pronës komunale	Zhvillimi i procedurave për lirim të pronës komunale të uzurpuar	Afati permanent	Ndikimi financiar Në Euro zero	Pjesëmarrësit tjerë Drejtoria e Inspeksionit	
3		Objektivat Zbatimi i Aktvendimeve lidhur me ndarjen e pronës nga Komisioni, të lëshuar nga Komisioni për komasacion	Futja e të dhënave në RDPP për zonat kadastrale në komasacion të përfunduar	Afati permanent	Ndikimi financiar Në euro zero	Pjesëmarrësit tjerë Agjensioni Kadastral i Kosovës	
4		Raportimi para Kuvendit të Komunës lidhur me pronat komunale	Informatë lidhur me pronat komunale të dhëna me qira	Muajt shtator	Ndikimi financiar, zero		
5		Lista e pronave të paluajtshme të Komunës	Përpilimi dhe azhurimi i listës të pronave komunale	Afati permanent	Ndikimi financiar zero euro	Pjesëmarrësit tjerë Drejtoria për Bujqësi	
5		Objektivat Ngritja e efikasitetit në punë	Përgjigjja në kohë ndaj kërkesave	Afati permanent	Ndikimi financiar Në euro zero		

URBANIZEM DHE MBROJTJETERMJDISIT

OBJEKTIVAT

- Mbështetja në zhvillimin e qëndrueshëm me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarë të komunës dhe brezave që do të vijnë
- Mbrojtja e Mjedisit
- Urbanizimi i qytetit
- Konservimi i zonës historike të qytetit

PRIORITETET

- Miratimi i Hartës Zonale
- Hartimi i Planit të Mobilitetit
- Rregullimi i Tregut të Gjellbër
- Rregullimi i sheshit & bulevardit “Adem Jashari”
- Identifikimi dhe rregullimi i Hapësirave Publike
- Rregullimi i Infrastrukturës
- Përgatitjet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032+

Aktiviteti	Perioda	Në bashkëpunim	Vërejtje
1	Janar Dhjetor	- Me të gjitha drejtoritë komunale që lidhet puna dhe aktiviteti i drejtorisë.	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
2	Janar- Dhjetor	Me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektionit	Spektori i Urbanizmit
3	Janar Dhjetor	- Me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë e Bujqësisë Drejtorinë e Inspektionit	Spektori i Urbanizmit dhe Planifikimit
4	Janar Dhjetor	- Me drejtorinë e Financave, Drejtorinë e Prokurimit dhe Drejtoritë tjera.	Spektori i Planifikimit

5	Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës	Janar Dhjetor	-	Me Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Prokurimit	Spektori i Planifikimit
6	Menaxhimi i Sistemit të Adresave në të gjithë territorin e komunës si në qytet ashtu edhe në fshatra, duke përfshirë në sistem edhe menaxhimin e kërkesave të ndryshme për ndryshime të kërkuara	Janar Dhjetor	-	Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	Spektori për sistemin e Adresave
7	Ndihmon në kujdesin për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë	Janar Dhjetor	-	Drejtorinë për Kulturë dhe Entin për Mbrojtjen Monumenteve Kulturo-historike të Kosovës	Spektori i Urbanizmit
8	Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë bazuar në PZHK 2016-2024	Janar Dhjetor	-	Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	
9	Inicimi i procedurave për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032+.	Shkurt-Qershor		Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	DUMM
10	Inicimi i procedurave për mbështetjen nga Un-Habitat për Hartimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban.	Janar-Shtator		Me të gjitha Drejtoritë dhe Institucionet tjera relevante	DUMM

MBROJTJE DHE SHPËTIM

Nr	Aktivitetet e planifikuara	Baza e planifikimit	Bartësit e aktiviteteve	Bashkëpunimi më:	Afati		Vërejtje
					Prej	Deri	
1	Azhurnimi i planeve; Vlerësimi i rrezikut nga Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Plani për Reagim Emergjent	Udhëzimi administrativ për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut	DMSH	Kryqi i Kuq, Policia e Kosovës, NJPZSH, si dhe të gjitha bizneset që inkorporohen në këtë Vlerësim	Gjatë vitit	Gjatë Vitit	
02	Planifikimi i resurseve njerëzore dhe teknike	Plani i punës	DMSH	Kryetarin e Komunës Drejtorit Komunale	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
03	Marrja e masave të nevojshme për parandalimin, zvogëlimin dhe sajimin e gjendjes të çdo dëmi që prek popullatën civile të mirat e tyre materiale dhe pronën	Plani i punës	DMSH	Drejtorit Komunale NJPZSH	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
04	Angazhimi për pastrimin dhe hapjen e Kanaleve nga vërshimet e ujit, pastrimin e rrugëve nga bora dhe largimin e pengesave eventuale gjatë situatave emergjente	Plani i punës	DMSH	Drejtoritë komunale	Gjatë vitit	Gjatë vitit	

05	Formimi dhe aftësimi i ekipeve vullnetarëve për MSH	Plani i punës	DMSH	OJQ- shoqëria civile, NJPZSH	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
06	Krijimi i partneritetit dhe strukturimi i formave të bashkëpunimit me institucionet, dhe agjensitë	Plani i punës	DMSH	Subjektet relevante	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
07	Të Identifikohen dhe vlerësohen problemet për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera	Plani i punës	DMSH	Të gjitha Drejtorit komunale Faktorët tjerë relevant	Gjatë vitit Përherë	Gjatë vitit Përherë	
08	Azhurnimi i listave të Zjarrfikëseve fillestar në njësitin e vullnetarëve si dhe pajisja e tyre me mjete materialo teknike	Plani i punës Ligji për mbrojtje nga zjarri	DMSH	NJPZSH ,Kryetarët e Bashkësive lokale	Prill	Shtator	
09	Organizimi i Punëtorisë për Procedurat Standarde Operative gjatë Rasteve emergjente	Plani i Punës	DMSH	Të gjitha subjektet që kanë obligim ligjor. NJPZSH	Qershor	Shtator	
10	Koordinimi i punëve rreth dhënies së lejeve për ndërtim, respektimi i standardeve për raste emergjente	Plani i punës, Rregullorja mbi ndërtim, Ligji i mbrojtjes nga Zjarri	DMSH	Drejtoria për urbanizëm Inspekcioni për ndërtim si dhe inspektorët e preventivës	Gjatë gjithë vitit	Gjatë gjithë vitit	
11	Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve dhe Menaxhimi i strehimoreve	Plani i punës	DMSH	Drejtoria e Urbanizmit	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
12	Ngritja e nivelit të gatishmërisë emergjente	Plani i punës	DMSH	Policia, 112,FSK, subjektet komunale, OJQ, etj.	Sipas nevojës	Gjatë vitit	

13	Zyra e Alarmit dhe koordinimit emergjent (ZAKE) informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënien e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë	Plani i punës Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera	DMSH	Qendrat e BL ku janë të vendosur radio lidhjet, (japin informata drejt nga tereni), Kryqi i kuq	Gjatë tërë vitit	Gjatë tërë vitit	
14	Pranimi, evidentimi dhe distribuimi i informatave	Plani i punës	DMSH	Subjektet relevante kompetente	Gjatë vitit	Gjatë vitit	
15	Renovimi dhe sigurimi i Licencave për radio-rrjetën komunale	Plani i punës	DMSH	ARKEP	Korrik	Gusht	
16	Intervenime me makineri të rëndë në raste emergjente si dhe në raste tjera ku identifikohen si rreziqe të mundëshme	Sipas situatës	DMSH	Zyrën e Kryetarit, Drejtoritë Komunale	Gjatë vitit	Gjatë vitit	

Mirëpresim propozimet për ndryshim dhe plotësim të këtij plani gjatë fazës së konsultimit publik.

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel. 038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Komisioni: Xhavit Mehmeti, Kryesues  Ismet Gashi, anëtar  Haki Maloku, anëtar 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Rregullore

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe kuvendit,

Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin për Draftim të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve e të ndarjes së mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione për persona juridikë - OJQ dhe ndihmë momentale për persona fizikë Nr 144/18 të datës 31.05.2018 në përbërje: Xhavit Mehmeti, kryesues, Ismet Gashi, anëtar dhe Haki Maloku, anëtar.

Komisioni ka përgatitur Draft Rregulloren në fjalë dhe ka zbatuar procedurat e konsultimit publik.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
KUVENDI I KOMUNËS



DRAFT

RREGULLORE (KKV) NR....

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORES NR. 144/18 TË DATËS
31.05.2018 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE
FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE
JURIDIKË — OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE FIZIKË

Tetor 2022

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (c) lidhur me nenin 17, shkronjat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 19, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 2022 miraton këtë:

RREGULLORE
(KKV) NR.... PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 144/18
TË DATËS 31.05.2018 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË
MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE
PERSONAVE JURIDIKË - OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE
FIZIKË"

Neni 1

Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për përcaktimin e kriterëve e të ndarjes së mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione për persona juridikë - OJQ dhe ndihmë momentale për persona fizikë. Nr 144/18 të datës 31.05.2018, si vijon:

Neni 2

Te neni 2, i Rregullores bazë, pas paragrafit 1.5 shtohet paragrafi 1.6. me këtë tekst: " Person i jashtëm fizik konsiderohet personi i cili nuk është banor rezident komunës së Vushtrrisë

Neni 3

Te neni 4 në paragrafin 2, pas pikës 2.2 shtohen pikat:

2.3 me këtë tekst: 'Për persona fizik në rastet e sëmundjeve të renda për trajtim jashtë vendit ndahen ndihma deri në dymijë euro (2000) €, dhe

2.4 Me këtë tekst: "Ne raste të fatkeqësive natyrore deri në pesëqindë euro (500) €".

Neni 4

Neni 8, paragrafi 2 riformulohet si vijon :

4.1 Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport (DKRS) formon Komisionin vlerësues për subvencionimin e personave juridikë - OJQ-të në vlerë deri në pesëqind (500) €, si dhe personave fizikë për realizimin e aktiviteteve të ndryshime kulturore, rinore dhe sportive (projekte-ide me karakter profesional, promovues, stimulues, tradicional, inovativ, kritik etj.), në vlerë deri në njëmijë euro (1000) € dhe i rekomandon kryetarit të komunës për miratim. Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarëve dhe ka mandat dy (2) vjeçar.

4.2 Paragrafi 10 te nenit 8 i shtohet edhe fjalia si në vijim:

Përfaqësuesit e jashtëm të komisionit vlerësues kompensohen në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €) për punën në komision vlerësues.

4.3 Në nenin 8, paragrafi 13 riformulohet si vijon, Drejtoria për shëndetësi dhe përkujdesje sociale propozon mjete financiare, ose pako ushqimore ne vlere deri ne dyqind (200) €, pas rekomandimit të komisionit vlerësues të DSHPS-së.

4.4 Paragrafi 15 i nenit 8 fshihet.

Neni 5

Paragrafi 1 i nenit 11 fshihen fjalët “ deri në treqind euro (300 €) ”

Neni 6

Neni 17 fshihet

Neni 7

Paragrafi 1, i nenit 18 riformulohet si vijon: “Personat juridikë - OJQ për të parashtruar kërkesë për subvencionim, duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar bazuar ne manualin për implementimin e Rregullores MF-nr.04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve ”

Neni 8

Neni 19, riformulohet si vijon:

1. Komuna mund të lidhë marrëveshje të mirëkuptimit me organizata dhe mekanizma vendor dhe ndërkombëtarë , përfshirë edhe persona fizikë për realizim të projekteve me interes për qytetarë e komunës së Vushtrisë me gjendje të rëndë ekonomike.

1.1. Kryetari i komunës vendos lidhur me marrëveshjet për bashkëfinancim për projektet në të cilat komuna merr pjesë deri në 49 % të vlerës së përgjithshme të projektit.

1.2 Kushtet dhe kriteret për përcaktimin e përfituesve të projekteve të tilla do të caktohen në marrëveshjen në mes të donatorit dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 9

Neni 25 fshihet

Neni 10

Neni 27 riformulohet si vijon:

1. Dokumentacioni i nevojshëm për parashtrimin e kërkesave për subvencione për persona fizik,

- 1.1. Kërkesa e arsyetuar
- 1.2. dokumenti identifikues;
- 1.3. certifikata e vendbanimit (për persona fizikë);
- 1.4. konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e parashtruesit të kërkesës.




Neni 11

1.Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Melihate Basholli – Latifi
Kryesuese e Kuvendit

Përgatitur nga,

Komisioni,

1. 
2. 
3. 



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRI

01 Nr. / Br. 144 / 18

Nr. i fq. / Bl. sh. - 15 -

Data: / Datimi 31.05.2018.

VUSHTRRI - VUSHTRRI



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë

**RREGULLORE (KKV) NR. 01/2018
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE
FINANCIARE NGA
FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE
JURIDIKË – OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE
FIZIKË**

Vushtrri, maj 2018

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c) lidhur me nenin 17, pikat (k, r dhe s) të Ligjit Nr. 03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Rregulloren MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 41, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018,, miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË NDARJES SË MJETEVE
FINANCIARE NGA
FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE PERSONAVE JURIDIKË -
OJQ DHE NDIHMË MOMENTALE PERSONAVE FIZIKË**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për persona juridikë - OJQ dhe ndihmë momentale për persona fizikë.
2. Kjo rregullore nuk vlen për kategori të tjera të personave juridikë, përveç atyre që kanë statusin e organizatave jo qeveritare me karakter jo përfitues.
3. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor të subvencioneve dhe transfereve për vitin aktual, komuna ndan mjete financiare buxhetore – ndihmë momentale për persona juridikë - OJQ dhe fizikë, në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Në vështrim të dispozitave të kësaj rregulloreje, këto përkufizime kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Subvencionet** – janë të gjitha transferet financiare të njëanshme, të pakthyeshme në llogari rrjedhëse të përfituesit (personave juridikë-OJQ dhe personave fizikë), për të cilat komuna nuk pranon kundërvlerë.
 - 1.2. **Persona juridikë** - janë vetëm organizatat jo qeveritare të karakterit jo përfitues.
 - 1.3. **Përfitues** – janë personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuar në Buxhetin e Komunës së Vushtrrisë dhe në pajtim me Ligjin për Buxhetin.
 - 1.4. **Banor rezident** – nënkupton personin që jeton dhe vepron prej pesë (5) viteve në Komunën e Vushtrrisë, si dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
 - 1.5. **LMFPP** – Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 3 **Limitet buxhetore**

Komuna e Vushtrrisë ndan subvencione, duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin për vitin fiskal, për të cilin ndahen subvencionet dhe vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4 **Rregullat e përgjithshme për parashtrimin e kërkesës për subvencion**

1. Komuna e Vushtrrisë ndan subvencione në shumën mbi pesëqind (500) € përmes thirrjes publike për aplikim për persona juridikë – OJQ, dhe mbi bazën e kërkesave për personat fizikë, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

2. Kryetari i komunës aprovon ndarjen e subvencioneve në këto limite:

2.1. Për persona juridikë – OJQ deri në pesëqind (500) €.

2.2. Për persona fizikë për ndihmë momentale për shërim mbi treqind (300) € deri në një mijë (1.000) €.

Neni 5 **Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve**

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna e Vushtrrisë zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike apo në raste të veçanta në fushën e shëndetësisë dhe ndihmës momentale në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Në thirrjen publike për ndarje të subvencioneve, përcaktohen qartë fushat e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e subvencioneve mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas kriterëve të parapara në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin e inicimit të procedurës për ndarjen e subvencioneve, organi duhet të sigurohet nga Zyrtari kryesor financiar, për disponueshmërinë e mjeteve financiare për realizimin e projektit ose ekzekutimin e vendimit, në të kundërtën konform nenit 37, paragrafi 1 të LMFPP-së, organizata buxhetore nuk ndërmer asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që tejkalon fondet e ndara.

Neni 6 **Subvencionimi i personave juridikë - OJQ**

1. Subvencionimi për persona juridikë – OJQ nga ana e Komunës së Vushtrrisë bëhet duke u bazuar në parimet si në vijim:

1.1. Konkurrenca;

1.2. Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi i aplikuesve, si dhe

gjithëpërfshirja gjinore e përfituesve;

- 1.3. Transparenca në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kritereve dhe procedurave, aplikimin dhe përzgjedhjen e përfituesve;
- 1.4. Kritere të caktuara më parë, të cilat mundësojnë vlerësimin e propozimeve dhe aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioritetëve të mbështetjes financiare;
- 1.5. Parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;
- 1.6. Respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në shfrytëzimin e fondeve publike;
- 1.7. Financimi përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë në interes të publikut.
- 1.8. Ruajtjen e pavarësisë së përfituesve;
- 1.9. Parandalimin e çfarëdo konflikti të interesit;
- 1.10. Sigurimin e dyshkallshmërisë (të drejtën e ankimit) në trajtimin e ankesave të aplikuesve, dhe
- 1.11. Parandalimin e financimit të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.

Neni 7

Planifikimi i mbështetjes financiare

1. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare planifikon mbështetje financiare në kuadër të buxhetit vjetor.
2. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare përgatit pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë – OJQ-të më së largu tridhjetë (30) ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.
3. Plani vjetor i mbështetjes financiare për personat juridikë – OJQ-të përmban:
 - 3.1. Informatën për organizatën buxhetore;
 - 3.2. Shumën e mbështetjes buxhetore për vitin fiskal;
 - 3.3. Fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për personat juridikë – OJQ-të;

- 3.4. Objektivat e mbështetjes financiare;
- 3.5. Numrin e përafërt të organizatave që do të përfitojnë;
- 3.6. Kohën e hapjes të thirrjes për aplikim, dhe
- 3.7. Kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.
4. Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), si ofrues i mbështetjes financiare duhet të publikojë në ueb faqen e vetë zyrtare, pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për personat juridikë - OJQ-të, më së largu pas dyzet e pesë (45) ditëve pas miratimit të buxhetit të Republikës së Kosovës.
 5. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin Vlerësues, i cili do të merret me vlerësimin e aplikimeve sipas thirrjes publike dhe të bëjë përzgjedhjen e përfituesve.
 6. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin e ankesave, i cili do të merret me trajtimin e ankesave eventuale të aplikantëve.
 7. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me persona juridikë – OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimin të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.
 8. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të sigurojë përkrahjen e nevojshme për Komisionin vlerësues, Komisionin e ankesave dhe zyrtarin apo ekipin për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke siguruar burimet e nevojshme financiare dhe administrative për zbatimin e suksesshëm të thirrjes publike dhe për monitorimin dhe vlerësimin e mbështetjes financiare.

Neni 8 **Komisionet vlerësuese**

1. Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare në vlerë mbi pesëqind (500) €, themelon Komisionin vlerësues, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, me mandat për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve.
2. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRR) formon Komisionin vlerësues për subvencionimin e personave juridikë – OJQ-të në vlerë deri në pesëqind (500) €, si dhe personave fizikë për realizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në gjashtëqind (600) €. Ky komision ka mandat dy (2) vjeçar, në përbërje prej tre (3) anëtarëve.

3. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (DSHPS) formon Komisionin vlerësues për subvencionimin e personave fizikë për ndihmë momentale për shërim dhe për furnizim me gjëra ushqimore. Ky komision ka mandat dy (2) vjeçar, në përbërje prej tre (3) anëtarëve.
4. Përbërja e komisionit (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), kohëzgjatja dhe mandati i tij caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës.
5. Komisioni vlerësues (në rastet e thirrjeve publike për mbështetje financiare), përbëhet nga pesë (5) anëtarë, dhe ka mandat dy (2) vjeçar, si në vijim:
 - 5.1. një (1) përfaqësues nga njësia përkatëse (drejtoria përgjegjëse), në kuadër të të cilit është planifikuar mbështetja financiare;
 - 5.2. dy (2) përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, të cilët do të zgjidhen përmes një thirrjeje publike, të cilën do ta bëjë ofruesi i mbështetjes financiare;
 - 5.3. dy (2) përfaqësues nga institucioni (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) që ofron mbështetje financiare, njëri nga të cilët duhet të jetë nga njësia përkatëse për buxhet dhe financa.
6. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit vlerësues nga paragrafi 5 i këtij neni, Komuna e Vushtrrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të parashehë me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit vlerësues, i cili ka konflikt të interesit.
7. Komisioni vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të komisionit.
8. Komisioni vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
9. Anëtarët e Komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
10. Me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës do të përcaktohet mënyra dhe shuma e kompensimit për dy (2) anëtarë e Komisionit vlerësues të përmendur në nënparagrafin 5.2 të këtij neni.
11. Kërkesat për ndarjen e subvencioneve nga paragrafët 2 dhe 3, paraprakisht i shqyrton Komisioni vlerësues i DSHPS-së, gjegjësisht DKRS-së, të cilët ia rekomandojnë Kryetarit të Komunës rastet e përzgjedhura për përfitim financiar.
12. Përbërjen e Komisionin vlerësues të DSHPS-së dhe DKRS-së si në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, drejtorët e drejtorive përkatëse ia propozojnë për aprovim Kryetarit të Komunës.

13. Drejtori i DSHPS-së propozon mjete financiare për shërim në vlerë deri në treqind (300) €, kurse për gjëra ushqimore deri në dyqind (200) € pas shqyrtimit të kërkesave dhe rekomandimit nga Komisioni vlerësues i DSHPS-së.
14. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300) € deri në një mijë (1.000) €, pas shqyrtimit, Komisioni vlerësues i DSHPS-së i rekomandon për aprovim Kryetarit të Komunës, konform kritereve të plotësuara të kësaj rregulloreje.
15. Drejtori/esha i/e DKRS-së propozon mjete financiare për aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive në vlerë deri në treqind (300) € pas shqyrtimit të kërkesave dhe rekomandimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së.
16. Për ndarjen e shumave mbi treqind (300) € deri në gjashtëqind (600) € për personat fizikë (të jashtëm), pas shqyrtimit nga Komisioni vlerësues i DKRS-së i rekomandohen për aprovim Kryetarit të Komunës, konform kritereve të plotësuara të kësaj rregulloreje.

Neni 9 Komisioni i Ankesave

1. Komuna e Vushtrisë, si ofrues i mbështetjes financiare që ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare, themelon komisionin e ankesave, i përbërë nga anëtarët që kanë përvojë dhe integritet, i cili ka për mandat shqyrtimin e ankesave të aplikantëve.
2. Komisioni i ankesave ka mandat të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për moskualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kritereve procedurale të parapara me këtë rregullore, si dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.
3. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe ka mandat dy (2) vjeçar.
4. Përveç anëtarëve të rregullt të Komisionit të ankesave nga paragrafi 3 i këtij neni, Komuna e Vushtrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të parasheh me vendim edhe një (1) anëtar rezervë, i cili do të zëvendësojë në rast nevojë anëtarin e Komisionit të ankesave, i cili ka konflikt të interesit.
5. Përbërja e komisionit caktohet me Vendim të Kryetarit të Komunës. Në Komisionin e ankesave nuk mund të marrin pjesë anëtarët, të cilët janë pjesë e Komisionit vlerësues dhe të emëruarit politikë.

Neni 10 Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë aplikuesit dhe parashtruesit e kërkesave

1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit (në cilësinë e personave juridikë - OJQ) mbi pesëqind (500) €, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- 1.1 të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizatën joqeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
 - 1.2 të jenë të pajisura me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionit ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
 - 1.3 të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
 - 1.4 të mos kenë pranuar mjete tjera nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
 - 1.5 të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- 2.Parashtruesit e kërkesave në cilësinë e personave juridikë deri në pesëqind (500) € duhet t'i plotësojnë kriteret e përmendura në nënparagrafët e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 11

Dokumentacioni për parashtrimin e kërkesave për persona fizikë

1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, parashtruesit e kërkesave (në cilësinë e personave fizikë) deri në treqind (300) € duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:
 - 1.1.Kërkesa, e cila duhet të parashtrohet në emër të personit me sëmundje;
 - 1.2.Raportet mjekësore specialiste që konstatojnë sëmundje të rëndë;
 - 1.3.Raporti për gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale;
 - 1.4.Dëshmi për gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale, të verifikuar nga komisioni i DSHPS-së (kartoni i socialit), dhe
 - 1.5.Dëshmi e shpenzimeve mjekësore apo shpenzimeve të terapisë.

Neni 12

Kushtet specifike

- 1.Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet t'i plotëson kushtet specifike konform nenit 11 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 13
Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike dhe aplikimit

1. Kriteret dhe procedurat e thirrjes publike dhe aplikimit, si dhe udhëzimeve dhe mënyrës së aplikimit për aplikantët, kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të aplikacioneve duhet të zbatohen konform neneve 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 14
Parandalimi i konfliktit të interesit

1. Komuna e Vushtrisë, si ofrues i mbështetjes financiare duhet të sigurojë shmangien e çfarëdo konflikti të interesit në rastin e marrjes së vendimit për aplikuesit (parashtruesve të kërkesave).

Neni 15
Afatet dhe procedurat e paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave

1. Kundër vendimit të Komisionit vlerësues, aplikantët mund të ushtrojnë ankesë në Komisionin e ankesave, si në vijim:

1.1. ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mospërmbushjes së kriterëve formale gjatë vlerësimit të aplikacionit në aspektin procedural, dhe

1.2. ankesë ndaj vendimit për ofrimin apo mos ofrimin e mbështetjes financiare.

2. Ankesat i drejtohen Komisionit të ankesave dhe duhet të dorëzohen brenda pesë (5) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

2.1 Komisioni i ankesave vendos mbi ankesën brenda pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të saj.

2.2 Komisioni i ankesave mund të nxjerr vendim për të pranuar ose refuzuar ankesën.

2.3 Vendimi i Komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative.

2.4 Vendimi duhet t'i dërgohet parashtruesit të ankesës dhe Komisionit vlerësues.

2.5 Komisioni i ankesave mban procesverbal për gjithë procesin e trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.

Neni 16

Kontrata me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit

1. Mënyra e hartimit të kontratës me përfituesin dhe metodologjia e monitorimit dhe raportimit duhet të bëhen konform neneve 22 dhe 23 të Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Neni 17

Rastet e përfitimit të subvencioneve, duke mos iu nënshtruar thirrjes publike

1. Rastet që përfitojnë subvencione, duke mos iu nënshtruar thirrjes publike janë:
 - 1.1. Personat juridikë – OJQ, deri në pesëqind (500) €.
 - 1.2. Personat fizikë për ndihmë momentale për shërim, deri në një mijë (1000) €.
 - 1.3. Personat e jashtëm fizikë, derë në gjashtëqind (600) €.
 - 1.4. Personat fizikë për ndihmë momentale për furnizim me gjëra ushqimore, deri në dyqind (200) €.

Neni 18

Dokumentacioni i nevojshëm për subvencionimin e personave juridikë - OJQ

1. Personat juridikë - OJQ për të parashtruar kërkesë për subvencionim, duhet ta dorëzojnë këtë dokumentacion:
 - 1.1. kërkesën me shkrim;
 - 1.2. dorëzimin e raportit për vitin paraprak, në rast të subvencionimit të mëhershëm;
 - 1.3. certifikatën e regjistrimit;
 - 1.4. arsyetimin e kërkesës;
 - 1.5. dokumentin identifikues të përfaqësuesit ligjor të personit juridik;
 - 1.6. numrin e llogarisë bankare të personit juridik.

Neni 19

Bashkëfinancimet

1. Komuna mund të lidhë marrëveshje të mirëkuptimit me institucione qendrore, organizata dhe mekanizma tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë (donatorë), përfshirë edhe persona fizikë për realizim të projekteve me interes publik për qytetarë (familje dhe individ) të Komunës së Vushtrrisë, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike, si në vijim:

- 1.1. Kryetari i komunës vendos lidhur me marrëveshjet për bashkëfinancim për projektet në të cilat komuna merr pjesë deri në 49 % të vlerës së përgjithshme të projektit.
 - 1.2. Kuvendi i komunës vendos lidhur me bashkëfinancimin për projektet në të cilat komuna merr pjesë 50 % e më tepër të vlerës së përgjithshme të projektit.
2. Kushtet dhe kriteret për përcaktimin e përfituesve të projekteve të tilla do të caktohen në marrëveshjen në mes të donatorit dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 20

Subvencionimi për pagesën e qirave në raste të rënda sociale (familjeve të pa strehë) dhe përfituesit e të drejtës për pagesën e qirasë

1. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës planifikimin buxhetor për pagesën e qirave për familjet në nevojë përmes aprovimit vjetor të buxhetit.
2. Komuna ka të drejtën e pagesës së qirave për familjet apo individët e Komunës së Vushtrrisë që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.
3. Numri i familjeve përfituese nga kjo kategori përcaktohet në pajtim me ndarjen buxhetore sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Të drejtën e subvencionimit e kanë banorët, të cilët në Komunën e Vushtrrisë janë rezident së paku prej pesë (5) viteve.
5. Qiraja e subvencionuar nga buxheti i komunës nuk mund të kalojë shumën prej njëqind (100) euro, për një (1) muaj.

Neni 21

Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për subvencionimin e qirasë të familjeve në nevojë

1. Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë për sigurimin e banimit për personat (rastet) e paraqitura janë:
 - 1.1 statusi i banimit;
 - 1.2 lartësia e të ardhurave;
 - 1.3 gjendja shëndetësore;
 - 1.4 invaliditeti, dhe
 - 1.5 struktura e familjes.

Neni 22

Përparësitë për zgjedhjen e përfituesve

1. Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve për subvencionim të qirasë kanë:
 - 1.1. familjet me shumë fëmijë;
 - 1.2. familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me nevoja të veçanta;
 - 1.3. familjet ku kryefamiljari është grua – mbajtëse e familjes;
 - 1.4. bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar, që nuk ka në përkujdesje fëmijë, dhe
 - 1.5. fëmijët me statusin e jetimit.

Neni 23

Afati për pagesën e qirasë së banimit

1. Pas aprovimit të propozimeve nga Kryetari i komunës, drejtori i DSHPS-së lidh kontratë me pronarin e banimit ku përfitues është familja apo individ i që i plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje.
2. Pagesa e qirasë së banimit nuk mund të bëhet më tepër se për pesë (5) vite. Përjashtim nga ky rregull kanë rastet që pas afatit prej pesë (5) viteve, komisioni vlerëson se duhet të vazhdohet qiraja edhe për dy (2) vite tjera. Ky afat kohor llogaritet nga 1 janari i vitit 2019.
3. Kontrata lidhet në afat një (1) vjeçar me mundësi të vazhdimit konform afatit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.
4. DSHPS-ja njofton përfituesin e subvencionit dhe qiradhënësin e qirasë së banimit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para përfundimit të afatit të kontratës së fundit (për herën e pestë) se komuna nuk do të vazhdojë t'i paguajë qiranë e banimit dhe nuk do të lidhë kontratë të re të banimit.

Neni 24

Rastet e ndërprerjes së subvencionit të qirasë (shkëputja e kontratës së qirasë)

1. Palës përfituese të subvencionit të qirasë, i ndërpritet e drejta për pagesë (shkëputja e kontratës së qirasë) kur:
 - 1.1. qiramarrësi ka bërë deklaram të rrejshëm për të ardhurat;

- 1.2. qiramarrësi ka përfituar një banesë tjetër dhe nuk e ka njoftuar organin kompetent të komunës;
- 1.3. qiramarrësi ia lëshon banesën me qira palës së tretë;
- 1.4. qiramarrësit i përmirësohet gjendja ekonomike, të cilin fakt e vlerëson në baza vjetore Komisioni Vlerësues i DSHPS-së;
- 1.5. qiramarrësit i punësohet njëri nga anëtarët e familjes me pagë mbi minimale, dhe
- 1.6. qiramarrësi i kalon pesë (5) vite nga momenti i lidhjes së kontratës, dhe komisioni nuk ka dhënë vlerësim pozitivë për vazhdimin e kontratës.

Neni 25

Subvencionimi nga fusha e rinisë, kulturës dhe sportit

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndanë subvencione për persona fizikë të jashtëm dhe persona juridikë-OJQ për projekte-ide me karakter: profesional, promovues, stimulues, tradicional, inovativ, kritik, praktik, ku përfshihen:

- 1.1. Aktivitetet kulturore;
- 1.2. Aktivitetet rinore, dhe
- 1.3. Aktivitetet sportive.

Neni 26

Rastet specifike për zgjedhjen e përfituesve

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, iu jepet përparësi rasteve specifike në vijim:

- 1.1. projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;
- 1.2. projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;
- 1.3. parashtruesve të kërkesave që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për kulturë, rini, sport të ndarë nga pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër.

Neni 27
Dokumentacioni për parashtrimin e kërkesave

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë parashtrimit të kërkesave për ndarje të subvencioneve janë:

- 1.1. projekt-propozimi;
- 1.2. formulari;
- 1.3. dokumenti identifikues;
- 1.4. certifikata e vendbanimit (për persona fizikë);
- 1.5. certifikata e regjistrimit (për persona juridikë);
- 1.6. dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.7. dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.8. dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridikë), dhe
- 1.9. konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e parashtruesit të kërkesës.

Neni 28
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1.Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 29
Dispozita shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen: Rregullorja për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale të Entiteteve Publike dhe Jopublike, me nr. 37/11 të datës 24/02/2011.

2.Në rast se ka mospërputhje në mes të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF – Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vlejnë dispozitat e kësaj të fundit.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1.Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

2. Petrit Dubovci - Propozitjone për studentët e familjeve të deklaruarve si këtu konkurrenca atë të familjeve të deklaruarve mbase studentët e komitetit jo shkencorë si këtu konkurrenca studentët e këtyre komitetit për se i përket përparisë për përfitim të burës

3. Esma Kajtazi - propozitjone për komuna të ndaj burse për student me të njëjtin nivel në vit

Takimi përfundoi në ora 14³⁵

Procesverbi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrm / Municipality of Vushtrri



Komisioni i draftimi te rregulloreve

Lista e pjesëmarrësve ne Konsultimn publik i mbajtur me 16/11/2022 ne Vushtrri

1. Draft – Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve te ndarjes se mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione pre personat juridik – OJQ-ve dhe ndihme momentale për personat fizik dhe
2. Draft – Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënskrimi
1.	Fatmir Dukoviq	Vushtrri Vushtrri		
2.	Violeta Caka	Vushtrri	044 105027	
3.	Blerim Ibrahimaj	Vushtrri	044 853252	
4.	Bujan Klinaq	K. Vushtrri		
5.	Valon Jashari	Vushtrri	045319860	
6.	Vilona Meko	Vushtrri	044847860	
7.	Emrita Hajtazi	Vushtrri	045 - 311 - 699	
8.	XHENTIANA ZEKA	VUSHTRRI	049 - 853 - 656	
9.	Blerim Jashari	Vushtrri Vushtrri	044-853-252	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr 03/2020 për Transparencë në Komuna, dhe nenin 5 par. 1, nenin 7 par. 1 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, me datën 31.10.2022 ipet ky:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Komisioni komunal i publikon për konsultim publik:

- 1. Draft - Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridik – OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizik, dhe
- 2. Draft – Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës.

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 01 nëntor 2022 deri më 02 dhjetor 2022. Ju bëhet ftesë qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve tjerë që gjatë kësaj periudhe kohore të i paraqesin sugjerimet, propozimet apo vërejtjet në draf-trregulloret e sipërshënuara, në adresën elektronike: xhavitmehmeti@hotmail.com.

Ju njoftojmë gjithashtu se me datën **16 nëntor 2022 (e mërkurë)** do të organizohet konsultimi publik me qytetarë lidhur me Draft rregulloret në fjalë.

Konsultimi publik do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës me fillim në ora 13:30.

Në shtojcë janë të bashkëngjitura Rregullorja bazë dhe Draft Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridik – OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizik, dhe Rregullorja bazë dhe Draft rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës.

Mirëpresim pjesëmarrjen në këtë takim publik.

Publikuar më 01.11.2022

Komisioni,

- 1.
- 2.
- 3.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel. 038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Komisioni: Xhavit Mehmeti, Kryesues  Ismet Gashi, anëtar  Haki Maloku, anëtar 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Rregullore

Të nderuar/a,

Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin për Draftim të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës Nr. 45/20 datë 28.05.2020, në përbërje: Xhavit Mehmeti, kryesues, Ismet Gashi, anëtar dhe Haki Maloku, anëtar.

Komisioni ka përgatitur Draft Rregulloren në fjalë, ka zbatuar procedurat e konsultimit publik ku janë dhënë propozime për ndryshim dhe plotësime. Propozimet janë shënuar në procesverbal që është bashkëngjitur në shtojcë të Draft Rregullores.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
KUVENDI I KOMUNËS



DRAFT

**RREGULLORE
PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORES PER NDARJEN E
BURSAVE PËR STUDENTË, NXËNËS DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS NR.45/20 TE DATES 28.05.2020**

Tetor 2022

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2 shkronja 'c', në lidhje me nenin 1.7 pika s të Ligjit Nr.03/1-40 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 19 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më2022 miraton këtë:

RREGULLORE
PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E RREGULLORES PER NDARJEN E
BURSAVE PËR STUDENTË, NXËNËS DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS NR.45/20 TE DATES 28.05.2020

Neni 1

1. Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblimeve për nxënës nr.45/20 të datës 28.05.2020.

Neni 2

Paragrafi 2 i nenit 4 të rregullores bazë fshihet.

Neni 3

Nenit 8 paragrafit 1 i shtohet pika 1.6 me tekst si vijon :

1.6 Deklaratë se aplikuesi nuk është përfitues i bursës apo pagës nga institucione tjera publike të financuara nga buxheti i Kosovës.

Neni 4

Paragrafi 6 të nenit 9 i fshihen fjalët “ dhe ia dërgon kryetarit të komunës”

Neni 5

Neni 10 riformulohet me sa vijon:

“Kriteret për përfitimin e bursës”

1. Kandidatët vlerësohen me pikë për suksesin e vitit paraprak akademik si në vijim:
2. Studenti me notë mesatare mbi 9-të, vlerësohet me 30 pikë
3. Studenti me notë mesatare mbi 8-të, vlerësohet me 25 pikë.
- 4 Studenti me notë mesatare mbi 7-të, vlerësohet me 20 pikë.
5. Studenti me notë mesatare mbi 6-të, vlerësohet me 15 pikë.
6. Studenti (fëmiu) i dëshmorit shpërblehet me bursë pasi që ti ketë plotësuar kushtet tjera të parapara me këtë rregullore.
7. Studenti (fëmiu) i të burgosurit politik vlerësohet me 5 pikë.
8. Studenti nga familja me asistencë sociale vlerësohet me 10 pikë.
9. Studenti (fëmiu) i martirëve, veteranëve dhe invalidëve vlerësohet me 5 pikë.

10. Studenti, i cili nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 5 pikë.
11. Studenti, që ka marrë mirënjohje apo certifikatë shtetërore, kombëtare apo ndërkombëtare e që ka arritur rezultate të larta, duke e zënë njërin nga tri vendet e para në ndonjë garë-konkursi në lëmin arsimor, vlerësohet me 5 pikë.
12. Studenti, që ka likuiduar vitin paraprak me afat të rregullt, vlerësohen me 5 pikë.
13. Studenti me nevoja të veçanta nuk u nënshtrohet kriterëve të këtij neni përveç që duhet ta ketë të regjistruar vitin akademik.
14. Studenti i cili i përket komuniteteve jo shumice vlerësohet me 5 pikë.
15. Në rastet kur dy kandidatë pas vlerësimit mbledhin pikë të barabarta, atëherë radha e përparësisë është kjo:
 - a) Kandidati me notë mesatare më të lartë pas presjes dhjetore;
 - b) për notë mesatare të njëjtë pas presjes dhjetore përparësi i jepet kandidatit që ka aplikuar i pari.

Neni 6

Neni 11 riformulohet me sa vijon:

Procedurat e ankesave

1. Çdo kandidat i pa kënaqur me rezultatin e komisionit për ndarje të bursave, ka të drejtën e ankesës te komisioni i ankesave, brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e publikimit të rezultateve.
2. Kryetari i komunës merr vendim për emërimin e komisionit ad-hoc tre anëtarësh, për shqyrtimin e ankesave.
3. Anëtarët e emëruar të komisionit janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë) nga të cilët një jurist, një zyrtar nga DKA-ja dhe i treti po ashtu nga administrata.
4. Nuk mund të jenë anëtarët të këtij komisioni, anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në ndarjen e bursave.
5. Vendimi për emërimin e komisionit publikohet në web-faqe të komunës dhe në tabelë të shpalljes.
6. Komisioni është autoritet vendimmarrës përfundimtarë i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve.
7. Komisioni për shqyrtimin e ankesave në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesat e ushtruara
8. Vendimet në emër të komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit.
9. Nga një kopje e vendimit i dergohet pales ankuese, komisionit për ndarje të bursave dhe DKA-se.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

QI Nr. / Bv 95/20

SHALLI / SHALLI - 5 -

Datë / Datë 28. 05. 2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

RREGULLORE
(KKV) NR.04/2020 NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË, NXËNËS
DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS

Maj, 2020

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "c", në lidhje me nenin 17 pika s të Ligjit Nr.03/I-40 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 41, paragrafi 2, pika "c", të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28 maj 2020** miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË, NXËNËS DHE SHPËRBLIMEVE PËR
NXËNËS TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

1. Me këtë rregullore themelohet baza juridike për ndarjen e bursave për studentë të nivelit baçelor, nxënës të shkollave profesionale dhe shpërblimeve për nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.
2. Caktohen kategoritë përfituese dhe rregullohet mënyra e dhënies së bursave dhe shpërblimeve.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Përfitues të bursave janë studentët të nivelit baçelor, të cilët studiojnë brenda vendit në universitete publike e që janë banorë të Komunës së Vushtrrisë.
2. Bursa për nxënës të klasës së dhjetë, drejtimi saldues dhe përpunim i drurit në SHMT "Lutfi Musiqi".
3. Përfitues të shpërblimeve janë: nxënësit e shkollave të mesme të larta, të mesme të ulëta të cilët kanë arritur rezultate të larta në provim të maturës, testin e arritshmërisë, gara, olimpiadanë nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Shpërblimi për nxënës** -- nënkupton shpërblimin e dhënë në të holla pa kthim, që Komuna e Vushtrrisë e ndanë për nxënësit e shkollave të mesme të larta, të mesme të ulëta të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe atë, në provim të maturës nxënësi që në nivel shkolla është i pari me rezultate, testin e arritshmërisë dhe atë tri vendet e para në nivel komune, kurse për nxënësit pjesëmarrës në gara, olimpiada në nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar për tri vendet e para.
 - 1.2. **Bursë** - Nënkupton ndihmën e dhënë në të holla pa kthim që Komuna e Vushtrrisë ndanë për studentët e nivelit baçelor që studiojnë në universitete publike brenda vendit dhe për nxënës të

klasës së dhjetë, drejtimi saldus dhe përpunim i drurit të cilët ndjekin mësimin në shkollat e mesme të komunës së Vushtrrisë.

1.3. DKA – nënkupton Drejtoria Komunale e Arsimit.

Neni 4

Bursa për studentë dhe nxënës

1. Përfitues të bursave janë studentë të rregullt, jo përsëritës të vitit, të cilët studiojnë në universitete publike në Kosovë, në nivelin beqelor dhe që janë banorë të komunës së Vushtrrisë.
2. Nga e njëjta familje, mund të jetë një përfitues i bursës.
3. Përfitues të bursës mund të jenë vetëm studentët që nuk janë përfitues të bursës apo pagës nga institucione tjera të buxhetit të Kosovës.
4. Dhënia e bursës fillon nga viti i dytë i studimeve.
5. Përfitues të bursës për nxënës janë nxënësit e klasës së dhjetë në SHMT "Lutfi Musiqi", drejtimi saldus dhe përpunim i drurit.
6. Bursa jepet një herë për një vit akademik apo për periudhën 1 tetor – 30 shtator për studentë dhe për një vit shkollor apo për periudhën 1 shtator – 31 gusht.

Neni 5

Shpërblime për nxënës

1. Përfitues të këtij shpërblimi janë nxënësit e mësimit të rregullt, që vijojnë mësimet në shkollat publike të Komunës së Vushtrrisë në nivelin e mesëm të ulët dhe nivelin e mesëm të lartë të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe atë:
 - 1.1. Nxënësi maturantë që në provim të maturës në nivel shkolla është i pari me rezultat.
 - 1.2. Nxënësit që në testin e arritshmërisë renditen në tri vendet e para në nivel komune me rezultat.
 - 1.3. Nxënësit pjesëmarrës në gara, olimpiada në nivel komunal, regjional, shtetëror dhe ndërkombëtar që renditen në tri vendet e para me rezultat.

Neni 6

Planifikimi i mjeteve për bursa

1. Në kuadër të kategorisë ekonomike "Subvencione dhe transefre" Kuvendi i Komunës çdo vit fiskal aprovon buxhetin për:
 - 1.1. Bursa për studentë.
 - 1.2. Bursa për nxënës.
 - 1.3. Shpërblime për nxënës.

Neni 7 Shpallja e konkursit për bursa

1. DKA është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave teknike pasi që kryetari i komunës të ketë nxjerrë vendim për numrin e bursave nëpër drejtime dhe shumën për një bursë, shpall konkurs publik për bursa dhe duhet ta ketë këtë përmbajtje:
2. Datën e fillimit dhe përfundimit të konkursit dhe dokumentet e nevojshme
3. Kriteret për konkurrim në pajtueshmëri me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 8 Dokumentet e nevojshme për konkurrim

1. Kërkojnë këto dokumente të nevojshme për bursa:
 - 1.1. Dëshmi e regjistrimit të klasës.
 - 1.2. Certifikatë e provimeve të dhëna.
 - 1.3. Deklaratë e bashkësisë familjare.
 - 1.4. Dëshmi se është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit të luftës, martirit të luftës, ish të burgosurit politik, është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja me gjendje të rëndë ekonomike-sociale.
 - 1.5. Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara –konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, në lëmin arsimor.

Neni 9 Komisioni për ndarjen e bursave

1. Kryetari i komunës nxjerr vendim për emërimin e komisionit 3 anëtarësh.
2. Kryetari dhe një anëtar i komisionit duhet të jenë zyrtarë nga DKA, ndërsa anëtari i tretë një jurist me përvojë nga administrata e komunës.
3. Komisioni mbledhet me ftesën e kryetarit të komisionit, më së largu 5 ditë nga mbyllja e konkursit.
4. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara me konkurs, eliminohen nga gara.
5. Përzgjedhja e kandidatëve për secilën kategori, bëhet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
6. Pas përfundimit të përzgjedhjes, jo më larg se 5 ditë nga dita e mbledhjes, komisioni i publikon rezultatet në tabelën e publikimeve, në Web-faqe të komunës, e shkruan dhe e nënshkruan procesverbalin e punës dhe ia dërgon kryetarit të komunës.
7. Pas kalimit të afatit për ankesa, komisioni i fton përfituesit e bursave dhe nënshkruan kontratë me ta.
8. Kontrata nuk merr obligim punësimin e bursistëve pas mbarimit të shkollimit-studimeve.
9. Kontrata obligon bursistët t'i përgjigjen DKA-së, sa herë që DKA-ja kërkon dokumente që përcjellin nivelin, vijueshmërinë dhe cilësinë e mësimeve-studimeve.
10. Komisioni në fjalë e informon Kuvendin e Komunës për tërë procesin e ndarjes së bursave.

Neni 10 Kriteret për përfitim e bursës

1. Kandidatët vlerësohen me pikë për suksesin e vitit paraprak akademik si në vijim:
2. Studenti me notë mesatare mbi 9-të, vlerësohet me 30 pikë
3. Studenti me notë mesatare mbi 8-të, vlerësohet me 20 pikë.
4. Studenti nga familja e dëshmorit shpërblehet me bursë pasi që ti ketë plotësuar kushtet tjera të parapara me këtë rregullore.
5. Studenti nga familja e të burgosurve politikë, vlerësohet me 5 pikë.
Studenti nga familja me asistencë sociale, vlerësohet me 5 pikë.
6. Studenti nga familja e martirëve, veteranëve dhe invalidëve, vlerësohet me 5 pikë.
7. Studenti, i cili nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 5 pikë.
8. Studenti, që ka marrë mirënjohje apo certifikatë shtetërore, kombëtare apo ndërkombëtare, e që ka arritur rezultate të larta, duke e zënë njërin nga tri vendet e para në ndonjë garë-konkursi në lëmin arsimor, vlerësohet me 25 pikë.
9. Studenti, që ka likuiduar vitin paraprak me afat të rregullt, vlerësohet me 5 pikë.
10. Studenti me nevoja të veçanta nuk u nënshtrohet kritereve të këtij neni, përveç që duhet ta ketë të regjistruar vitin akademik.
11. Në rastet kur dy kandidatë pas vlerësimit mbledhin pikë të barabarta, atëherë radha e përparësisë është kjo:
 - a) kandidati me notë mesatare më të lartë pas presjes dhjetore;
 - b) për notë mesatare të njëjtë pas presjes dhjetore përparësi i jepet kandidatit që ka aplikuar i pari.
12. Aplikacionet e studentëve, që kanë notë mesatare më pak se 8.00 nuk shqyrtohen.

Neni 11 Procedurat e ankesave

1. Çdo kandidat i pa kënaqur me rezultatin e komisionit për ndarje të bursave, gëzon të drejtën e ankesës tek komisioni i ankesave, brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore.
2. Kryetari i komunës nxjerrë vendim për emërimin e komisionit ad-hoc tre anëtarësh, për shqyrtimin e ankesave.
3. Anëtarët e emëruar të komisionit janë nga radhët e zyrtarëve të administratës së komunës (me përvojë), nga të cilët një jurist, një zyrtar nga DKA-ja dhe i treti po ashtu nga administrata.
4. Nuk mund të jenë anëtar të këtij komisioni, anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në ndarjen e bursave.
5. Vendimi për emërimin e komisionit publikohet në Web-faqe të komunës dhe në tabelë të shpalljeve.
6. Komisioni është autoritet vendimmarrës, përfundimtar i çështjes, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve.
7. Vendimet në emër të komisionit i nënshkruan kryetari i komisionit.
8. Çdo veprim shkruhet në 4 kopje në origjinal.
9. Një kopje i dërgohet kryetarit të komunës, një komisionit për ndarje të bursave, një palës që është ankuar dhe një vendim arkivit të komunës.
10. Afati për ankesa është 8 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve për përfitues të bursave.
11. Në vendim jepet edhe arsyetimi.

Neni 12
Dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese

1. Kjo rregullore miratohet nga Kuvendi i Komunës së Vushtrisë sipas procedurave për miratimin e akteve normative.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Ndarjen e Bursave dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrisë, 01 Nr: 86/15, datë 30.04.2015.

Neni 13

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 14
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu

Kryesuesi i Kuvendit



Procesverbal

Nga konsultimi publik me qytetarë për shqyrtim të:

1. Draft - Rregullorës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullorës nr. 01/2018 për përcaktimin e Kriterëve të Ndarrjes së Mjetëve Financiare nga Fondi për Transfer dhe Subvencione për Personat juridikë - OJQ-t dhe Ndihmë Monetare për Personat Fizikë
2. Draft - Rregullorës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullorës nr. 04/2020 për Ndarrjen e Bursave për Student Nënës dhe Shpërblime për Nënës

Takimi u mbajt me datën 16.11.2022, në ora 13³⁰ në Sallën e Kuvendit të Komunës

Prezent: shigo listën e nënshkrimit të pyetjeve, bashkëngjitur me shkopje

1. Fjalën hyjëse e porajti Kujdesi i Komitetit për Draftin të Rregullorës për subvencione...
Distributet:

- Blerim Ibrahim, propozoj që informimi i qytetarëve të bëhet përmes ^{dy ditë të reze të facebook-it pasi që fajja zyrtare e komunës këtu} ^{postimeve} ^{potencionalisht}
2. Udhur me Draft - Rregullorën për ndarjen e bursave:

Blerim Ibrahim - propozoj që të kriteret për ndarje të bursave (nëse 10 pikë nr. 8 i rregullorës baze, në vend të "25 pikë" të jetë "15 pikë", ~~që~~ Komiteti ka propozuar 5 pikë në vend të "25 pikë"

Vildane Mulaku: nuk u pajtua me propozimin e komitetit për draftin të rregullorës i cili tash për komunitetin jo shumicë (studentë) si kriter është parajsa të ipen 5 pikë, ^{shtesë} ~~me~~ ky mospajtim u arsyetua me faktin që krijohet pabarazi në mes pjesëtarëve të komunitetit.

Blerim Ibrahim propozoi rishte i të njëjtit mendim që të mos iu njëhet e dyta në 5 pikë shtesë për komunitetin jo shumicë - në krah të kriterëve të përcaktuar për ndarje të bursave.

2. Petrit Dabovci - Propozitj qe studentit e familjeve te detyrohen te ken konkurent ate te familjeve te detyrohen me te studentit e komitetit jo shume te ken konkurent studentit e ketij komunitet. per se i perbat perparise per perjetim te bursat
3. Ennira Kajtazi - propozitj qe komuna te ndaj bursa per student me teper se 1 here ne vit


Takimi perfundimor me ora 14 35

Procesverbaljen





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrm / Municipality of Vushtrri



Komisioni i draftimi te rregulloreve

Lista e pjesëmarrësve ne Konsultimn publik i mbajtur me 16/11/2022 ne Vushtrri

1. Draft – Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin dhe rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për personat juridik – OJQ-ve dhe ndihme momentale për personat fizik dhe
2. Draft – Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nr. telefonit	Nënskrimi
1.	Ferit DUKOVI	Vushtrri Vushtrri		<i>Ferit</i>
2.	Violeta Caka	Vushtrri Vushtrri	044 105027	<i>Violeta</i>
3.	Blerina Brocushina	Vushtrri	044 853252	<i>Blerina</i>
4.	Bujar Këllay	K. Vushtrri		<i>Bujar</i>
5.	Velon Jashari	Vushtrri	045 319 800	<i>Velon</i>
6.	Vilona Melekaj	Vushtrri	044 847860	<i>Vilona</i>
7.	Enrita Hajtozi	Vushtrri	045 - 311 - 699	<i>Enrita</i>
8.	XHENTIANA ZEKA	VUSHTRRI	049 - 853 - 656	<i>Xhentiana</i>
9.	Blerta Jashari	Vushtrri		<i>Blerta</i>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, dhe nenin 5 par. 1, nenin 7 par. 1 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, me datën 31.10.2022 ipet ky:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Komisioni komunal i publikon për konsultim publik:

- ➔ Draft - Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondit për transfere dhe subvencione personave juridik - OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizik, dhe
- ➔ Draft - Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 01 nëntor 2022 deri më 02 dhjetor 2022. Ju bëhet ftesë qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve tjerë që gjatë kësaj periudhe kohore të i paraqesin sugjerimet, propozimet apo vërejtjet në draft-irregulloret e sipërsënuara, në adresën elektronike: shavrimchmeti@komuna.com.

Ju njoftojmë gjithashtu se me datën **16 nëntor 2022 (e mërkurë)** do të organizohet konsultimi publik me qytetarë lidhur me Draft rregulloret në fjalë.

Konsultimi publik do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës me fillim në ora 13:30.

Në shtojcë janë të bashkëngjitura Rregullorja bazë dhe Draft Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2018 për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondit për transfere dhe subvencione personave juridik - OJQ-ve dhe ndihmë momentale personave fizik, dhe Rregullorja bazë dhe Draft rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 04/2020 për ndarjen e bursave për student, nxënës dhe shpërblime për nxënës.

Mirëpresim pjesëmarrjen në këtë takim publik.

Publikuar më 01.11.2022

Komisioni,

- 1.
- 2.
- 3.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Komisioni: Xhavit Mehmeti, Kryesues  Islam Latifi anëtar  Haki Maloku, anëtar 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Rregullore

Të nderuar/a anëtar/e të KPF dhe Kuvendit,

Kryetari i Komunës ka themeluar komisionin për Draftim të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 11/20 datë 25.06.2020 në përbërje: Xhavit Mehmeti, kryesues, Islam Latifi, anëtar dhe Haki Maloku, anëtar.

Komisioni ka përgatitur Draft Rregulloren në fjalë dhe ka zbatuar procedurat e konsultimit publik.

Draft Rregullorja ju dërgohet për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt,



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 15 pika 1.8 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-60, nenin 8 shkronja a) të Ligjit nr. 03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 miraton këtë:

DRAFT - RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë Nr.05/2020, prot. nr. 115/20, datë 25.06.2020.

Neni 2

Në nenin 7, paragrafi 5 riformulohet si vijon:

„ Ekonomitë familjare të cilat ngarkohen me tarifë të energjisë elektrike në shumën totale prej pesëmbëdhjetë (15.00 €) të njëjtat obligohen për të paguar tarifën vjetore të mbeturinave në vlerën tetëmbëdhjetë euro në vit (18.00 €). Ky paragraf vlen vetëm për qytetarët jo rezident të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 3

Shtojca e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë Nr.05/2020, prot. nr. 115/20, datë 25.06.2020, riformulohet si vijon:

1. Tarifa për amvisëritë, konsumatorët e rregullt (kategoria A):
 - 1.1. Zona Urbanenga 4.4 € në muaj në 6.00 € në muaj
 - 1.2. Zona Ruralenga 4.4 € në muaj në 6.00 € në muaj
2. Tarifa për amvisëritë nga Diaspora (D):
 - 2.1. Zona Urbanenga 13.20 € në vit në 18.00 € në vit
 - 2.2. Zona Rurale nga 13.20 € në vit në 18.00 € në vit
3. Tarifa për biznese dhe lokale tjera afariste:
 - 3.1. Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 01-20 m2nga 5.30 € në 7.00 € në muaj
 - 3.2. Lokalet e bizneseve me hapësirë prej 21-50 m2 ..nga 11.70€ në 15.00 € në muaj

- 3.3. Lokalet e bizneseve me hapësirë mbi 50 m²nga 23.50 € në 25.00 € në muaj
4. Tarifa minimale për institucionet publike dhe bizneset e shkallës më të lartë bëhen me kontraktim individual me kontraktuesin e shërbimit.
- 4.1. Kostoja e kontejnerit 1.1 m³nga 11.50 € 14.00 € për zbrazje
- 4.2. Kostoja e kontejnerit 7.0 m³nga 50.68 € në 60.00 € për zbrazje

Neni 4

Për zbatimin e kësaj rregullore obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe do të zbatohet nga data 01 janar 2023.

Arsyetim

Bazuar në Ligjin për mbeturina, komuna është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë përcaktimin e tarifës dhe mënyrës për inkasimin e mjeteve financiare për shërbimet e komunale, prandaj edhe është bërë përcaktimi i tarifës për këto shërbime. Mirëpo pas ngritjes enorme të çmimeve të derivateve dhe mirëmbajtjes së mekanizmit, është paraqitur nevoja e rishikimit të çmimeve ekzistuese dhe propozimit të ngritjes së tarifës për këto shërbime, prandaj duke u bazuar në nenin 7 paragrafin 11 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë nr.05/2020, prot. nr. 115/20, datë 25.06.2020, është bërë rishikimi i tyre dhe propozimi për ngritjen e tarifave.

Njëkohësisht ky rishikim vjen si rezultat i kërkesës së Ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave KRM „UNITETI”.

Bazuar në të cekurat më sipër i propozohet kuvendit të komunës që ta miratoj këtë Draft – Rregullore si në tekstin e mësipërm.

Komisioni:

1. 
2. 
3. 



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr 03/2020 për Transparencë në Komuna, dhe nenin 5 par. 1, nenin 7 par. 1 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, me datën 25.11.2022 ipet ky:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Komisioni komunal e publikon për konsultim publik Draft - Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 25 nëntor 2022 deri më 26 dhjetor 2022.

Ju bëhet ftesë qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve tjerë, që gjatë kësaj periudhe kohore të i paraqesin sugjerimet, propozimet apo komentet në Draft-Rregulloren e sipërhënuar, në adresën elektronike: islam.fatih@vuk.com.net.

Ju njoftojmë gjithashtu se me datën 20 dhjetor 2022 (e martë) do të mbahet takim publik me qytetarë lidhur me Draft rregulloren në fjalë në të cilën mund të paraqiten propozime për ndryshim apo plotësim.

Takimi publik do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës me fillim në ora 11:00.

Në shtojcë mund të gjeni të bashkangjitur Draft - Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.


Mirëpresim pjesëmarrjen në këtë takim publik.

Komisioni:

- 1.
- 2.
- 3.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovicë



Datë:	18.11.2022
Për:	z. Bedri Hamza, Kryetar i Komunës së Mitrovicës z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderajt
Nga:	Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh. A
Lënda:	Kërkesë

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Kompania Regjionale për Grumbullimin e Mbeturinave "Uniteti" Sh. A Mitrovicë, është ndërmarrje Publike me vetfinancim e specializuar dhe e licencuar për kryerjen e shërbimeve me rëndësi të veçantë shoqërore për bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike. KRM "Uniteti" Sh. A, operon me shërbimet e veta në Komunitet: Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 18.11.2022, në selinë e Kompanisë ka diskutuar lidhur me situatën emergjente të krijuar nga greva e punëtorëve të cilët kërkojnë ngritje të pagave.

Duke u nisur nga fakti se vendi ynë po kalon nëpër një situatë të vështirë financiare, ku çdo ditë shohim ngritje të çmimeve në të gjitha sferat e ekonomisë, qofshin ato për shkak të faktorëve të jashtëm apo të brendshëm, kjo ngritje e çmimeve ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në veprimtarinë tonë si kompani ku kemi përjetuar ngritjen enorme të çmimeve të derivateve të naftës, vajrave motorike, pjesëve mekanike të kamionëve etj., gjë që ka shkaktuar vështirësi në përmbushjen e detyrave tona si kompani.

Shto faktin se punëtorët tanë këto punë i kryejnë duke pranuar me një pagesë jo të mjaftueshme bazuar në rrethanat ekonomike, po kjo me të cilën nuk arrijnë ti përmbushin nevojat elementare për ta dhe familjet e tyre. Të njëjtit me datë 14.11.2022 para selisë së KRM "Uniteti" Sh. A, kanë hyrë në grevë një (1) orësh, ndërsa me datë 15.11.2022 i njëjti veprim është ndërmarrë në të tri Njësitë e Kompanisë në Komunitet përkatëse, me kërkesë që të ngritet tarifa mujore e faturimit, pasi që kjo ngritje do të ndikonte direkt në rritjen e buxhetit të Kompanisë e si pasojë e kësaj rritje do të krijohet bazë e mjaftueshme edhe për ngritjen e pagave për këta punëtor. Të njëjtit kanë paralajmëruar se në rast të mos ngritjes së tarifave do ta bojkotojnë punën në grumbullim të mbeturinave.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovicë

Pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar si dhe gjendjes financiare të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve ka vendosur që ti drejtohet komunave aksionare që të mbështesin kërkesën e punëtorëve tanë, që tarifa për ekonomi familjare të ngritët në minimum prej 6.00 €, derisa tarifat për biznese dhe institucione të ngritën për 20%.

Parapakisht ju falënderojmë për mirëkuptim!


Bordi i Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh.A – Mitrovicë

Fatmir Hyseni 

Kushtrim Januzi 

Liridon Hajdini 

Faton Zekaj 

Gazmend Morina 



PUNTORËT E SEKTORIT TE OPERATIVES NJESIA MITROVICE, KERA

QË PËR SHKAK TË SITUATES SË VESHTRE FINANCIARE NË TË CILEN
LIDHJENI, INFLACIONIT TË MADHË NË VITIN E FLUIDIT, PAGES SHUM
TË ULËT TË CILEN E MARRIN DHE PUNËS SHUMË TË VESHTIRE TË
CILEN E KRJEJNE QDO DITE, TË NGA NGRITEN PAGAT NË UJË NA
TË KONSIDERUESHME NË MENDJE QË NË TË MUND TË MBLIETOJME
NË TË KUVERTEN NË NUK DO TË MUND TA PERBALDOJME, AS
UDHETIMIN E AS USHQIMIN DITOR.

NË SI PUNTORE TË KOMPANISE JEMI NË NJOHURI PËR VESHTERS
FINANCIARE NË TË CILEN GJKIDET KOMPANIA E JOME, DHE
KERROJME NGA MENAXHMENTI I KOMPANISE QË SA NË PARE
TË MIRREN VESHE ME KOMUNEN E MITROVICES PËR NGRITJE
E TARIRES MUJORE PËR ERONOMITE FAMILJARE NË SHERBI.
PËR MBETURINA NË MENDOJME SE KJO ESHTË ZGJEDHAJA
VETME E CILA DO TË NA MUNDËSONTE NGRITJEN E PAGAVE
NË SI PUNTORE KERROJME NGA DREJTORIA E KRM, UNITETI
MITROVICE QË KETE KERKESË PËR NGRITJEN E PAGES TA
PERCJELLE EDHE NË K.R. MITROVICE.

KERROJME NGA K.R. MITROVICE QË DERI NË JANAR V. 20
TË BEJE NGRITJEN E TARIRES MUJORE PËR SHERBIMIN TË
CILIN E KRJEJNE NDAJ ERONOMIS FAMILJARE.
NESE DERI NË KETE AFAT NUK DO TË KETE LEVIZJE NGA
KOMUNA E MITROVICES NË KETE DREJTIN, ATËHERE NE SI
PUNTORE JEMI TË DETYRUAR TA NDALOJME PUNEN NË
TEREN, DHE TË FUTEMI NË GREVE. PAS KESAJE NË
PERVEQ PROTESTES PARA UNITETIT DO TË PROTESTOJME
EDHE PARA UDERTES SË KOMUNES SË MITROVICES DERI NË
REALIZIMIN E KERKESAVE TONA

PER DREJTORINE K.R.M UNITETI
MITROVICE

DHE K.R. MITROVICE



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: KPF dhe Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës *A. P. D. U. W. A.*
Hartues: Drejtoria për Arsim _____
Tema: Propozim – vendim _____

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-0409, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën _____ 2022 merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË PAGESËS PËR FËMIJË PARASHKOLLOR NË ÇERDHEN E FËMIJVE “FOLEJA” NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim caktohet pagesa prej pesëdhjetë euro (50.00 euro) për muaj, për një fëmijë parashkollor, për shërbimet të cilat ofrohen në Çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtri.
2. Pagesa për dy e më tepër fëmijë të një qifti bashkëshortor caktohet në vlerë prej dyzet euro (40.00 euro) në muaj, për një fëmijë.
3. Pagesa e shumës nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi bëhet në llogarinë bankare të komunës, në fillim të çdo muaji e më së largu deri me datën 05 të secilit muaj.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtori/esha i/e Çerdhes.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01 NR.715/04, datë 30.09.2004.
6. Vendimi hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Përcaktimi i lartësisë së pagesës për shërbimet që i ofron për fëmijët parashkollor çerdhja e fëmijëve "Foleja" në Vushtri është bërë me vendim të kuvendit të komunës në muajin shtator 2004, në lartësi prej 30 euro, dhe ky çmim është edhe tani.

Duke qenë se që nga atëherë kemi ngritje enorme të çmimeve të artikujve ushqimorë dhe rritje të shpenzimeve tjera, komuna ka vështirësi në mbulimin e shpenzimeve të nevojshme ditore.

Çmimet në çerdhet e sektorit privat siç dihet janë disa herë më të larta në krahasim me ato në sektorin publik.

Marrë parasysh faktet që u cekën më lartë, është se nevojshme që këto çmime të ngriten ashtu siç janë propozuar në këtë propozim vendim.

Nga se u cek më lartë i propozohet kuvendit të komunës që ta miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

PËR/ZA/TO:	KPF dhe Kuvendin e Komunës
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Ferit Idrizi Kryetari i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Nismë për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Skënderajt

Të nderuar anëtar/e të KPF dhe Kuvendit,

Ju drejtohem me kërkesë që në mbledhjen e kuvendit të komunës të miratoni nismën për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Skënderajt.

Komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës së Jugut dhe Skënderajt në muajin shtator 2022 kanë iniciuar procesin e bashkëpunimit me qëllim të krijimit të sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet hartimi i Planit Regjional për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave. Me këtë Plan do të definohet strategjia e përbashkët për menaxhimin e integruar të mbeturinave në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi, me Standarde Evropiane si dhe me objektivat e Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2021-2030.

Fasilitues në këtë proces është GIZ-i Gjerman i cili në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane dhe BE-në janë duke ofruar mbështetje në përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave drejt menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Në shtojcë ju dërgojmë propozim vendimin për këtë projekt, për shqyrtim dhe miratim.

Me respekt!



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës G. P. D. D. D.
Hartues: Drejtoria për Shërbime Publike J. M. M. M.
Tema: Propozim vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 7 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011), nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr.1618/22 datë 07.12.2022 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Skënderajt..
2. Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që pas konsultimeve me Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Skënderajt të përgatis Draft Marrëveshjen e Mirëkuptimit për menaxhimin e integruar të mbeturinave për këto tri komuna.
3. Draft marrëveshja e hartuar në tekstin final, i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim bazuar në procedurat e caktuara ligjore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Melihate Basholli Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës së Jugut dhe Skënderajt në muajin shtator 2022 kanë iniciuar procesin e bashkëpunimit me qëllim të krijimit të sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet hartimi i Planit Regjional për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave. Me këtë Plan do të definohet strategjia e përbashkët për menaxhimin e integruar të mbeturinave në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi, me Standarde Evropiane si dhe me objektivat e Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2021-2030.


Fasilitues në këtë proces është GIZ-i Gjerman i cili në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane dhe BE-në janë duke ofruar mbështetje në përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave drejt menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Me qëllim të implementimit të kësaj nisme palët do të pajtohen që të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përmes nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit për këtë qëllim.

Bazuar në të cekurat më sipër i propozohet kuvendit të komunës që t'a miratoj këtë propozim vendim si në diapozitiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRI SË

Raport vjetor i zbatimit të Planit të integritetit per vitin 2022

Pergatitur nga:

Xhavit Mehmeti,

Zyrtar per Integrim Evropian

Dhjetor, 2022

Hyrie

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kunder Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Vushtrise, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2020 - 2022.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të organizatës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës. Plani rihekson përkushtimin e komunës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollat ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, janë fokusuar në ofrimin e shërbimeve efektive, transparente dhe të orientuar kah klienti.

Plani i integritetit ka mundësuar:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizate individuale;
- Vlerësimin e çfarëdo lloji rreziku që mund të parages rrezik për shtaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale; dhe
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

Parimet e menaxhimit të Integritetit

Menaxhmenti i këtij plani ka demonstruar një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin, nga ata që të udhëheqin procesin gysht nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

Pjesëmarrja e secilit punëtorë ka gene shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe

koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cënueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cënueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cënueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

		Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësi për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit				Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit	Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e organeve komunale	Është ne proces te plotësimit
		Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit				Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit së paku dy herë në vit.	Mekanismat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës	Do te rri-caktohet përgjegjësi
						Të rishikohet niveli i zbatimit dhe përditësohen masat për përmirësim.	Menaxheri i integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit.	Çdo gjashtë muaj
						Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	çdo dhjetor të vitit është hartuar ky plan
						Vlerësimi objektiv për rezultatet e punës së zyrtarëve brenda vitit.	Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	Është realizuar për çdo vit në vazhdimësi vlerësim dhe planifikim te trajnimeve
						Të bëhet analiza e nevojave për trajnime	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive	
						Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave		
						Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura		
						Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për	Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe	Është ne proces sepse ka pas
2.	POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE	Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm	Ligjet, aktet nënligjor, dhe aktet e brendshme të komunës			Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarave.		
		Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve						

	<p>të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuar</p>				<p>organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.</p>	<p>udhëheqësit e sektorëve.</p>	<p>paqartësi me ligjin e pagave dhe zyrtareve publik</p>
<p>Mungesa e kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit.</p>				<p>Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës.</p>	<p>Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe sektorëve</p>	<p>Është hartuar dhe miratuar kodi i etikës</p>	
<p>Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës</p>				<p>Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit</p>	<p>Kryetari i komunës dhe Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve</p>	<p>Është miratuar në vitin, 2020</p>	
				<p>Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmëbajjen e Kodit.</p>	<p>Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve</p>	<p>Te gjithë zjarrtave i u është shpërndarë dhe WEB</p>	

	Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent				Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve	Kryetari i komunës dhe drejtorja për buxhet dhe financa	Në vazhdimësi
				Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore.	Drejtorja për buxhet dhe financa	Në vazhdimësi	
Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i asetëve komunale				Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës	Njësia për informim	gjate tere vitit	
				Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit.	Kryetari i komunës dhe Drejtorja për buxhet dhe financa	Në vazhdimësi gjate tere vitit	
				Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit	Drejtorja për buxhet dhe financa	Në vazhdimësi gjate tere vitit	
				Të përditesohet regjistri i brendshëm i asetëve të komunës	Drejtorja për buxhet dhe financa	Në vazhdimësi gjate tere vitit	
4. RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACI ONIT	Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare	Ligjet, aktet nënligjor, dhe aktet e brendshme të komunës.		Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative	Kryetari i komunës, Drejtorja e Administratës dhe sektori i TIK	I monitoruar r vazhdimësi	
				Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rezikut nga mashtrimet dhe	Drejtorja e Administratës dhe sektori i TIK	Në vazhdimësi	

		Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve			Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive	Komisioni dhe plani për rekomandi met e auditimit për çdo vit është realizuar.
		Mungesa e koordinimi ndërmjet Njesisë së AB, Komisionit të Auditimit dhe Kryetarit			Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit	Drejtorët e drejtorive	Në vazhdimësi
					Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njesisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale.	Kryetari i komunës, Njësia e AB, Komisioni i Auditimit	Në vazhdimësi komunikim i është në nivel të duhur
2.	PROKURIMI PUBLIK	Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit	Ligjet, aktet nënligjor, dhe aktet e brendshëm të komunës		Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Cdo here duke u bazuar në legjislacion in ne fuqi
					Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik	Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi nga komuna edhe institucion e tjera

		Mos transparencë dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik				Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës	Njësia e prokurimit	Çdo vit, pas miratimit të planit të prokurimit
						Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit	Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit	Mekanizë i mjaftueshëm ligjore në ofertimin online.
3.	MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE	Mungesa e stafit profesional për menaxhimin kontratave	Ligjet, aktet nënligjor, aktet e brendshme të komunës			Menaxhimi i kontratave nga zyrtarët me kompetencë profesionale	Kryetari i komunës Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi me nevojën për profesionistë të fushave
						Trajnimi i zyrtarëve për menaxhimin e kontratave		Janë organizuar nga komuna dhe institucionet tjera
4.	ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUIQËSIA	Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal				Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës	Kryetari i komunës, Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	E miratuar nga Kuvendi i komunës

	Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente.			Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal.	Kryetari i komunës, Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	Janë përcaktuar me buxhetin e komunës
Kritere jo të qarta dhe transparencë të pamjaftueshme në ndarjen e subvencioneve për zhvillim e bujqësisë dhe sektoreve tjerë	Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal			Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve	Kryetari i komunës; Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	Rregullore komunale për subvencion e miratuar dhe rregulloja 2017/4 MF Në vazhdimësi vazhdimësi ne thirrje publike
				Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal	Kryetari i komunës; Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

		Mbikëqyrja jo efektive mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal			Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal	Kryetari i komunës, Drejtorja për Zhvillim Ekonomik	
5.	PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL	Mangësi në rregullatven e brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural	Ligjet, aktet nënligjor, aktet e brendshme të komunës dhe planet rregullativ e urbane		Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë reziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive	Kryetari i komunës, Drejtorja për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Në vazhdimësi
		Zbatim jo i plotë i rregullatves së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural			Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullatves së brendshme	Drejtorja për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi
		Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural			Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural		
		Mbikëqyrja jo efektive mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural			Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural	Kryetari i komunës, Drejtorja për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	

6.	STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI	Mungesa e kontrolleve konsistente (vend ndërtimet punishtet)	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës		Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje.	Kryetari i komunës, Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Në vazhdimësi nga drejtoria e inspektionit
		Mungesë e stafit për kontrollimin ndërtimeve	dhe planet rregullativ e urbane		Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural	Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	Veshtersi te regrutimit bazuar në paga
7.	INSPEKTIMET	Mungesa e planifikimit të duhur inspektiveve	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës		Të sigurohet plani vjetor i inspektiveve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.	Drejtoria e inspektiveve	Në fillim vit, hartohet plani
		Mungesa kapaciteteve profesionale të inspektorëve			Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët	Drejtoria e inspektiveve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi sipas nevojës
		Numër pamjaftueshëm inspektorëve			Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja	Drejtoria e inspektiveve, Njësia e Burimeve Njerëzore	Kryetari i komunës ka miratuar rekrutimin e brendshëm

8. ARSIMI PUBLIK	Planifikimi i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës			Të sigurohet planifikim të shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes së numrit të nxënësve.	Kryetari i komunës dhe Drejtorja e arsimit	Në vazhdimësi gjate tere vitit
	Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor				Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij	Drejtorja e arsimit	Në vazhdimësi
9. SHËNDETI PUBLIK	Hapësira dhe infrastruktura shëndetësore jo e mjaftueshme dhe jo efikase në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.	Ligjet, aktet nënligjor; aktet e brendshme të komunës			Të bëhet analizë e detajuar më qëllim të përcaktimit të prioriteteve për përmirësimin në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime shëndetësore.	Drejtorja Shëndetësi për	Në vazhdimësi gjate tere vitit
	Mangësi në rregullativen e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe zbatimin jo i plotë i saj	si dhe planet dhe strategjitë në shëndetës i			Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit.	Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për shëndetësi	Në vazhdimësi gjate tere vitit
	Funksionimi jo efikas i Sistemit të informacionit shëndetësor.				Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullatives.	Drejtorja shëndetësi dhe drejtuesit institucioneve shëndetësore	Në vazhdimësi
					Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve si dhe përmirësimit të menaxhimit të institucionit shëndetësor të funksionalizimit Sistemi i informacionit Shëndetësor	Drejtorja shëndetësi dhe drejtuesit institucioneve shëndetësore	Është avancuar ky proces ne vazhdimësi




Republika e Kosovës

60175122
-1-
01.12.2022



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Datë:	01 Dhjetor 2022
Për:	KK- Vushtrri
Nga:	Dr. Nexhmedin Rashica  Drejtore i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
Lënda:	Raport i Punës, Qendra për Punë Sociale

Të nderuar,

Bashkangjitur e gjeni raportin njëmbëdhjetë mujor të punës (Janar – Nëntor 2022) të Qendrës për Punë Sociale – Vushtrri.

Faleminderit për bashkëpunim!

Detyrat programore të Qendrës për Punë Sociale janë të rregulluara me Ligjin mbi Asistencën Sociale, Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Përkujdesjen Materiale të Familjeve me Fëmijë të Aftësisë së Kufizuar si dhe Ligje dhe Akte tjera të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuadër të veprimtarisë së vetë profesionale, Qendra për Punë Sociale:

1. Zbulon dhe përcjellë nevojat dhe problemet sociale të qytetarëve,
2. Zbulon familjet në gjendje të vështirë materiale dhe zbaton formën e ndihmës sociale në kuadër të kriterëve të përcaktuara me Ligj,
3. Propozon, organizon dhe ndërmerr masa në aplikimin e formave adekuate të mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale,
4. Inicon, organizon dhe koordinon punën profesionale dhe vullnetare në lëmin e mbrojtjes sociale,
5. Mbanë kontakte dhe bashkëpunon me OJQ dhe institucione që kanë fushëveprimin e mbrojtjes sociale.

Përveç punëve të lartëcekura, Qendra kryen edhe punë dhe shërbime të përcaktuara nga Ligji mbi Familjen, Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, pra kryen punë si ato të kujdestarisë:

1. Merr pjesë në procesin e marrjes së aftësisë së veprimit dhe rikthimit të sajë ndaj personave,
2. Kryen kujdestari të drejtëpërdrejtë përmes punëtorëve të vetë profesional,
3. Merr pjesë në marrjen e së drejtës prindërore dhe rikthimit,
4. Kryen punë të adoptimit,
5. Ofron ndihmë në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare,
6. Jep mendim dhe propozim Gjykatës për pajtim të bashkëshortëve, besimit të fëmijëve dhe ndërrimit të vendimit për besim të fëmijës,
7. Ofron ndihmë në problemet zhvillimore të fëmijëve dhe çrregullime në sjelljet e tyre,
8. Ofron ndihmë familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar,
9. Ofron ndihmë dhe trajton personat e trafikuar dhe viktimat e dhunës në familje si dhe personat e abuzuar seksualisht,
10. Sistemon të moshuarit në shtëpi të pleqëve.

D I N A M I K A

LËVIZJA E NUMRIT TË SHFRYTËZUESVE DHE REALIZIMIT TË FORMAVE TË MBROJTJES SOCIALE

Në periudhën raportuese mund të themi se kanë ardhë në shprehje maksimale të gjitha grupmoshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të shërbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale.

ASISTENCA SOCIALE

Pranë QPS-së, Vushtrri në Asistencë Sociale janë 1362 familje, prej tyre 1311 familje me 6354 anëtarë janë shqiptarë si dhe 51 familje me 113 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 114 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 85 janë aprovuar kurse, 29 prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 12 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 121 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 5, prej tyre 2 janë aprovuar në vlerë prej 100 euro dhe 3 të refuzuara.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 675 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 542 aplikues, janë refuzuar 133 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 24.

Gjatë kësaj periudhe 9 familje i kanë kthyer mjetet, pasi që janë refuzuar nga ATK janë të obliguar t'i kthejnë mjetet. Kthimi i mjeteve bëhet për shumën e marrë të ndihmës sociale për një muaj.

Gjatë kësaj periudhe nga bashkësia islame janë përkrahur me pako ushqimore 1400 shfrytëzues. Kurse, familjet e asistencës sociale janë përkrahur edhe me nga 100 euro mjete material nga Qeveria.

SHËRBIMET SOCIALE

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe shkurorzimeve kategorive të reja, dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtutjeshme.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 59 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 16 kanë arritur pajtim 23 procedur dhe 15 ndarje.

Nga këto familje janë 34 fëmijë, prej tyre 19 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 15 ju janë besuar babait në përkujdesje.

FËMIJËT PA KUJDES PRINDOR

Edhe në këtë periudhë QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindor dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorije deri në përfundim e sipër si punë permanente.

Kemi pasur 2 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse gjatë këtij viti kemi 3 fëmijë të braktisur gjithsej 5 fëmijë, ku janë ofruar këto shërbime pas qëndrimit në spital për një periudhë një mujore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor, 2 raste të bartuara nga viti i kaluar janë në procedur paraadoptuese, 2 fëmijë janë vendosur në strehim familjar në komunitet, kurse (1) fëmija tjetër i braktisur ka lindur i vdekur dhe është kthyer në familje te babit ku edhe I është bërë vorrimi. 1(një) fëmijë i prindërve të penguar në detyrën prindore i bartur nga vitet e kaluara është në mbrojtje institucionale i strehuar në Caritas Klinë. Dhe një (1) fëmijë për shkak të vështirësive që ka pasur prindi për ti kryer detyrat prindore është trajtuar me formën mbrojtëse strehim familjar në komunitet, gjatë qëndrimit në strehim familjar fëmijës ju kanë ofruar shërbime psikologjike si dhe është bërë regjistrimi në shkollë të re, dhe shërbimet e tjera të nevojshme sociale. Gjatë këtij viti i kemi pasur 2 raste heqje e zotësis për të vepruar si dhe kërkesa për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 7 raste, me rastet e bartura

nga vitet paraprake gjithsej 25 kujdestari aktive. Strehim familjar tek të afërmit 20 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar tek të afërmit janë vizituar. të gjitha rastet problematike janë trajtuar në formën e duhur duke ju ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbime të tjera të nevojshme, DPSF na ka njoftuar përmes trajnimeve të organizuara me OJQ, OFAP se sipas nevojave të kërkuara nga QPS mund të ofrohen shërbime dhe trajtime në fushën e psikologjis për fëmijët në strehim familjar tek të afërmit dhe në komunitet. Po ashtu kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim, raport për 4 raste, martesë e të miturve dhe 3 raste leje për pëlqim nga Organi I Kujdestaris.

Pra krahasuar me vitin paraprak në periodën raportuese janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si vënja nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindor 4 raste, 12 kujdestari për raste të veçanta, asistencë sociale si dhe shërbime tjera të punës sociale. Ndihma në natyrë këtë vit krahasuar me atë paraprak ka qenë shumë e vogël me që është mvarë nga donator.

TË MITURIT ME SJELLJE TË ÇRREGULLUARA DHE DELIKUENT TË MITUR

Në këtë periodë kemi këtë gjendje gjithsej 43 raste të fëmijëve me sjellje asocial dhe në konflikt me ligjin. 22 raste të delikuençës së të miturve dhe 4 raste fëmijë me sjellje asociale, 17 raste të kundravajtjes ku janë dhënë 17 raporte vlersuese rreth gjendjes sociale për fëmijë të cilët kanë bërë kundravajtje, kryesisht për vozitje pa patent shofer pa e arritur moshën madhore. Puntorët e shërbimeve sociale asistojnë në polici dhe gjykatë për rastet e të miturve delikuent në përgjethësi. Për kategorinë e fëmijëve që bëjnë kundravajtje japin raport vlersues dhe propozues për masat ndëshkuese. Ndërsa për të miturit delikuent trajtimin dhe përpunimin e rasteve e bënë Shërbimi Sprovues të Kosovës, pra dhënjën e mendimeve gjykatave, ndërsa në i trajtojmë edhe më tutje në aspektin e mbiqkyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejt me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bredhja, si rezultat i kësaj është prezente shfrytëzimi për pornografi dhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje nga neni 135 LPK. Si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësis publike, drejtim i automjetit pa patent shofer. Gjatë tretmanit psiko-social të këtyre fëmijëve dhe të miturve Qendra ka vendosur kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqëndruar në identifikimin gjegjësisht diagnostifikimin e rastit,

hulumtimin e personalitetit të fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturëve, etj.

VIKTIMA TE TRAFIKIMIT DHE TENTIM DHUNIMIT

Gjatë periodës raporutuese kemi 1 rast dhunimi të të miturës, e cila është trajtuar nga Instituti i Mjeksis Ligjore dhe pas trajtimit viktima është rikthyer në familjen e saj, dhe 2 raste e të miturave të shfrytëzuara për pornografi rastet janë në procedur, dhe 2 raste të abuzimit seksual. Në këtë vit nuk kemi raste të të rriturave të cilat dyshohet për trafikim

Ekipi shërbimeve sociale në këto raste përcjellë këto viktima prej fillimit të hetuesisë në bashkëpunim me policin, gjykatën, familjet dhe subjektet e tjera. Vlen të theksohet se nga QPS-ja në këtë vit janë ndihmuar reth riintegrit 3 viktima të trafikimit nga vitet paraprake këto viktima të trafikimit kanë pasur edhe mbështetjen financiare me qëllim të rehabilitimit dhe reintegrit të tyre. Pra puna kryesore ka qenë e fokusuar në risocializimin, kthimin e tyre në familje dhe të rikthimit në shkollim të rregulltë. Në këtë drejtim nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me qendrën e shëndetit mendor, kemi pasur raste të trajtuar nga kjo qender dhe mendoim se ka pasur sukses në stabilizimin e tyre psiko-social.

DHUNA FAMILJARE

Gjatë periodës që po raportojmë ka pasur shtim të lartë të rasteve ku kemi 55 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici, asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë.

Në këtë vit kemi 15 gra + 24 fëmijë gjithsej 39 persona të cilët janë vendosur në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Kemi pasur një transfer nga strehimorja Mitrovicë në strehimoren Ferizaj të nënës me 5 fëmijë. Dhe 1 rast të mbartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpin e Sigurt Gjakovë.

Janë dhëne 53 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje, 16 raste kemi arritur ta pajtoim, 23 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedur. Punëtorëve të shërbimeve sociale ju

mbetet të vazhdoin me trajtimin e këtyre rasteve në vitin vijues.

PERSONAT E MOSHUAR

Sikurse edhe kategorit tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periudë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 3 raste 2 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 1 kërkesa te reja, 1 kërkesë është në procedur për tu vendosur në shtëpi të pleqëve Prishtinë, dhe janë dhënë 4 raporte për bashkim familjar tek të afërmëve jashtë shtetit.

KATEGORI DHE SHERBIME TË TJERA

Në Qendër për Punë Sociale ofrohen shërbime edhe për këto kategori janë dhënë:

Vertetime për lirim nga shtetësia e Kosovës 95

Certifikata për zotësi të veprimit për punë dhe për armbajtje 303,

Asistime në polici për fëmijët e mitur dhe raste të dhunës në familje 127,

Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 169,

Vizita në familje 78,

Kontaktim prind fëmijë 486,

Seanca konsultime dhe këshillime 326

Bashkëpunim me Institucione 185

Konstatime Zyrtarë 15

Regjistrim i më vonshëm i fëmijëve 2 etj

Gjatë këtij viti janë mbajtur 2 komisione mjekësore për fëmijët me aftësi të kufizuar në muajin Shkurt, kanë aplikuar 62 raste të reja, kemi pasur 2 ankesa, 33 janë miratuar 6 plotësime dhe 12 janë refuzuar, 4 mungojnë.

Është punuar në bazë të shërbimeve sociale, bazën e strehimit familjar dhe bazë të fëmijëve me aftësi të kufizuar gjithsej 63 raste. Gjatë këtij viti është bërë lëshimi i një baze të re online për dhunën në familje.

Pasqyra tabelare e të punësuarve në bazë të etnicitetit dhe gjinisë

Kombësia	Numri total i të punësuarve	Përqindja
Shqiptar	11	100 %
Serb		
Boshnjak		
Ashkalninjë		
Turq		
Gjithësejt	11	100%
Gjinia	Numri i punëtorve	
Meshkuj	6	54%
Femra	5	45%
Gjithësejt	11	100%

INFRASTRUKTURA LIGJORE

Në kuadër të kësaj mundë të themi se kemi një plotësim të infrastruktures ligjore. Legjislacioni primar si është Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale Nr.04/L-096. i cili Ligj rregullon kriteret e ndihmës sociale si dhe ka ndryshuar dhe plotësuar ligjin paraprak Nr.2003/15.i Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare,Ligji për Personat me Aftësi të kufizuara.Legjislacioni Sekondar i MPMS-së si Rregullorja për zbatimin e Ligjit të Skemës së ndihmës Sociale,Rregullorja mbi arkivimin e lëndëve,pastaj Udhëzimet Administrative si:Udhëzimi Administrativ për punën dhe kriteret e vendosjes së residentëve në shtëpin e personave të moshuar dhe pa kujdes familjar, Udhëzimi Administrativ për vendosjen e rezidentëve në Institutin Special në Shtime, Udhëzimi Administrativ për Verifikimin e gjendjes materiale për familje që aplikojnë për ndihmë sociale,etj.

PLANI I IMPLEMENTIMIT TË STANDARDEVE

Gjatë kësaj periode raportuese QPS nga aspekti i veprimtarisë së vetë natyrisht rendësi të vaçantë i ka kushtuar edhe implementimit të standardeve. Qendra për Punë Sociale ka ofruar shërbime sociale për të gjithë qytetarët pa dallim etnije, feje apo race.

Vlenë për tu theksuar se pranë kësaj qendre janë 51 familje minoritare shfrytëzues të ndihmës sociale, prej tyre 43 familje serbe, 11 rome, 6 familje ashkalinjë dhe 1 familje turke.

PENGESAT NË REALIZIMIN E DETYRAVE PROGRAMORE

Pengesat të cilat janë paraqitë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së institucionit dhe pengesat të cilat do të paraqiten në të ardhmen për realizimin e objektivave të këtij institucioni mendojm se janë të klasifikuara si në vijim:

- ✓ Numri i pamjaftueshëm i zyrtareve .
- ✓ Mospagimi i zyrtarëve të shërbimeve sociale për punë jashtë orarit zyrtarë (kujdestaris).
- ✓ Mos siguria në punë (puntorët e qendres rrezikohen në kryerjen e detyrave zyrtare nga kërcenimet dhe pengesat e palëve).
- ✓ Mungesa e një veture zyrtare për verifikimin e terrenit.
- ✓ Trajnimet shtes të stafit punues me qëllim të avansimit profesional.
- ✓ Koeficienti i ulët i pagave dhe jo nivelizimi i pagave me zyrtaret e shërbimeve me komunat tjera të cilët e kryejn të njejtën punë.





REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATË:	12 dhjetor 2022
PËR:	KPF-në dhe KK-në
PROPOZUES:	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës
HARTUES:	Remzi Ahmeti Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
LËNDA:	Propozim - Vendim paraprak për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 6 pika 1.1, nenit 8 pika 1.1, nenit 13 pika 1 dhe 2 dhe nenit 14 pika 1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 5, paragrafi 1.2, nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 8, të Rregullores (QRK) Nr.09/2022 Për Caktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 13, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2022 mori këtë :

V E N D I M P A R A P R A K

Për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023

1.Me këtë vendim aprovohet lista e veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2023, parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m², P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m², P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m², ZK-Novolan, parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m², ZK-Prelluzhë, parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m², ZK-Strovc, parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m²,

parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m², parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m², ZK-Kollë, parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m², ZK-Dumnicë e Llugës, parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m², parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m², ZK-Stanovc i Poshtëm,

parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m², ZK-Sllatinë, parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m², ZK-Qytezë, parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m², ZK-Bukosh, parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m², ZK-Liqen, pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-27, në sipërfaqe prej 2000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m², ZK Lummadh, lokalet afariste në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri (14 lokale me sipërfaqe prej 12m²), parcela P-70202050-00912-0 me sipërfaqe prej 39631m², zk Pasomë, parcela P-70202047-00343-0, me sipërfaqe prej 87873m², zk Akrashticë, parcela P-70202046-00508-1 me sipërfaqe prej 1065m², zk Maxhunaj, parcela P-70202071-0 në sipërfaqe prej 11379m², zk Shtitaricë.

1.1 Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m², P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m², P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m², ZK Novolan, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.2 Parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m², ZK-Prelluzhë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.3 Parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m², ZK-Strovç, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.4 Parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m², parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m², parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m², ZK-Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.5 Parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m², ZK-Dumnicë e Llugës, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

1.6 Parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m², ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

- 1.7 Parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m², ZK-Stanoc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.8 Parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m², ZK-Sllatinë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.9 Parcela P-70202062-OK106-1 me sipërfaqe prej 1002m², ZK-Qytezë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.10 Parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m², ZK-Bukosh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.11 Parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m², ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m², ZK-Liqen, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.12 Pjesë e parcelës P-70202011-00435-27 me sipërfaqe prej 2000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m², ZK-Lummadh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.13 Lokalet afariste (14 lokale afariste me sipërfaqe prej 12m²) që gjenden në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri në parcelën kadastrale P-70202016-00653-0, zk Vushtrri, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari afariste.
- 1.14 Parcela P-70202050-00912-0 me sipërfaqe prej 39631m², ZK-Pasomë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.15 Parcela P-70202047-00343-0 me sipërfaqe prej 87873m², ZK-Akrashticë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.16 Parcela P-70202046-00508-1-0 me sipërfaqe prej 1065m², ZK-Maxhunaj, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.
- 1.15 Parcela P-70202071-00461-0 me sipërfaqe prej 11379m², ZK-Shtitaricë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizik dhe juridik për veprimtari bujqësore.

2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit publik për pronat nga nënpika 1.1 deri 1.12. Për pronën në nënpikën 1.13 të zhvillohen procedurat e negocimit për dhënie në shfrytëzim. Drejtoria për Gjeodezi,

Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

Gumnishta, Hercegovna, Karaça, Kolla, Kunovik, Kurilova, Liqej, Lumadh, Mavriqi, Maxhunaj, Mihaliq, Miraça, Nedakoci, Novolan, Oshlan, Pantina, Pasoma, Pestova, Prilluzha, Reznik, Ropica, Samadrexha, Sfaraçak i Epërm, Sfaraçak i Poshtëm, Shallë, Shlivovica, Shtitarica, Skoçan, Skroma, Sllakoci, Sllatina, Smrekonica, Stanoc i Eperm, Stanoc i Poshtëm, Stroci, Studime e Epërme, Studime e Poshtme, Taraxha, Tërllabuq, Vërnica, Vesekoci, Vilanc, Vushtrri, Zagore dhe Zhilivoda.

Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Vushtrri kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.

Kapitulli II

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

ZHVILLIMI SOCIAL

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

ZHVILLIMI SOCIAL

Arsimi

Sistemi i edukimit-arsimimit në Komunën e Vushtrrisë është i organizuar në katër nivele: Niveli- 0 arsimimi para-fillor, niveli -1 arsimi fillor, niveli -2 arsimi i mesëm i ulët dhe niveli -3, arsimi i mesëm i lartë.

Në Komunën e Vushtrrisë arsimimi është i organizuar në institucione arsimore publike, dhe institucione private ku përfshihen:

Institucion parafillorë në Vushtri janë: çerdhja “Foleja” me 174 fëmijë , çerdhja pranë shkollës “Mustaf Venhari” me 113 fëmijë. Si dhe 1 çerdhe private “Gëzimi ynë” me 60 fëmijë.

I kemi 3 institucione të arsimit fillor të cilat i përkasin Nivelit-1, janë SHF ”Ali Kelmendi” me 913 nxënës, SHF”Naim Frashëri” me 640 nxënës si dhe SHF ”Musafë Venhari” me 1021 nxënës.

Kemi 2 shkolla të mesme të ulëta, nga klasa (6-9), të këtij niveli, si: SHMU-1 dhe SHMU-2, që të dyja në Vushtri.

Kemi 4 SHML, si: Gjinnazin “Eqrem Çabej”, SHMT”Lutfi Musiqi” dhe SHMP”Bahri Haxha” në Vushtri, si dhe institucionin privat shkolla e mesme e lartë e mjekësisë “Vician Med”.

Në procesin mësimor janë të përfshirë rreth **12796** nxënës.

Nga viti 2002, arsimi në Republikën e Kosovës u përfshi nga reformat arsimore, duke u përcaktuar arsimimi sipas niveleve me përfshirjen edhe të arsimit parashkollor.

Struktura e reformuar ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët , 3 vite të shkollimit të mesëm të lartë . Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re, ku arsimi i obligueshëm është zgjatuar për një vit, tani në 9 vite nga ai i mëparshmi me 8 vite.

Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në aspektin e përgjithshëm të mësim-nxënies kushte jo të kënaqshme na paraqiten në vendbanimet e thella rurale. Këto objekte shkollore kanë nevojë për investime,

renovim, ujësjellës, kanalizim, për rregullim të oborreve dhe të fushave sportive, pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme arsimore.

Tabela: Numri i shkollave, numri i nxënësve dhe kushtet mjedisore

Nr.	Emri i shkollave	Vendi	Numri i nxënësëve	Gjendja me ujë	Fushë sportive
1.	Foleja 2	Vushtrri	113	Ujësjiellësi	+
2.	Foleja 1	Vushtrri	174	Ujësjiellësi	+
3.	Abdyl Frashëri	Druar	160	Ujësjiellësi	+
4.	Mihaliq	Mihaliq	142	Ujësjiellësi	+
5.	Martirët	Reznik	140	Ujësjiellësi	+
6.	Adem Voca	Pasomë	67	bunari	+
7.	Ali Kelmendi	Vushtrri	913	Ujësjiellësi	+
8.	Nedakoc	Nedakoc	121	Ujësjiellësi	+
9.	SHMU - 1	Vushtrri	654	Ujësjiellësi	+
10.	Azem Bejta	Dubofc	34	Ujësjiellësi	+
11.	Azem Bejta 1	Beçiq	35	Ujësjiellësi	+
12.	Anton Zako Çajupi	Vushtrri	902	Ujësjiellësi	+
13.	Bajram Curri	Dumnicë e Mesme	123	Ujësjiellësi	+
14.	Bajram Curri 1	Dumnicë e Epërme	19	bunari	+
15.	Emin Duraku	Novolan	159	Ujësjiellësi	+
16.	Enver Hadri	Smrekonicë	353	Ujësjiellësi	+
17.	Dobërlukë	Dobërlukë	205	Ujësjiellësi	+
18.	Gjergj Kastriot Skënderbeu	Pantinë	137	Ujësjiellësi	+
19.	Jusuf Gërvalla	Dumnicë e Poshtme	126	bunari	+
20.	Liria	Strofc	200	bunari	+
21.	Liria 3	Gllovatin	30	bunari	+
22.	Lumni Surdulli	Samadrexhë	179	bunari	+
23.	Migjeni	Stanofc i Epërm	328	Ujësjiellësi	+
24.	Migjeni 1	Cakaj	126	Ujësjiellësi	+
25.	Lumadh	Lumadh	135	Ujësjiellësi	+
26.	Mustafë Shyti	Oshlan	103	Ujësjiellësi	+
27.	Mustafë Venhari	Vushtrri	1021	Ujësjiellësi	+
28.	Naim Frashëri	Vushtrri	640	Ujësjiellësi	+
29.	SHMU - 2	Vushtrri	1002	Ujësjiellësi	+
30.	Nazmi Zhegrova	Stanofc i Poshtëm	309	Ujësjiellësi	+
31.	Rexhep Musa	Ceceli	53	bunari	+
32.	Rilindja	Maxhunaj	313	Ujësjiellësi	+
33.	Rilindja 2	Ropicë	65	Ujësjiellësi	+
34.	28 Nëntori	Vërmicë	165	Ujësjiellësi	+
35.	Hajrullah Shala	Akrashticë	181	Ujësjiellësi	+
36.	Bahri Kuqi	Shtitaricë	279	Ujësjiellësi	+
37.	Lutfi Musiqi	Vushtrri	635	Ujësjiellësi	+

38.	Bahri Haxha	Vushtrri	987	Ujësjiellësi	+
39.	Eqrem Çabej	Vushtrri	765	Ujësjiellësi	+
40.	7 marsi	Bukosh	203	Ujësjiellësi	+
41.	Dëshmorët	Zhilivodë	30	bunari	+
42.	Gëzimi Ynë' 16 private	Vushtrri	60	Ujësjiellësi	+
43.	Vician Med private	Vushtrri	161	Ujësjiellësi	+
44.	Shkollë e re Pestova	Pestovë	249	Ujësjiellësi	+
	Total		12796		

Edukimi mjedisor

Shkolla si qendër edukimi është bazë e edukimit qytetar dhe atij mjedisor të nxënësve. Në përgjithësi, në kuadër të edukimit qytetar, nxënësit marrin në shkollë dhe njohuri për edukimin mjedisor.

Edukimi mjedisor duhet të nisë që në ciklin fillor dhe të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të nxënësve. Edukimi mjedisor në shkollë e bënë ndërgjegjësimin e nxënësve për të gjitha llojet e shkatërrimeve dhe ndotjeve që po ndodhin sot në komunë. Edukimi mjedisor sot është, si një parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit. Duke parë problemet mjedisore me të cilat po përballet sot komuna, të cilat janë rezultat i një zhvillimi të pakontrolluar dhe degradues ndaj mjedisit dhe edukimi mjedisor shihet si përparësi, si një mjet kryesor për një qeverisje më të mirë të mjedisit. Çdo ditë e më shumë edhe në komunën tonë lëvizja dhe edukimi mjedisor i komunitetit po marrin vendin e duhur. Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk duhet të konsiderohen si çështje që i takojnë “shtetit” dhe “të tjerëve”, por të gjithë komunitetit, pasi edhe ndikimi është i gjithanshëm.

Edukimi mjedisor synon rritjen e përgjegjësisë individuale në marrjen e vendimeve dhe formulimin e një kodi sjelljeje për çështjet që lidhen me cilësinë e mjedisit dhe ruajtjen e tij. Edukimi mjedisor realizohet në dy drejtime kryesore:

- Në ndërgjegjësimin e shoqërisë se mjedisi ndikon mbi individin dhe të gjithë individët me zgjedhjet dhe sjelljet e tyre çdo ditë ndikojnë mbi mjedisin.
- Të kuptuarit nga gjithkush se duhet të bëjë çmos dhe të veprojë për të zvogëluar riskun e dëmtimeve që shkaktohen në mjedis nga faktorë të ndryshëm.
- Zbatimi i projekteve dhe planeve informuese, ndikojnë në ndërgjegjësimin dhe edukimin e nxënësve të cilat duhen aplikuar sa më shpejt dhe me përgjegjësi, për të shmangur dhe zgjidhur problemet e shumta, gjithnjë e më prezente në mjedis.

Por, edukimi i përvetësuar mjedisor është i pamjaftueshëm për shumë arsye: mungesa e materialeve të shkruara, mungesa e një organizimi të aktiviteteve të përbashkëta,

mangësitë në dhënie dhe marrjen e informacionit mjedisor, mungesa e qendrave të informimit mjedisor etj.

Me gjithë përpjekjet e deritanishme, ka mangësi në organizimin e aktiviteteve për edukimin mjedisor. Disa shoqata mjedisore janë përpjekur të rrisin edukimin mjedisor të nxënësve, por mungesa e fondeve ka krijuar vështirësi për zhvillimin e mëtejshëm, e të vazhdueshëm të këtij procesi.

Shëndetësia

Rrjeti i institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) në Vushtrri përbëhet nga QKMF dhe 3 QMF në Vushtrri; 7 QMF në fshatrat Lumi i Madh, Maxhunaj, Dumnicë, Smrekonicë, Pantinë, Druar dhe Novolan, si dhe 9 AMF në fshatrat: Samadrexhë, Ceceli, Pasomë, Ashlan, Duboc, Beçiq, Stroc, Zhilivodë dhe Skromë. Stafi profesional i QKMF ka 203 punëtorë, prej tyre 45 mjekë, 129 infermierë dhe 29 staf administrativ të tjerë.

Në aspektin e Kujdesit Dytësor Shëndetësor (KDSH) - Spitali i Vushtrrisë është institucioni kryesor në këtë komunë. Sfida kryesore mbetet tek ngritja e kapaciteteve profesionale dhe e cilësisë së shërbimeve. Ky spital ka 41 mjek specialist, 140 infermier dhe 30 staf administrativ dhe mbështetës. Repartet kryesore në këtë spital janë: Kirurgjia, blloku operativ, anestezi, internistika, pediatria, materniteti, gjinekologjia, radiologjia dhe transfuzioni.

Ekonomia

Komuna e Vushtrrisë karakterizohet me një zhvillim ekonomik të re dhe dinamike, ku nga një ekonomi centraliste është transformuar në një ekonomi e cila është konkurente në treg, kryesisht bartëse e zhvillimit ekonomik është industria përpunuese dhe bujqësia. Vushtrria është shtëpia e disa prej kompanive më të rëndësishme prodhuese në mobilie, bujqësi dhe ushqim, si dhe në prodhimin e metaleve.

Ndwr bizneset mw tw suksesshme tw cilat operojnw nw komunwn e Vushtrrisw dhe punowsojnw njw numwr tw konsiderueshwm tw punwtorwve janw: Ciao Berto, Binni, Ariani Company, Butrinti Company, Vipa Chips etj.

Komuna e Vushtrrisë është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, si dhe falë tokës pjellore e cila ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Komuna e Vushtrrisë prinë në prodhimin dhe përpunimin e patates.

Komuna e Vushtrrisë ka të regjistruara 3133 biznese. Prej tyre 1311 merren me tregti me shumicë dhe pakicë, 509 transport dhe telekomunikacion, 321 hotele dhe restorante, 244 industri përpunuese, 91 bujqësi dhe pylltari, si dhe veprimtari të tjera ekonomike, në funksion të ngritjes së mirëqenies së vet qytetarëve. Edhe pse disa prej tyre nuk janë aktive, këto veprimtari ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

Strukturura e bizneseve	Vushtrri	
A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	295	294
B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE)	6	7
E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE	20	21
F - NDËRTIMTARIA	376	401
H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	538	534
I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	438	459
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	107	122
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT	15	16
L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË	12	16
M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	136	148
N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE	137	150
O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM	7	6
P - ARSIMI	53	55
Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE	89	94
R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI	63	66
S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE	268	273
G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	1636	1655
D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR	3	3
C - INDUSTRIA PËRPUNUESE	495	516
Grand Total	4 694	4836

Industria

Në komunën e Vushtrris ekzistojnë ndërrmarje prodhuese të ndryshme, të gjitha këto ndërrmarje janë private, kryesisht janë industri e lehtë. Ish ndërrmarjet publike janë privatizuar. Prej ndërrmarjeve më të rëndësishme janë: Fabrika e Llamkosit, Ndërrmarja Qao BERTO, Fabrika për përpunimin e drurit BINI, Ndermarrja bujqesore PESTOVA, etj.

Bujqësia

Komuna e Vushtrris ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Rreth 21727 ha është tokë e punueshme që e përbëjnë arat, kopshtet, kullosat, livadhet dhe tokat djerrin. Në strukturën e tokës së punueshme dominojnë arat, pastaj janë livadhet dhe kullosat, ndërsa sipërfaqet me pemishte dhe kopshte janë më të vogla.

Sipërfaqja e tokës së punueshme sipas llojit të sipërfaqes bujqësore e shprehur në përqindje në sipërfaqen e përgjithshme të tokës bujqësore dominojnë arat me 16022 ha. Livadhet përfshijnë sipërfaqen prej 1447 ha. Gjithashtu pjesëmarrje kanë edhe kullosat me 3583 ha. Me pemishte janë 630 ha, kurse serat dhe kopshtet (45 ha) kanë një pjesëmarrje shumë të vogël.

Në kuadër të tokës së punueshme kultivohen lloje të ndryshme të kulturave bujqësore nga të cilat dominon patatja me 900 ha me një rendiment mesatar 35 ton/ha. Prodhimtaria bujqësore është e mirë në përgjithësi, ndërsa drithërat kanë pjesëmarrje me 4000ha grurë me mesatare prej 4 ton/ha, gjë që është prodhimtari e kënaqshme duke marr në konsideratë kualitetin e tokës dhe mundësit e tjera tekniko-teknologjike. Prodhimtaria në Perimtari është 400 ha, ndërsa prodhimtaria në pemë është 530 ha.

Krahas pjesëmarrjes më të madhe të sipërfaqeve me ara edhe prodhimtaria e drithërave është më e lartë, ndërsa prodhimtaria e perimeve dhe pemëve konsiderohet më e vogël. Ndër perimet të cilat kultivohen në sipërfaqe më të mëdha janë lakra e cila merr pjesë me 100 ha, pastaj janë qepët me 100 ha, domatet me 30 ha, kurse perimet e tjera si lulëlakra, sallata,speci dhe trangujt kanë pjesëmarrje më të vogël por me një trend të rritjes.

Numri i madh i pronave që kanë sipërfaqe të vogël mbetet njëra ndër sfidat kryesore për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Vushtrris.

Blegtoria – Komuna e Vushtrris ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e blegtorisë. Pozita gjeografike, madhësia e territorit, lartësia mbi detare, peizazhet e jashtëzakonshme e bëjnë këtë veprimtari shumë atraktive dhe në rritje e sipër.

Gjendja e tanishme në sektorin e blegtorisë sipas fermave dhe krerëve është si në tabelën në vijim:

Tabela 4: Struktura e bagëtisë në komunën e Vushtrris

Nr.	Lloji i kafshës	Numri i fermave	Numri i krerëve
1	Lopë	292	2830
2	Dele	29	33137
3	Dhi	3	132

Burimi:

Në këtë numër nuk janë përfshirë ekonomit familjare por vetëm fermat.

Bletaria – Një veprimtari shumë profiabile, në rritje dhe me mundësi dhe resurse të mëdha për tu zhvilluar dhe për të ndihmuar ekonomitë familjare dhe më gjerë. Në territorin e komunës së Vushtrris kultivohen gjithsej rreth 11441 shoqëri bletësh në lokalitete të ndryshme.

Shpezëtaria – Me këtë veprimtari në komunën e Vushtrris aktivisht merren 2 ferma të cilat posedojnë rreth 66000 krerë pula vojse.

Perimtaria – Një nga fushat ku kemi rritje të vazhdueshme të sipërfaqeve të mbjellura si në fushë të hapur po ashtu edhe në sera. Nga një veprimtari familjare është shndërruar në një veprimtari shumë profitabile.

Sipërfaqet e mbjellura

Kultura	Sipërfaqja
Perimet	400 ha
Serra-	2 ha

Pemëtaria – Kohët e fundit komuna e Vushtrris ka shënuar rritje pozitive në ngritjen e plantacioneve të reja me pemë. Mundësit e shumta dhe kushtet e volitshme si tokësore po ashtu edhe klimatike, atëherë po kalohet nga pemëtaria ekstensive në atë intensive.

Tabela 6: Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave pemëtare/rendimentit

Kultura	Sipërfaqe	Rendimenti mesatar
Mollë	250 ha	9,000 kg/ha
Dardhë	120 ha	8,000 kg/ha
Kumbullë	250 ha	6,000 kg/ha
Arra	40 ha	1,500 kg/ha
Qerrshi-vishnje	30 ha	2,950 kg/ha
Lajthi	20 ha	260 kg/ha
Dredhëz	12 ha	3,000 kg/ha
Mjedër	2 ha	6,000 kg/ha

Burimi:

Lavërtaria – Tradicionalisht konsiderohet si sektori më i kultivuar në komunën e Vushtrris, mirëpo për shkak shkak se nuk ka profit si sektorët tjerë, ka tendenca të zvogëlimit të sipërfaqeve të mbjellura me këto kultura.

Tabela 7: Sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave lavërtare/rendimentit

Drithëra	Sipërfaqe	Rendimenti mesatar
Patatja	900 ha	35,000 kg/ha
Grurë	4000 ha	4,000 kg/ha
Elb	135 ha	3,500 kg/ha
Thekër	20 ha	3,000 kg/ha
Misër kokërr	2200 ha	6,500 kg/ha
Misër sillazh	2800 ha	16,500 kg/ha
Tërshërë	80 ha	3,500 kg/ha
Bimë foragjere	Sipërfaqe	Rendiment
Sanë	210 ha	6,000 kg/ha
Jonxhë	220 ha	6,500 kg/ha

Burimi:

Nr.	Kulturat	Sipërfaqja e planifikuar në ha
1	Grurë	4000
2	Misër kokërr	2200
3.	Misër i gjelbër	2800
4.	Elb pranveror	35
5.	Tërrshër	80
7.	Bimë industriale	10
8.	Perime	400
9.	Patate	900
10.	Fasule monokulturë	30
11.	Sanë	60
12.	Bari	150
13.	Jonxhë	120
14.	Tërfil	60
15.	Urov	40
16.	Elb vjeshtor	150
17.	Thekër	20
	Gjithsej	11.055

Turizmi dhe Hoteleria

Turizmi

Vushtrria është qytet historik që daton nga koha e civilizimit ilir, e cila shtrihet në pjesën veripernëdimore të Rrafshit të Kosovës, e rrethuar nga bjeshkët e Shalës dhe Çyqavicës, e përshkuar nga lumi Silnica, e cila krijon potenciale të mëdha të zhvillimit të turizmit si kulturor, ashtu edhe të atij natyror dhe rekreativ, duke shërbyer si faktor ndikues i zhvillimit ekonomik.

Njëra ndër fushat më të hovshme të turizmit është edhe hoteleria. Ndërsa, shtrirja e bizneseve hoteliere/sherbyese është e shprehur kryesisht përgjatë rrugëve të karakterit nacional (magjistrale – regjionale), si dhe objekteve dhe peizazheve tjera me atraktivitet të veçuar. Rëndësi dhe vlera tjera turistike në komunën e Vushtrrisë janë edhe monumentet e trashëgimisë kulturore të kohëve të ndryshme historike dhe me tendencë të zhvillimit të hotelerisë malore-bujtinave.

Problemet

Mungesa e zhvillimit të turizmit rural.

Investime të pamjaftueshme.

Statistika të pasakta.

Mungesa e sektorit të turizmit i cili merret me promovimin e turizmit në Komunën e Vushtrrisë.

Buxheti i pamjaftueshëm.

Rekomandimet

Trajtimi me prioritet i projekteve që ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës (rrugore, trotuareve, shtigjeve për ecje dhe bicikletave, rregullimi i lumenjve, bujtinave, Shfrytëzimi i resurseve natyrore) që mundësojnë zhvillimin e turizmit dhe shfrytëzimin e potencialit turistik.

Bashkëpunimi ndërkomunal.

Radhitja e turizmit në njërën nga objektivat strategjike.

Gjenerimi i vndeve të reja të punës.

Trashëgimia kulturore dhe përfitimet ekonomike prej saj

Trashëgimia Materiale e Kosovës është krijuar në mes të qytetërimeve antike dhe asaj pas erës së Re, e cila trashëgon një thesar të pasur kulturor, dhe është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore.

Vushtrria është ndër qytetet më të vjetra në Kosovë, që prej kohës antike, e cila në territorin e saj ka trashëguar shumë monumente kulturore, që e dëshmojnë historinë e saj në periudha të ndryshme kohore

Vushtrria është e pasur me monumente kulturore-historike ndër to: Kalaja e vjetër e qytetit, Ura e vjetër e Gurit, Hamami i Qytetit si dhe shumë monumente dhe lokalitete të shpërndara në territorin e Komunës¹.

Problemet

Sfidat në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore paraqiten në dimensione të ndryshme, kurse në Komunën e Vushtrrisë ndër sfidat kryesore janë:

Degradimi i zonës urbane me ndërtime pa leje.

Mungesa e ndërveprimit institucional, buxhetit dhe investimeve në ruajtjen e trashëgimisë.

Vetëdije dhe promovim i ulët mbi trashëgiminë kulturore

Rekomandimet

Për ruajtjen e trashëgimisë kulturore nevojitet mbështetje institucionale dhe zbatim i ligjit për trashëgimi kulturore. Dokument mjaftë i rëndësishëm për trashëgiminë kulturore është integrimi i planifikimit hapësinor në ruajtjen e vlerave dhe trajtimin e monumenteve dhe promovimi i trashëgimisë përmes turizmit dhe ngrijën e vetëdijësimit të banorëve.

Jetësimi i zonës historike brenda zonës urbane të qytetit.

Institucionet komunale, shoqëria civile dhe qytetarët e komunës së Vushtrrisë duhet jenë të përkushtuar në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si pasuri që katalizon zhvillimin e përgjithshëm shoqëror ekonomik dhe mjedisor.

•



Krahasimi i gjendjes se kalase²

¹ https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Vendim_i_Ministrit_MKRS_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2022-2023.pdf

² https://vushtrriacity.files.wordpress.com/2017/07/62cd6-46484_1617157064996148_4446826306790032691_n.jpg

Kalaja e vjetër në qytetin e Vushtrrisë është e tipit fushor me një pozitë strategjike në qendër të qytetit me funksion mbrojtës dhe vrojtues dhe u ndërtua gjatë periudhës iliro-dardane. Kalaja përbëhet prej strukturave ndërtimore me shtresime të periudhave të ndryshme historike.

Edhe pse është dëmtuar dhe ri-ndërtuar disa herë, ajo ka arritur të mbijetoj deri sot ku pas restaurimit, në këtë monument zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore.



Ura e Vjetër e Gurit

Ura e vjetër e gurit, daton që nga shekulli XIV dhe ishte vendosur në rrjedhën e lumit Silnica.

Gojëdhënat thonë se ura ka njëmbëdhjetë harqe, ndërsa sot janë të dukshme vetëm nëntë harqe, ndërkaq gjatë ndryshimeve.

Ura ka gjithsejt nëntë harqe dhe është ndërtuar nga guri.

Pas ndryshimit të rrjedhës së luhmit Silnica, ura e vjetër ka mbetur si monument arkeologjik*(me e pa ne ligj a osht arkitektonike apo arkeologjike) më rëndësi të veçantë e njohur edhe si “Ura pa lum”

11 harqe



Hamami i Qytetit

Hamami i qytetit të Vushtrrisë apo i njohur si Hamami i Gazi Ali Begut, është i vendosur në bërthamën e qendrës së vjetër të Vushtrrisë. Është ndërtuar mes shekujve XIV dhe XV.

Funksioni kryesor i objektit ishte sanitar publik ku përdorej si banjo publike e cila shfrytëzohej nga të dy gjinitë

Infrastruktura dhe shërbimet publike

Transportimi, infrastruktura dhe shërbimet

Rëndësia e zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të saj, në bazë të ndikimit që ka në zhvillimin e një vendbanimi dhe banorëve të cilët jetojnë në atë vend shtrohet si një çështje e rëndësishme për analizë. Shkalla e zhvillimit të infrastrukturës flet edhe për shkallën e zhvillimit të shërbimeve të cilat u ofrohen banorëve të atij vendbanimi.

Analiza e shkallës së zhvillimit të infrastrukturës ngërthen në vete analizën e nivelit të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror, furnizimit me energji elektrike, sistemit të furnizimit të ujësjellësit dhe sistemit të kanalizimit dhe ujërave fekale, shërbimit të telekomunikimit dhe të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

Gjendja ekzistuese

Transporti: Në Komunën e Vushtrrisë transporti zhvillohet përmes: transportit rrugor dhe ati hekurudhor.

Transporti rrugor zhvillohet përmes rrugës Nacionale M2, Prishtinë – Vushtri – Mitrovicë, zgjerimi dhe modernizimi i së cilës është në ndërtim e sipër dhe përmes rrugëve regjionale dhe atyre lokale.

Magjistranja M2 kalon nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë në gjatësinë prej **20 km** dhe e bën lidhjen e kësaj komune dhe të kryeqendrës së saj me komunat tjera, atë të Prishtinës në pjesën jug-lindore dhe atë të Mitrovicës në pjesën veri-perëndimore, si qendra më të mëdha, dhe njëkohësisht ndikon në zhvillimin e vetë komunës duke i ofruar popullatës qasje në vendet tjera. Aktualisht është duke u bërë zgjerimi dhe modernizimi në tërë gjatësinë e saj.

Rrugët regjionale kanë një shtrirje në gjatësinë prej **42 km** nëpër vendbanimet e komunës së Vushtrrisë. Janë rrugë të asfaltuara por që kanë nevojë për rehabilitim, mirëmbajtje dhe shtrirje më të madhe të tyre.

Rrugët lokale janë pjesa tjetër e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë në gjatësinë prej **750 km**, prej të cilave **695 km** janë rrugë nëpër fshatra dhe **55 km** janë rrugë urbane.

Prej **750 km** të rrugëve **726 km** ose **96.68%** janë të asfaltuara kurse pjesa tjetër janë rrugë të rendit IV-të.

Infrastruktura rrugore e Komunës së Vushtrrisë aktualisht është në gjendje relativisht të mirë, sidomos pas hapjes dhe asfaltimit të rrugës regjionale Vushtri-Skenderaj dhe vazhdimit të ndërtimit të asaj Vushtri-Mitrovicë, si dhe asfaltimit të 96.68 % të rrugëve lokale.


Sipas të dhënave që posedojmë, nga gjithsejtë 67 vendbanime të komunës nëpër 63 vendbanime kalojnë rrugët e asfaltuara apo 94% të vendbanimeve të komunës.

Vendbanimet nëpër të cilat kalon rruga magjistrale Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë janë: Graca, Stanovci i Poshtëm, Limëmadhi, Dumnica e Poshtme, Maxhunaj, Pestova, Nadakovci, Dobërlluka dhe Smrekonica.

Vendbanimet nëpër të cilat kalojnë rrugët e asfaltuara dhe të cilat gravitojnë në magjistralen Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë, janë: Prilluzha, Dumnica e Poshtme, Dumnica e Mesme, Dumnica e Epërme, Stanoci i Poshtëm, Stanoci i Epërm, Lumi i Madh Maxhunaj, Pestova, Nadakovci, Sfaraqaku, Samadrexha, Novosella e Begut, Gojbula, Smrekonica dhe Sllatina.

Vendbanimet nëpër të cilat kalojnë pjesë të asfaltuara të rrugës regjionale Mitrovicë-Obiliq janë: Pantina, Akrashtica, Shtitarica, Dolaku, Bukoshi, Nevolani (pjesërisht), Vërnica, Resniku, Druari, Mihaliqi dhe Gllavotini.

Shtrirja hapësinore e rrugëve: magjistranja, rrugët e asfaltuara dhe rrugët e pa asfaltuara nëpër vendbanime.



Parkingjet publike

Numri i vend parkimeve për njësi të banimit duhet të jetë një vend parkim për një banesë, kurse për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, minimum një vend parkim për 30 m² neto sipërfaqe afariste, nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.

Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës dhe dimensionet minimale për hapësirat e parkimit në varg për automjete motorike janë standarde, ndërsa për vendparkimet në korsi përgjatë rrugës apo në mes të rrugës standardet duhet të jenë sipas UA mbi NTPH.

Vend-parkimet për qëllime të veçanta

Në zhvillimet e reja apo ato ekzistuese duhet të planifikohen apo ndërtohen vend-parkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve në automjete transportuese të veçanta, dhe ndalesat për parkim të transportit publik duhet të jenë 2m, sipas UA mbi NTPH;

Vend-parkimet për qëllime të veçanta iu përkasin vend-parkimeve të rezervuara

Vend-parkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara, përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/ dalje nga automjeti; së paku 5% e numrit të gjithmbarshëm të parkingjeve duhet të jenë për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

Vend-parkimet për qasje të fëmijëve në automjete transportuese të veçanta

Vend-parkimet për qasje të fëmijëve të vegjël deri në 6 vjeç në automjete transportuese të veçanta, shënohen në mënyre që të ju lehtësojnë prindërve marrjen e fëmijëve dhe të pajisjes së tyre. Përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, këto vend-parkime përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/ dalje nga automjeti:

- vendi dhe dimensionet bazë duhet të jenë sipas normave teknike të planifikimit hapësinor
- dimensionet e vend-parkimeve për qëllime të veçanta duhet realizuar sipas UA mbi NTPH

Garazhet publike

Garazhet publike janë struktura për parkim të automjeteve të cilat mund të ndërtohen si struktura të veçanta apo në kuadër të strukturave tjera p.sh. në qendra tregtare etj.

- Përzgjedhja e lokacionit bëhet pasi të jetë bërë një analizë e mire e studimit të qarkullimit të automjeteve duke analizuar distancën nga ndërtesat e banimit, administrative, tregtare, të biznesit, etj.

- Lokacioni duhet të jetë i atillë që për shumicën e ngasësve që parkojnë automjetet e tyre në

garazhe, të jetë rreth 350 m deri në 400 m distance që mund të arrihet lehtë me këmbë.

Rampat në garazhe për parkim dhe dimensionet e vend-parkimeve duhet të jenë sipas UA mbi

NTPH.

Terminalet rrugore

Kushtet e përzgjedhjes së lokacionit dhe kërkesat teknike për terminalet rrugore (të udhëtareve dhe

të mallrave), përfshire rrjetet përkatëse të vend-ndalimeve/stacioneve, përcaktohen me anë të

rregulloreve të veçanta.

Shtigjet dhe rampat

Shtigjet për këmbësorë janë sipërfaqe të rregulluara për lëvizjen e këmbësoreve të ndarë nga korsitëautomobilistike. Rampat janë pjerrtësitë e rregulluara për personat me aftësi të kufizuara.

- Rampat për qasje të personave me aftësi të kufizuar duhet të jenë të ndërlidhura dhe të përshtatura për orientim dhe pjerrtësia nuk duhet të jetë më e madhe se 5%, përjashtimisht

mund të jetë dhe 8%, sipas UA mbi NTPH;

- Shtigjet për këmbësorë duhet të jenë me gjerësi së paku 1.8m, përjashtimisht mund të jetë dhe 1.5m, ashtu që të mundësohet lëvizja e papenguar të personave me aftësi të kufizuara. Gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse duhet të jetë të paktën 0.9m, sipas UA mbi NTPH;

Korsitë, shtigjet dhe vend-parkimet për biçikleta

Pjesa urbane e Vushtrrisë është kryesisht e rrafshët dhe duhet të promovojë transportin jomotorrik,

respektivisht përdorimin e biçikletave. Ndërtimi i shtigjeve dhe korsive për biçikleta është i nevojshëm

brenda zonës urbane të Vushtrrisë dhe vendbanimet tjera dhe jashtë vendbanimeve.

- Dimensionet e shtigjeve/korsive brenda dhe jashtë vendbanimeve dhe dimensionet e vend-

parkimit për biçikleta duhet të jenë sipas UA mbi NTPH

- Varësisht nga përmbajtja dhe lloji i ndërtesës përcaktohet numri i vend parkimeve për biçikleta.

Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta në varësi nga përmbajtja (UA nr.08/2017 për NTPH)

Përmbajtjet tregtare dhe komunale 5 VPB/ 100 m² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN)

për vizitor

Përmbajtjet e bizneseve dhe publike 1 VPB/ 100 m² të bruto sipërfaqes së ndërtuar (BSN)

për të punësuar

Përmbajtjet arsimore 1 VPB/ 5 nxënës, për vizitorë + 1 VPB/ 10 të punësuar

Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze 10 VPB/ 100 ulëse, për vizitorë

Përmbajtjet shëndetësore- spitale 10 VPB/ 100 shtretër, për vizitorë

Përmbajtjet sportive dhe rekreative 10 VPB/ 100 ulëse, për vizitorë

Brezi mbrojtës i korsive dhe shtigjeve për biçikleta

Brezi mbrojtës ndërmjet korsive të rrugës dhe shtigjeve për këmbësorë apo biçikleta duhet të

ndërtohet përveç nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme;

Gjerësia minimale e brezit mbrojtës të korsive dhe shtigjeve për biçikleta është:

- ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me korsi të rrugës, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe

t ngritur; dhe 2. ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me shtigje për këmbësor apo vend-parkingje gjatësore, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur, të gjelbër apo me elemente standarde ose të ngjashme. Në të gjitha ndërtesat për industri dhe aktivitete

komerciale të parashihet hapësira për ngarkim dhe shkarkim materialeve, pajisjeve etj.,
Kjo

hapësirë nuk duhet të jetë para ndërtesave dhe rrugës publike;

• Vendndalimet për transport publik duhet të jenë sipas standardeve.

Infrastruktura e transportit hekurudhor është kompetencë e nivelit qendror. Brezi mbrojtës duhet të përcaktohet në bazë të UA mbi NTPH.

Transporti publik – Shërbimi i transportit publik me autobus, është pjesë e transportit rrugor i cili zhvillohet në Komunën e Vushtrrisë, dhe ka shtrirje në 50 vendbanime (apo 75 % të vendbanimeve të komunës), ndërsa shprehur në përqindje të banorëve 75% të banorëve kanë qasje direkte në shërbimet e transportit publik me autobus dhe mjetet tjera të kombinuara në vendbanimet e tyre. Nga kjo e dhënë mund të konkludojmë se në çështjen e shërbimeve të transportit, transporti publik është një prej shërbimeve që ka shtrirje më të madhe në Komunën e Vushtrrisë.

Vendbanimet që kanë shërbimin e transportit publik me autobus janë: Oshlani, Balinci, Pantina, Akrashtica, Shtitarica, Bukoshi, Liqej, Taraxha, Novolani, Brusniku, Duboci, Galica, Beçiqi, Vërnica, Shalë, Kolla, Druari, Rezniku, Mihaliqi, Gllavatini, Bivolaku, Stroci, Bequku, Zhilivoda, Graca, Stanoci i Poshtëm, Dumnica e Poshtme, Dumnicë e Llugës, Dumnica e Epërme, Lumadhi, Maxhunaj, Pestova, Vilanci, Ropica, Samadrexha, Cecelia, Sllakoci, Nedakoci, Studime e Poshtme, Studime e Epërme, Gojbulë, Miraça, Karaça, Skroma, Sllatinë, Tërllobuq, Bajska, Pasoma, Dobërlluka dhe Smrekonica.

Shtrirja hapësinore e vendbanimeve të cilat janë të përfshira në shërbimin e transportit publik me autobus.

Nga harta e cila paraqet shtrirjen hapësinore të vendbanimeve të cilat e kanë shërbimin e transportit publik me autobus, shihet se ky është njëri prej shërbimeve me shtrirje më të madhe në Komunën e Vushtrrisë.



Transporti hekurudhor është lloji tjetër i mundësisë së qarkullimit dhe transportit të udhëtarëve dhe mallrave nëkomunën e Vushtrrisë.

Binarët hekurudhor kalojnë nëpër 10 vendbanime: Pantinë, Shtitaricë, Dalak, Bukosh, Novolan, Vërnice, Reznik, Druar, Mihaliq dhe Prelluzhë.

Stacionet hekurudhore janë në vendet Shtitaricë, Vërnice dhe Prelluzhë.

Nga gjithsejtë 67 vendbanime në komunën e Vushtrrisë, vetëm nëpër dhjetë sosh kalon rruga hekurudhore, apo 15% të vendbanimeve të komunës, dhe në gjatësinë e vijës hekurudhore ekzistojnë 3 stacione hekurudhore, në Prelluzhë, Shtitaricë dhe Vërnice. Shprehur në raport të popullatës atëherë: 15% të numrit të banorëve jetojnë në vendbanime nëpër të cilat kalojnë binarët e transportit hekurudhor d.m.th. kanë qasje direkt në këtë lloj transporti.

Nga shtrirja hapësinore e vendbanimeve të Komunës së Vushtrrisë, nëpër të cilat kalon rruga e transportit hekurudhor, që është pjesa qendrore e komunës, shihet se me riaktivizimin e saj dhe riparimin e vetë binarëve hekurudhor si dhe tri stacioneve hekurudhore, krijohet një mundësi shtesë e favorshme për qarkullimin e popullatës dhe të mallrave, lidhjes me komunat tjera dhe zhvillimin e komunës në sfera të ndryshme.





Furnizimi me energji elektrike – në Komunën e Vushtrrisë rrjeti për shpërndarjen e këtij shërbimi nuk është në nivel të mirë. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga trafostacioni Vushtrria II 110/10 (20 [kV]) dhe nga trafostacioni Vushtrria I 110/35 [kV]. Po ashtu në tërë Komunën e Vushtrrisë janë në funksion 185 trafo të cilat furnizojnë banorët e Komunës, mirëpo rrjeti i shtyllave dhe telit është në gjendje mjaftë të rëndë.

Furnizimi me ujë: Sa i përket shërbimeve komunale për ofrimin e ujit të pastër, Komuna e Vushtrrisë është e angazhuar drejtpërdrejt në shtrirjen e rrjetit të ujit të pijshëm për qytetarët e Vushtrrisë. Bazuar në të gjeturat e pyetësorit në terren, rreth 75.2% e familjeve të anketuara deklaruan se kanë qasje në ujë të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt.

Po ashtu, shtrirja dhe kyçja në rrjetin e ujësjellësit në Komunën e Vushtrrisë është realizuar në 70% të vendbanimeve, përfshirë zonën urbane. Jo shumë vite më parë, kjo përqindje ishte përgjysmë më e vogël për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit të vjetërsuar të shpërndarjes. Me ndërtimin e fabrikës së ujit në Balincë, komuna pati mundësinë të investonte në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet ku mungonte rrjeti. Aktualisht, sipas një hulumtimi të realizuar në terren, vendbanimet që ende nuk kanë rrjet të ujësjellës janë; Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Mesme, Dumnicë e Poshtme, Sllakoc, Ceceli, Samadrexhë, Ropicë, Studime e Epërme, Karaçë, Miraçë, Tërllobuq, Pasomë, Beçiq. Ndërsa në kyqje e sipër janë fshtarat Beçuk, Stroc, Zhilivodë të cilët do të furnizohen pas përfundimit të ndërtimit të rezervuarit në Beçuk dhe sistemit të pompimit në Mihaliq. Gradualisht pra komuna e ka zgjeruar rrjetin në shumicën prej këtyre vendbanimeve, dhe kapaciteti i furnizimit është i mjaftueshëm pas aktivizimit të orarit të plotë të punës në fabrikën e përpunimit.

Në tabelën shtesë të këtij dokumenti janë të paraqitura edhe të dhënat e numrit të banorëve nëpër vendbanime të cilat janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, të llogaritura në përqindje veç e veç për çdo vendbanim si dhe përqindja e përgjithshme e komunës.



Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë ofrohet në tërë territorin e komunës. Kompania publike “Uniteti” ofron shërbimin për 100% të popullsisë sipas ekonomive familjare, bazuar në Marrëveshjen në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes Regjionale „UNITETI”, si dhe nga të dhënat e regjistruar nga vetë kompania në terren. Komuna kryen inkasimin për amvisërit, ndërsa kompania kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga bizneset dhe institucionet publike.

Nga të dhënat e mundësuar nga kompania publike dhe komuna, për vitin 2022 nga KRM “Uniteti” kryhet shërbim në 17.203 ekonomi familjare, biznese dhe institucione.

Gjithashtu shërbimi i grumbullimit të mbeturinave kryhet në të gjitha bizneset aktive dhe institucionet në tërësi territoriale.

Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga KRU “Uniteti”)

Komuna	Klientë gjithsej në zonën kadastrale				Klientë të faturuar = shërbyer			
Qyteti/Fshat	<i>Ekonomi familjare</i>	<i>Biznese</i>	Institucione	Gjithsej	<i>Ekonomi familjare</i>	<i>Biznese</i>	Institucione	Gjithsej
Vushtrria	15107 plus 1072 diasporë	1205	164	17548	15107 plus 1072 diasporë	860	164	17203

Kompania e cila është e licencuar për administrimin e mbeturinave dhe punon në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2012. Si kompani publike punon sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregëtare.

Kompania nuk e bën grumbullimin e mbeturinave të ngurta ndërtimore, si dhe mbeturinat e hekurit, ndërsa mbetjet shtazore grumbullohen me kërkesë nga komuna, me procedurë dhe kontrata të veçanta dhe gjatë gruposjes ato dezinfektohen përmes gëlqerosjes.

Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

Lidhur me krahasimin e të dhënave dhe raporteve mbulueshmëria e territorit të Komunës së Vushtrrisë me ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është 100%, zvogëlimin e shkallës së hedhjes ilegale në 90% (referuar raporteve të deponive ilegale sipas krahasimit të viteve referente 2019 dhe 2018).

Në tabelën e mëposhtme do të përmblihen të dhëna të përgjithshme të mjedisit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbeturinave në komunë.

Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	KOMUNA VUSHTRRI
MATJE MBI PËRBËRJEN E MBETURINAVE?	JO
PIKA TË DEPONIVE ILEGALE TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE	5
VENDE TË AUTORIZUARA TË DEPOZITIMIT TË MBETURINAVE (PGM)	18
VENDE TË PAAUTORIZUARA PËR DEPOZITIMIN E MBETURINAVE	20
VENDDEPOZITIME ILEGALE QË JANË ELEMINUAR	15
VEND I CAKTUAR PËR DEPONIMIN E MBETJEVE INERTE	FSHATI STROC
% E MBETJEVE QË SHKOJNË NË DEPONINË E MITROVICËS	100% ... MBETURINË AMVISËRIE
% E MBETJEVE NË VENDDEPOZITIM TË AUTORIZUAR	0%
% E MBETJEVE NË VENDDEPOZITIME ILEGALE	NUK KA TË DHËNA
SISTEM PËR NDARJE NË BURIM	PO (BUKOSH)
SASIA E MBEJTEVE E MBLEDHUR DHE E PËRPUNUAR (TON/VIT)	60
% E MBETJEVE TË MBLEDHURA DHE TË PËRPUNUARA	0
A KA NISMA PËR KOMPOSTIM?	PO

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave konsiston në mbledhjen e mbeturinave urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontejnerëve publikë dhe atyre individualë, si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontejnerëve dhe vendit përreth, transportimi i mbeturinave urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit.

Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin gjithë zonën e administrimit komunal (100%).

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbeturinave (PGM) përbëhet nga kontejnerë metalik me rrota me volum 1.1m^3 , të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritetet komunale, sipas planit për riorganizimin e zonës qendër në Komunën e Vushtrrisë. Largësitë mesatare midis PGM variojnë sipas dendësisë së popullsisë 0235 me frekuencë 100-150 m distancë, në zonën e qendrës ku është e përqendruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve, si dhe zonat e tjera të qytetit të Vushtrrisë, në 200-400ml.

Në bazë të këtyre të dhënave në Komunën e Vushtrrisë:

- Gjenden rreth 38 pika të grumbullimit të mbeturinave të plotësuara me infrastrukturë me kontejnerë;
- Gjenden disa vende të paautorizuara për depozitimin e mbeturinave, kryesisht të natyrës së mbetjeve inerte, të përziera dhe voluminoze. Referuar të dhënave prej 11 në total, 6 deponi ilegale janë pastruar dhe 5 janë aktive të parehabilituara;
- Mbeturinat komunale depozitohen në deponinë komunale të Mitrovicë;
- Komuna posedon një vend të caktuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve inerte, në zonën rurale në fshatin Stroc.



Figura: Deponia në fshatin Stroc për mbeturina Inerte

Riciklimi i mbeturinave

Sektori i riciklimit në Komunën e Vushtrrisë është në hapat fillestarë të zhvillimit. Aktualisht kjo industri është e lokalizuar në biznese të vogla që kryesisht merren me

sortimin e materialit të riciklueshëm dhe shitjen e tij për tregun vendor apo të jashtëm. Tregu i shitjes së materialit të riciklueshëm kryesisht është i fokusuar në materialet e riciklueshme si: metali/alumini, plastika sipas disa llojeve të plastikës, letra dhe kartoni. Çmimi i shitjes varion në treg sipas bursës internacionale dhe çmimet kryesisht shkojnë sipas fraksioneve: letra 3-4-cent/kg; plastika 20-26cent/kg, alumini/hekuri deri në 70cent/kg. Për momentin aktiviteti i grumbullimit realizohet prej veprimtarisë joformale në shkallë të ulët, përderisa ai i paketimit dhe presimit prej bizneseve të vogla lokale. Këto veprimtari joformale nuk monitorohen prej komunës apo organeve tjera përgjegjëse. Përpos fraksioneve të lartpërmendura, në rajonet përreth Komunës së Vushtrrisë ka iniciativa prej bizneseve të vogla tjera për grumbullimin e materialit çelq dhe përpunimin e tij, megjithatë janë në shkallë fillestare. Në çdo rrethanë, komuna duhet të hartojë politika që adresojnë ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave si pjesë e objektivave për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të depozituara në deponinë rajonale të Mitrovicës. Në Komunën e Vushtrrisë janë shpërndarë 1550 shporta për riciklim, të verdha 120l dhe 240l, në amvisëri, shkolla dhe institucione. Ballimi bëhet në ndërmarrjen sociale në fshatin Bukosh.

Shpërndarja e shportave për riciklim me kapacitet 120 l dhe 240 l

Qendër për grumbullim e mbeturinave të ndara.			
Prezentim hartografik (Ortofoto etj)	Emri i vendbanimit ku gjendet pika e grumbullimit dhe adresa	Numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim	foto e lokacionit
a	b	c	dh
	zona ish varrezat e qytetit	600 ekonomi familjare te furnizuara me 600 shporta 240 dhe 120 litershe	
	zona Mustafa Venhari	300 ekonomi familjare te furnizuara me 300 shporta 240 litershe	
	lagja Bekim Berisha Abeja	100 ekonomi familjare te furnizuara me 100 shporta 240 litershe	
	lagja Bahri Kuqi	150 ekonomi familjare te furnizuara me 150 shporta 240 litershe	
	36 institucione te arsimit	200 copa 240 l	

Shpjegim (dh): Te regjistrohesh numri i ekonomive familjare qe jane brenda rrezes 250 m nga një pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme, plus numrin e ekonomive familjare që janë pajisë me komposter plus numrin e ekonomive familjare në rreze 5 km nga një qendër për grumbullim e mbeturinave të ndara.

Kompostimi

Në Komunën e Vushtrrisë raportohen nisma për kompostim edhe pse potenciali parashikohet të jetë shumë i lartë pasi kjo komunë posedon një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që jetojnë në zona rurale, të cilët gjenerojnë sasi të vogla të mbetjeve inorganike dhe sasi të mëdha të mbetjeve organike që lidhet me veprimtarinë prodhuese të tyre. Vlen për t’u përmendur fakti që edhe pse në këtë komunë ka potencial të lartë të

gjenerimit të mbetjeve organike apo lëndë drusore, si pasojë e hapësirave të gjelbra që posedon, aktualisht ka aktivitet për kompostim në fshatin Bukosh ku janë shpërndarë 150 komposterë.

Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera

Një faktor tjetër që ndikon në aspektin estetik dhe shëndetsor për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë është edhe hedhja pa kriter e mbeturinave voluminoze, kryesisht inerte, mbeturinave të vëllimshme, të papranueshme për sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Mbeturinat nga prishja e ndërtimeve apo të ashtuquajturat mbetje të ngurta janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave, shtëpive dhe strukturave të tjera. Shpesh këto mbetje hedhen të përziera me mbetje urbane, duke impaktuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve apo edhe hedhen në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar prezencë të deponive të egra ilegale të dëmshme për mjedis dhe shëndetin e banorëve. Momentalisht ka sistem të instaluar prej kompanisë “Uniteti” për grumbullimin e tyre të veçantë (mbeturinat e vëllimshme). Komuna së fundmi ka përcaktuar një lokacion për dërgimin e mbeturinave inerte prej gjeneruesve të mbeturinave megjithatë zbatimi i rregullores për hedhje të kontrolluar të kësaj kategorie të mbeturinave nuk gjen zbatim tek prodhuesit e këtij fraksioni të mbeturinave (shkaku largësia e deponisë në fshatin Stroc 16 km nga qendra).

Referuar organizimit të veçantë të grumbullimit për mbetjet prej eshtrave, sipas informatave nuk posedohet një organizim i veçantë apo trajtim i kësaj kategorie të mbetjeve të rrezikshme.

Mbetjet tjera të rrezikshme duke përfshirë mbetje spitalore prej klinikave të mjekësive familjave bashkohen me rrymën e mbeturinave të përgjithshme dhe dërgohen në deponi pa trajtim të veçantë. Krijimi i sistemeve të integruara të mbeturinave dhe organizimi i shërbimit referuar llojit të mbeturinave të gjeneruara kërkon angazhim të të gjithë akterëve në proces me rëndësi të veçantë edhe inspektoriatin. Komuna në planet e saj parashih trajtimin e mbeturinave referuar rrymës që i përkasin, si dhe krijimin e qendrave të ndarjes në njësi komunale, duke i bashkërenduar me zhvillimin e fushatave të informimit për qytetarë.

Deponimi i mbeturinave

Shërbimi i deponimit të mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë ofrohet nga kompania regjionale “Uniteti”, përmes deponisë rajonale të Mitrovicës, e cila gjendet në fshatin Gërmovë në distancë prej 20 km në njërin drejtim. Mungesa e aseteve transportuese adekuate dhe trafiku rrugor parashihen si problematikë gjatë bartjes dhe deponimit të mbeturinave në deponi. Kostoja e deponimit ngarkon tarifën prej 6 euro për çdo ton të mbeturinave komunale të deponuara, tarifë kjo sa gjysma e tarifës së aplikuar nga Kompania për Menagjimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK). Mungesa e aktiviteteve të riciklimit e cila synon reduktimin e sasisë dhe volumit, si rrjedhojë reduktimin e kostove të transportit, adreson kërkesën e ngarkesës shtesë me kosto financiare referuar koston së transportit, amortizimit të pajisjeve dhe eficiencës në kohë.




Figure: Deponia në Gërmovë, Mitrovicë

Mjetet për ofrimin e shërbimit sipas të dhënave do të përmblihen në kontejnerë për grumbullim.

Të dhënat paraqesin se Komuna e Vushtrrisë ka të shpërndarë në territorin e saj kontejnerë sipas shërbimit derë më derë 8200 shporta 120l apo nëpër pika të përbashkëta grumbullimi, 220 kontejnerë 1.1 m³. E gjithë kjo infrastrukturë është në pronësi të komunës dhe në shfrytëzim të kompanisë regjionale.

Në tabelën më poshtë jepet lloji dhe numri i konteinerëve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë:

Table: Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

NR.	LLOJI I KONTEJNERËVE	KAPACITETI	NR. KONTEJNERËVE 2020	VITI I FILLIMIT TË PËRDORIMIT	GJENDJA E TYRE
1	Plastik	240 litra	1350	2017-2019	E mirë
2	Plastik	120 litra	8200	2016-2019	E mirë
3	Plastik	1.1 m ³	203	2018	E mirë
4	Metalik	1.1m ³	60	2018	E mirë
5	Metalik (arkë)	7m ³	7	/	

Nevojat dhe prioritetet

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e komunës ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, i cili është prioriteti kryesor i Komunës Vushtrrisë nga pikëpamja ekonomike si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Nevojat të cilat duhen marrë parasysh në zbatimin e planit lokal për veprim në mjedis në harmoni dhe me planin komunal për menaxhim të mbeturinave të komunës janë renditur si me poshtë:

- Rehabilitimi i zonave me ndotje prej deponive ilegale dhe revitalizimi i tyre, duke i kthyer në zona të gjelbra me vlerë rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Inventarizimi dhe diagnostikimi i venddepozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- Aprovimi i një buxheti të mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave referuar planeve dhe objektivave;
- Hartimi i programeve për ndarje në burim të mbeturinave;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë për të financuar infrastrukturën e nevojshme;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave, zbatimi i sanksioneve dhe monitorimi i shërbimit në përgjithësi.

Sipas qëllimeve të vendosura në planin për menaxhim të mbeturinave komunale, objektivat primare në menaxhim të mbeturinave komunale janë fokusuar në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës komunale për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurtë të mbeturinave komunale, si dhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Kjo do të përfshijë zbatimin e skemave për shtrirjen e shërbimit bazik në nivel të komplet territorit dhe popullsisë së shërbyer dhe aktivitete tjera që rrisin performacën për ofrimin e shërbimeve bazike, zbatimin e programeve të minimizimit të mbeturinave, përfshirë ndarjen në burim për riciklim dhe kompostimin për të reduktuar në mënyrë progresive sasinë e mbeturinave për deponim final në deponi (2022-2026), si dhe trajtimin adekuat të mbeturinave me qëllim zvogëlimin e rrezikut që shkaktojnë në mjedis. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara prej Komunës së Vushtrrisë në planin komunal për menaxhim të mbeturinave 2016-2020, duke analizuar objektivat e vendosura dhe duke analizuar gjendjen ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Krahas saj, vlerësimi i gjendjes ekzistuese të sektorit rishikojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në plan dhe nevojën për plotësime shtesë apo rishikimin e tyre.

Për sa i përket vendosjes së objektivave të Planit Lokal për Veprim në Mjedis të harmonizuara me PKMM 2022-2026, në mënyrë të përmbledhur ato në disa qëllime konsistojnë apo synojnë që:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brenda territorit të komunës.

3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final, si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës, duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Objektivi kryesor i planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Në harmoni me këto politika, Komuna e Vushtrrise do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim, si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (zvogëlim – ripërdorim - riciklim), pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave;
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi i sistemit aktual, zgjerimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzaminimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për deponimin e mbeturinave);
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit;
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave.

Vlersimi i gjendjes mjedisore

AJRI

VLERËSIME TË PËRGJITHËSHME PËR GJENDJEN E AJRIT

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Disa ndotës mund të kenë ndikime globale - p.sh. rritja e efektit të gazeve serrë ose dëmtimi i shtresës së ozonit. Çdo burim i ndotjes është kontribues në territorin ku shfaqet, por ndotja e ajrit gjithnjë e më shumë po merr përmasa globale.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë sektori i transportit, i cili mbetet një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban. Kjo lidhet me numrin e madh të automjeteve që nuk plotësojnë standartet e shkarkimeve në ajër, cilësia e lëndës djegëse që përdorin, viti i prodhimit të tyre, si dhe përdorimi i automjeteve me motor pa konvertor katalitik duke favorizuar rritjen e përmbajtjes së pluhurit si dhe shkarkimet e gazta gjatë djegies së karburantit. Gjithashtu mungesa e sipërfaqeve të gjelbra dhe zbatimi pa kriter i ndërtimeve kanë ndikimin e tyre në ndotjen e cilësisë së ajrit sidomos në shtimin e sasisë së pluhurave.

Vushtrria shtrihet në mes të bjeshkëve të Shalës dhe Çyqavicës, të cilat kanë lartësi mbidetare 900 – 1380 m, si dhe rrafshit të Kosovës, duke filluar nga Kastrioti e deri në Mitrovicë, me lartësi mbidetare mesatare 550 m.

Si burime të ndotjes së ajrit përveç KEK-u, Trepçës, djegies për ngrohje dhe industrive dhe ekonomive familjare, si burim mjaft i theksuar është edhe ndotja nga komunikacioni. Ajri konsiderohet i ndotur, kur në të gjinden substanca tjera përveç përbërave të ajrit. Sot, në kohën bashkohore nuk mund të flitet për ajër të pastër.

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë:

1. burimet natyrore dhe
2. burimet artificiale.
 - Burimet natyrore të ndotjes së ajrit janë erupsionet vullkanike, djegia e pyjeve, stuhitë etj.
 - Burimet artificiale të ndotjes në atmosferën janë:
 - a) Xehetaria dhe Metalurgjia

- b) Industria kimike, tekstilit, ushqimit, gomës, letrës, ndërtimtarisë, bujqësisë etj.
- c) Komunikacioni etj.

Pra si ndotës të ajrit në Komunën tone janë: Trepça që reflektohet përmes emisionit të Pb, SO₂, CO₂, CO, bloza, sulfidi i plumbit, arseni, oksidi i azotit, floriri i hidrogjenit etj.

Si ndotës tjetër i madh është edhe KEK-u i cili përmes emisioneve të SO₂, H₂SO₄, flori, fenolit, NH₃ etj.

Në mungesë të matjeve apo të të dhënave, për Komunën e Vushtrrisë është bërë vetëm zonimi i ndikimit të ndotësve të ajrit. „KEK”-u ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ajrit në rajonin jugor të Komunës së Vushtrrisë. Vendbanimet e prekura nga ndotja e ajrit nga termocentralet janë: Zhilivoda, Bivolaku, Prelluzha, Stanofci i Poshtëm dhe i Epërm, Graca dhe një pjesë e Strocit.

Në mënyrë indirekte, e sidomos gjatë lëvizjes së erërave jugore, ndotja e mjedisit përshin edhe Strocin, Gllavotinin, Mihaliqin, Lumëmadhin, Dumnicën e Poshtme dhe Beçukun, që ndikon negativisht në shëndetin e popullsisë në ato lokalitete.

Një rol të konsiderueshëm në ndotjen e ajrit luajnë edhe gurëthyesit e ndryshëm në Pasomë, Tërllabuq dhe Shalë. Këtu mund të llogaritet edhe fabrika e llamarinës “Llamkos” (nëse rifunksionalizohet së shpejti), si dhe numri i madh i automjeteve.

Me rritjen e transportit automobilistik sipas tendencës së deritanishme edhe përmbajtja e NO₂ mund të arrijë vlerën kufi të lejuar brenda një harku kohor 3-5 vjet. Pa ndërprerë këtë tendencë rritëse të transportit automobilistik, një ndërhyrje efektive në planifikimin urban të qyteteve respektive, ku të merret parasysh optimizimi i trafikut, përdorimi i mjeteve alternative të transportit rrugor, kontrolli teknik i automjeteve sipas standarteve të BE si dhe rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara do të ndikonte pozitivisht në reduktimin e ndotjes potenciale mjedisore prej gazeve e tymrave të çliruar nga automjetet.

Si ndotës tjetër është edhe ndotja urbane nga makinat e shumta të cilat janë të vjetruara dhe janë pa katalizator.

Për të evituar dhe zvogëluar një ndotje të tillë të ajrit duhet të merren edhe disa masa themelore.

- a) Shpikja e teknologjive të reja tekniko – teknologjike
- b) Aplikimi i sistemeve të ndryshme teknologjike
- c) Ngritja e objekteve industriale sa më larg vendbanimeve të mëdha.
- d) Aplikimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit

Këto masa për mbrojtjen e ajrit nga ndotjet mund të karakterizohen në dy grupe të mëdha:

1. Masat higjienike - sanitare
2. Masat tekniko – teknologjike.

Këto masa kanë për qëllim zvogëlimin e shkallës së ndotjes në nivel normal.

Në kategorinë e pare rol të rëndësishëm luajnë sipërfaqet e gjelbëruara ku bëjnë pjesë parqet, kopshtet, shkurret, drunjtë e bulevardeve. Ato ngritën për shkaqe sanitare – higjienike dhe estetike, të cilat kryejnë funksionin e mbrojtjes së shoqërisë edhe nga zhurma, e cila drejtpërsëdrejti ndikon në sistemin nervor. Me zhurmë nënkuptohet çdo zë i pa dëshirueshëm, andaj është me rëndësi të veçantë mbrojtja e mjedisit.

Drunjtë, shkurret, barërat mënjanojnë fundërrinat prej ajrit të ndotur (duke i lidhur për vete), absorbojnë karbonin i cili është në përbërje të dyoksidit të karbonit dhe lirojnë oksigjenin gjatë procesit të fotosintezës. Në to sedimentohen edhe grimca të pluhurit ,dioksidi i sulfurit etj.

2. Masat tekniko – teknologjike.- për mbrojtjen e ambientit nga ndotja realizohen nëpërmjet të një numri të madh të masave siqë është: reciklazha, të rralluarit, spastrimi me aparate të ndryshme etj.

Këto aparate janë:

1. Aparatet e spastrimit të lagshtë siqë janë: shkumorët dhe shpërlarësit,
2. Aparatet e filtrimit,
3. Aparatet elektrike të fundërrimit (jonizimi i grimcave të imëta) etj.

Monitorimi i cilësisë së ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit realizohet nga këto institucione: IHMK, IKSHP, dhe nga disa operatorë ekonomik (ndotës) siqë janë: KEK-u, dhe Feronikeli.

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë ende është i mangët edhe pse ka përparime në kompletimin e rrjetit, pasi që ka filluar plotësimi i stacioneve automatike për monitorimin e cilësisë së ajrit nëpër disa qytete të Kosovës.

Monitorimi i cilësisë se ajrit nga IHMK

Gjatë vitit 2020, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës – IHMK mori mbështetje nga Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës – MFK (financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit-MCC) për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të komunikimit që ofron të dhëna për cilësinë e ajrit në kohë reale nëpërmjet këtij portali online.

Shërbimi i Parashikimit në Kosovë

Matja e të dhënave të cilësisë së ajrit, pavarësisht saktësisë, mund të ofrojë informacione vetëm në lokacionin e një stacioni të veçantë të monitorimit të cilësisë së ajrit. Për të ofruar vlerësime të sakta të cilësisë së ajrit dhe parashikime të cilësisë së ajrit për tërë Kosovën është krijuar një model matematikor, i cili përdoret për gjenerimin e parashikimeve 3-ditore në dispozicion në PCA. Modeli shfrytëzon parashikimin e motit dhe modelet e shpërndarjes së ndotjes së ajrit në atmosferë në bazë të numrit të zvogëluar të 4 ndotësve: PM10, PM2.5, dioksidi i azotit (NO2) dhe ozoni (O3).

Qasja në parashikime është e mundur nëpërmjet menysë rënëse “të dhënat e parashikimit” në PCA dhe janë në dispozicion në dy nivele – për tërë Kosovën (rrjeti 1

km për vendin dhe 0,5 km në qytete) dhe për Prishtinën me modelim më të detajuar dhe harta me rezolucion më të lartë (200 m në qytet dhe 50 m përgjatë rrugëve kryesore).

Parashikimet përdoren për t'i parashikuar përqendrimet e ndotësve, nivelin e ICA dhe efektet e mundshme shëndetësore. Prandaj, lejojnë planifikimin e aktiviteteve në një mënyrë që zvogëlon ekspozimin ndaj niveleve të larta të ndotjes.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për veprimtarin hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, IHMK është e obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës.

Nga fundi i vitit 2009 ka filluar së funksionuari stacioni i parë i monitorimit automatik të cilësisë së ajrit i vendosur në Prishtinë-IHMK.

Gjatë vitit 2010 Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit i MMPH dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, bazuar në kriteret e Direktivës 2008/50/EC, kanë bërë studimin preliminarë për përcaktimin e pikave monitorues.

Në studimin e lartpërmendur është bërë edhe zonimi, kështu që Kosova do të ketë një aglomerat (Prishtinën) dhe pjesa tjetër e vendit do të formojnë një zonë.

Numri i stacioneve është caktuar në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Udhëzimi administrativ për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese numrin dhe shpeshësinë e matjeve, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave, Nr.15/2010. Bazuar në këtë udhëzim është vendosë që rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë të ketë 9 stacione të monitorimit automatik dhe 1 stacion monitorues mobil.

Stacioni i parë i monitorimit automatik i cilësisë së ajrit është vendosur në lokacionin e IHMK (Harta 1.). Koordinatat gjeografike të lokacionit janë 42°38'56.03"/ 21° 8'13.00". Ky stacion është i pajisur me analizerët automatik të dioksidit të sulfurit (SO₂), oksideve të azotit (NO_x), monoksidit të karbonit (CO), ozonit (O₃), monitori i grimcave të suspenduara PM₁₀/PM_{2.5} si dhe me sensorët e parametrave meteorologjik.



Stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit në oborrin e IHMK-së

Konkluzionet

Bazuar në të dhënat e disponueshme për cilësinë e ajrit, të dhënat për emisione dhe të dhënave tjera statistikore, mundë të vlerësohet se ajri në Kosovë ka cilësi jo të kënaqshme. Problem parësorë i ndotjes së ajrit në Kosovë është ndotja me grimcat PM10, duke mos i abstrahuar edhe ndotësit tjerë të cilët atakojnë shëndetin e njeriut, vegjetacionit, botën bimore, botën shtazore dhe rrezikojnë materialet. Institucionet e Kosovës në periudhën e pasluftës brenda mandatit dhe mundësive kanë bërë përpjekje në ndërmarrjen e masave adekuate për zvoglimin e ndikimit të burimeve ndotëse në ajër dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Megjithkëtë nevojitet angazhim edhe më i madh në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në sektorin a ajrit.

Bazuar në këtë mundë të konkludohet se:

- Baza legjislative për ajrin është në kompletim e sipër dhe është në masë të madhe e harmonizuar dhe e transponuar me direktivat e BE-së,
- Është hartuar Strategjia për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe Plani I Veprimit për përmirësimin e cilësinë e ajrit dhe gjatë këtij viti pritet miratimi i tyre nga Kuvendi i Kosovës,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë në saje të ndihmës së ofruar nga Komisioni Evropian dhe donatorët e tjerë është në fazën e kompletimit dhe funksionalizimit të sistemit për monitorimit e cilësisë së ajrit,
- Është e nevojshme që sistemi i monitorimit të ajrit të plotësohet edhe nga institucionet tjera monitoruese dhe nga operatorët ekonomik dhe po ashtu nevojitet të shtohet numri i parametrave të matur të rëndësishëm për vlerësimin e gjendjes së ajrit,

- Ende nuk vërehen angazhime serioze nga operatorët ekonomik me ndikim në mjedis që të instalojnë sisteme vetanake kontinuale të monitorimit të emisioneve, megjithëse sistemi ekzistues i monitorimit, mundëson një vlerësim modest për emetimin e emisioneve në ajër nga operatorët ekonomik,
- Edhe pse ka filluar inventarizimi i gazrave serë ende mungon sistemi kombëtar për monitorimin dhe raportimin e gazrave serë,
 - Mungon gjithashtu edhe sistemi për monitorimin e zhurmës dhe sistemi për monitorimin e radioaktivitetit.
- Ka filluar bashkëpunimi me institucionet mjedisore ndërkombëtare dhe ato të BE-së e veçanërisht me Agjencionin Evropian të Mjedisit.

Rekomandimet

Në bazë të gjendjes së prezantuar në këtë raport, duke u bazuar në gjetjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara dhe me qëllim të përmirësimit të gjendjes rekomandohet:

- Përshtatja dhe transpozimi i plotë i legjislaturës për ajrin në harmoni me legjislaturën e Bashkimit Evropian, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe organizatave tjera ndërkombëtare,
- Hartimi i akteve ligjore e nënligjore për ajrin, ndryshimet klimatike, ozonin, zhurmën, radioaktivitetin dhe fenomene tjera që ndikojnë në ndotjen e ajrit;
- Implementimi i Strategjisë për Mbrojtje e Ajrit nga Ndotja, Planit të Veprimit, Programit Nacional dhe projekteve specifike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit,
- Kompletimi dhe funksionalizimi i plotë i sistemit nacional për monitorimit e cilësisë së ajrit, sistemeve monitoruese vetanake nga operatorët ekonomik dhe të shtohet numri i parametrave të matur të rëndësishëm për vlerësimin e gjendjes së ajrit,
- Ngritja e sistemit kombëtar për monitorimin dhe raportimin e gazit serë, si dhe sistemit për monitorimin e zhurmës dhe sistemit për monitorimin e radioaktivitetit,
- Fuqizimi i inspektoratit në nivel qendror dhe në nivel lokal në mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e zbatimit të obligimeve ligjore dhe masave që kërkohen për mbrojtjen e ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së tij,
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale dhe shtimi i personelit për mirëmbajtjen e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, servisimin dhe kalibrimin e pasijeve.
- Ngritjen e kapaciteteve për modelim të shpërndarjes së ndotjes, hartimin e studimeve dhe analizave për gjendjen e ajrit,
- Thellimi i bashkëpunimit në mes të institucioneve monitoruese dhe operatorëve e sidomos në procesin e rrjedhjes së informatave, përpunimit, raportimit të tyre dhe informimit më efikas të publikut për kualitetin e ajrit.
- Përgaditja për Ratifikimin e Konventave dhe Protokolleve Ndërkombëtare për ajrin, ndryshimet klimatike dhe ozonin,

- Çertifikimi dhe akreditimi i laboratorëve, pajisjet dhe personelit që bënë menaxhimin e rrjetit dhe paisjeve për monitorimin e cilësisë së ajrit;
- Vazhdimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe informative me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe me institucionet tjera ndërkombëtare për cilësinë e ajrit, ndryshimet klimatike, hollimin e shtresës së ozonit, zhurmës e radioaktivitetit.

UJI

Hidrologjia e zonës dallohet nga zhvillime të larta të rrjetit hidrografik, që në tërësi i takojnë ujëmbledhësit të Detit të Zi. Nëpër territorin e komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica me disa degë të saj dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme e lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë (4314 km²), Silnica është lumi me sipërfaqe më të madhe ujëmbledhëse në Kosovë prej 2912 km².

Territori i komunës së Vushtrrisë merr pjesë me 345 km² ose afër 12% të sipërfaqes së tërësishme të ujëmbledhësit të nivelit me prurjeve ujore të lumit Silnica dhe shërben si pikë kryesore hidrometrike për këtë ujëmbledhës lumor. Në sektorin e rrjedhjes nëpër territorin e Vushtrrisë, ky lum nga ana e djathtë merr këto degë kryesore: Llapin, Lumkuqin, Tërstenën, Banjën e Gjytezës, ndërsa nga ana e majtë, Silnica merr vetëm disa përrenj dhe përrocka periodike, të cilat formohen në shpatet lindore të Qyqavicës. Nëpër komunën e Vushtrrisë kalojnë edhe dy lumenj më të vegjël: Tërstena dhe Studimja.

Nga aspekti hidrogeologjik, terreni i komunës së Vushtrrisë cilësohet me veti të dobëta filtruese, me mungesë të horizontit ujëmbajtës me përmasa të rëndësishme eksploatabile dhe ujëdhënie të vogël. Në komunën e Vushtrrisë janë disa lumenj që kanë rrjedhë të përhershme e disa rrjedhin vetëm kur ka të reshura. Këta lumenj janë: Silnica, Llapi, Brezhnica, Lumkuqi, Studimja, Terstena, Bajaska

Me ndotje të ujit të pastër natyror nënkuptojmë çdo shmangie kualitative apo kuantitative e përbërjes dhe cilësive të tij natyrore kimike, fizike dhe biologjike, të cilat kanë pasoja të padëshirueshme për shëndetin e njeriut, ekonomin e tij dhe ekosistemin në përgjithësi. Vushtrria ka rezerva të vogla të ujit.

Qasje në ujësjellës kanë 70-75% të popullatës kryesisht qyteti dhe fshatrat e përfaqëta. Ndotja e ujit është një problem jetik për jetën kur kihet parasysh rëndësia themelore e përdorimit të tij.

Derdhja e ujërave të zeza është një ndër faktorët kryesor për ndotjen e ujit të pijes dhe të ujitjes që po sjellin pasoja të mëdha shëndetësore të njerëzit dhe te bujqësia në tërësi. Në mungesë të një plani urbanistik, familje të tëra ujërat e ndotura i derdhen në kanalet e ujitjes, që pastaj reflektohen me sëmundje të shumta të bimëve, që pastaj direkt reflektohen edhe në shëndetin e njeriut. Po ashtu ndotja e ujit për ujitje ndikon më të madhe edhe në shëndetin e kafshëve të cilat atë ujë e konsumojnë për pije.

Gropat septike, që kanë nisur të aplikohen si rezervuare të ujërave të zeza, nga familjet rurale, bëhen jashtë standardeve të parapara, prandaj paraqesin burim infeksionesh nga më të ndryshmet.

Malet tona dita ditës po shkatërrohen pa mëshirë nga të pandërgjegjshmit e që në një të afërme nuk do të ekzistojnë fare. Për këtë ekziston edhe rreziku nga erozioni.

Lumenjtë “Sitnica” dhe “Terstena” janë lumenj që e begatojnë qytetin tone, por që sot fatkeqësisht janë lumenjtë të vdekur nga ndotja tejmase që i shkaktohen kryesisht nga KEK-u dhe nga ujërat e zeza, si dhe nga mbeturinat e ekonomive familjare.

Në komunën e Vushtrrisë janë disa lumenj që kanë rrjedhë të përhershme e disa rrjedhin vetëm kur ka të reshura. Këta lumenj janë:

- Silnica
- Llapi
- Brezhnica
- Lumkuqi
- Studimja
- Terstena
- Bajaska
- Smrekonica

Të gjithë këta lumenj burimin e kanë në bjeshkët e shalës me përjashtim të lumit Llap I cili rrjedhë nga bjeshkët e Llapit si dhe lumi Silnica cili rrjedhën e ka nga Rrafshi i Kosovës dhe bjeshkët e Çyqavicës. të gjithë këta lumenj përveç Sitnicës rrjedhin nga ana e djathtë e maxhistralës Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë dhe Lumit Silnica kurse nga ana e majtë shtrihen bjeshkët e Çyqavicës që nuk ka lumenj që kanë rrjedhe të përhershme por janë të varur prej kushteve atmosferike kryesisht prroe dhe procka të ndryshme.

Andaj duke u nisur nga këto fakte e shohim të rrugës që të ndërmarrim diçka për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe largimin e sëmundjeve, çka do të thotë mbrojtjen e shëndetit tonë dhe të fëmijëve tanë.

Duke i analizuar këto probleme e shohim të udhës që ti mbrojm këta lumenjëme qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve që ta mbrojnë mjedisin e tyre, ta ruajnë shëndetin e tyre, dhe të kenë një kujdes më të madh ndaj tretjeve dhe derdhjes së ujërave të ndotura, si dhe të mbrojtjes së lumit nga mbeturinat e amvisnive shtëpiake dhe të mjeteve hazarde.

Territori i komunës së Vushtrrisë ka një rrjet të zhvilluar hidrografik, i cili në tërësi i takon ujëmbledhësit të Detit të Zi (Sitnicë, Ibër).Nëpër territorin e komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica me disa degë të saj dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë (4314 km²), Sitnica është lumi me sipërfaqe më të madhe ujëmbledhëse në Kosovë prej 2912 km².

Territori i komunës së Vushtrrisë merr pjesë me 345 km² ose afër 12% të sipërfaqes së tërësishme të ujëmbledhësit të nivelit me prurjeve ujore të lumit Silnica dhe shërben si

pikë kryesore hidrometrike për këtë ujëmbledhës lumor. Në sektorin e rrjedhjes nëpër territorin e Vushtrrisë, ky lum nga ana e djathtë merr këto degë kryesore: Llapin, Lumkuqin, Tërstenën, Banjën e Gjytezës, ndërsa nga ana e majtë, Silnica merre vetëm disa përrenjë dhe përrocka periodike, të cilat formohen në shpatet lindore të Qyqavicës. Nëpër komunën e Vushtrrisë kalojnë edhe dy lumenjmë të vegjël: Tërstena dhe Studimja.



Lumi Silnica

Dikur lumi Sitnica shfrytëzohej për piknik, rekreacion dhe freskim, si dhe ishte shumë atrktiv për peshkim, kurse sot ky lumë, nga pasojat e ndotjes së madhe të shtratit të tij, i ngjan një prroske, e cila lind pas vërshimeve. Lumi Sitnica është i gjatë 108.8 Km., kurse si burime kryesore dhe të përditshme të ndotjes të këtij lumi janë derdhjet e pa kontrolluara të ujrave industriale (të KEK-ut dhe të uzinave të tjera), si dhe derdhja e ujrave të kanalizimeve nga fshatrat dhe qytetet që shtrihen përgjat lumit Sitnica. Derdhja e ujrave të përdorura nga KEK-u në lumin Sitnica e kanë ndotur dukshëm këtë lum. Ujrat e ndotura të KEK-ut për mbajnë ndotës inorganik dhe organik. Në bazë të analizave është vertetur se në lumin Sitnica ka sasi të konsiderueshme të joneve të bakrit, plumbit, zingut, kadmijumit, të cilat vijnë kryesisht nga uzinat për flotacion e xeheve në Kishnicë dhe Ajvali. Pas përqendrimit të joneve, rreziku vie edhe nga prezenca e fenoleve, të cilat mundë të depertojnë edhe deri te uji I puseve, I cili përdoret për pije dhe amvisri.

Fenolet për nga përbërja kimike janë komponime kimike aromatike të benzenit, të cilat kanë veprim toksik kancerogjen, të cilat shkaktojnë kancerin.

Në vitin 2004 nga bugjeti Komunal I Vushtrrisë janë bërë analizat e ujit të puseve në të gjitha fshatrat afër lumit Sitnica dhe nga këto analiza të kryera nga Instituti Kombëtar Shëndetësor I Kosovës del se uji nga këto puse është i pa përdorshëm për pije, andaj preferohet që popullata, e cilajeton rrethë këtij lumi të njoftohet me rrezikun permanent që I kanë nga këta ndotës, andaj për t'u shmangur një rreziku preferohen banorët e lokaliteteve afër lumit që sa më shpesh të bëjnë kontrollimin e kualitetit të ujit në Institutin Kombëtar Shëndetësor në Prishtinë dhe të këshillohen për përdorimin e ujit të

pijes nga puset, në të kundërten do të ballafaqohen me helmime të ndryshme, të cilat mundë të përcillen me pasoja të rënda.

Andaj për tju kthyer funksionaliteti këtij lumi për piknik, freskim dhe peshkim duhet që të rregullohet diga e cila është mjaft e dëmtuar, si dhe të ndertohej një impant ku do të trajtohen të gjitha ujrato e zeza dhe ndotësit tjer që e ndotin mjaft këtë lum.

Vlenë të theksohet se afër lumit Sitnica është rregulluar një shetitore në gjatësi prej 3.2 Km., e cila ka për qëllim që qytetarët e Komunës të shfytëzojnë këtë hapësirë për shetitje dhe argëtim.

Po ashtu për mbrojtjen e lumit Sitnica dhe ndotjes së tij është eliminuar deponia ilegale e mbeturinave, dhe në hapësirën e kësaj deponie është rregulluar një mini parkë.

Lumi Terstena

Lumi Terstena është lumë i shpejt dhe shume i rrezikshëm, buron në malet e Terstenës dhe të Skromes si dhe kalon në për këto vendbanime: Lajthizë, Karaqë, Gojbulë, Begaj e Vushtrri ku derdhet në lumin Sitnica.

Lumi Terstena buron në masivin malor në verilindje të Vushtrrisë, në lartësin mbidetare prej 1364 m. Është ujëmbledhës i një sipërfaqeje prej 42 m², mirpo nga reshjet atmosferike del nga shtrati në pjesët e poshtme të qytetit dhe i verson pothuajse të gjitha shtëpit në të dyanët e lumit.

Me qëllim të mbrojtjes nga vershimet, në lumin Terstena janë bërë investime parciales por të pa mjaftushme për pengimin e dameve.

Në vitin 1990, pas studimeve të kushteve topografike, përbërjes gjeologjike të terrenit analizës së bazave hidrologjike u propozuan zgjidhjet teknike për mbrojtjen e qytetit nga vershimet e lumit Terstena si dhe u hartua **Projekti Kryesor i Rregullimit të Lumit Terstena** në pjesën që kalon nëpër qytet në gjatësi prej 1719 m. projektin e hartoi Enti për Hidroekonomi në Prishtinë, në prill të vitit 1990. Me këtë projekt është parapar rregullimi I kanalit të hapur të lumit në gjatësi prej 1719 m., gjërsi 6 m.

Menaxhimi i ujërave

Menaxhimi i ujërave përmban aktivitete të shumta, vendime dhe masa, qëllimi i të cilave është mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi i kualitetit të tij. Menaxhimi i mirë i ujërave të Kosovës duhet të jetë në listën e prioriteteve për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është e paraparë edhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Menaxhimi i mirëfilltë i resurseve ujore mbështetet në disa parime themelore:

- Uji është burim i pa zëvendësueshëm i jetës në tokë, dhe është obligim i çdo qytetari për ruajtjen e këtyre resurseve.

- Me ujëra duhet të menaxhohet sipas standardeve evropiane dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm, ku do të ketë të drejt të kenë qasje të gjithë sipas parimeve të OBSH.
- Kufijtë administrativo-territorial të komunes nuk mund të jenë pengesë për qeverisje integrale të ujërave.
- Njësitë për menaxhimin me ujëra janë rajonet dhe pellgjet ujore si tërësi hidrografike dhe ekonomike.
- Për shfrytëzimin e ujërave përtej kufijve të lejuar si dhe kufijtë administrativo-territorial të njërive nuk mund të jenë pengesë për qeverisje integrale të ujërave.
- Për shfrytëzimin e ujërave përtej kufijve të lejuar si dhe për çdo keqësim të cilësisë së ujit duhet paraparë kompensimi i cili do të jetë proporcional me leverdi respektivisht duhet të varet nga shkalla e ndikimit në ndërrimin e gjendjes së ujërave.

Ndotja e Ujërave

Sasia e ujit që përdoret në industri në të shumtën e rasteve kthehet prap në rrjedhat ujore me ndryshime në aspektin e cilësisë.

Detergjentet si mjete efikase në mbajtjen e higjienës kanë gjetur përdorim të madh në amvisëri. Ato llogariten në mesin e ndotesve me ndikim në mjedis, si ndotës biologjikisht jo të zbërthueshëm të cilat kontribuojnë në procesin e eutrofikimit të ujit.

Edhe përdorimi i karburanteve dhe vajrave të përdorura nga makineria me djegie të brendshme, që në mënyrë direkt apo indirekte arrijnë deri të burimet e ujit paraqesin një burim potencial të ndotjes së ujërave.

Eutrofikimi i ujërave

Eutrofikimi është një indikator i shtimit të materieve ushqyese që ka pasojë rritjen e numrit të algave dhe bimëve të larta në ujëra, si pasojë e rritjes së materieve ushqyese, duke shkaktuar dëmtimin e cilësisë së ujit dhe prishjen e baraspeshes ekologjike në këto ekosisteme ujore. Ujërat në kushte natyrore, të pa ndotura, kanë përmbajtje relativisht të ulët të azotit dhe fosforit, dhe kjo gjëndje e ujërave njihet si gjëndje “oligotrofike”. Kur ujërat e shkarkuara përmbajnë lëndë me origjinë antropogjene të pasur me azot dhe fosfor krijohet mundësia e rritjes së algave dhe humbja e kthjelltësisë së ujit. Një gjëndje e tillë e ujërave njihet si gjëndje “eutrofike”.

Gjendja eutrofike e ujërave ka pasojë të mëdha për organizmat ujorë, sepse kjo shoqërohet me zvogëlimin e përqendrimit të oksigjenit të tretur në ujë.

Për gjendjen e eutrofikimit të ujërave në lumenjtë e komunës së Vushtrris, nuk ka të dhëna, për shkak të mungesës së monitorimit të shkarkimit të ujërave të ndotura në lumenj. Mirepo vlerësohet se ujërat e përdorura industriale dhe urbane që shkarkohen direkt në rrjedhat e lumenjve pa trajtim paraprak ndikojnë në eutrofikimin e ujërave rrjedhese.

Sitnica deri në derdhje të Graçankës ka karakteristikat e klasës së II ndërsa pas pranimit të ujërave të zeza të qytetit të Prishtinës e më pas ujërave shkarkuese të KEK-ut kalon në klasën e III dhe të IV varësisht prej derdhjeve në lumë, ndërsa Ibri nga prurjet e lumit Sitnicë për shkak të punës së hidrocentralit dhe derdhjeve artificialisht të baraspeshuara në rezervuarin e Gazivodës mbetet në klasën e II.

TOKA

Ndikimet e vazhdueshme nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

Toka është komponent kryesor e biosferës në të cilën rritet dhe zhvillohet bota bimore dhe shtazore e me këtë kuptohet edhe prodhimtaria bujqësore.

Kur është fjala për ndotjen e tokës atëherë duhet të ceket se veprimtaria e gjithëmbarshme e njerëzimit po len gjurma të drejtpërdrejta dhe indirekte në këtë mes. Pikërisht çdo shfrytëzim i tokës për çfarëdo qëllimi bartë me veti mundësin e rrezikut dhe çdo sjellje jo racionale gjatë shfrytëzimit të saj kanë pasoja direkt dhe indirekte të degradimit.

Në realitet deri te ndotja e tokës vie nëpërmjet ndotjes së ujit, ajrit, përmes përdorimit të plehrave minerale dhe pesticideve, nga deponit ilegale të mbeturinave etj.

Një nder burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe fabrikat e shumta kimike ndikimi i të cilave vërehet në botën bimore dhe shtazore afër emetimit të tyre, prandaj mundë të ceket se toka ndotet në mënyra të ndryshme prej të cilave duhet veçuar:

Përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale pa të cilat nuk mundë të mendohet prodhimtaria bujqësore,

Ndotja e tokës me materie radioaktive,

Ndotja e tokës me metale toksike ku çdo ditë po bëhet më aktuale,

Ndotja e tokës me mikro organizma patogjen,

Ndotja e tokës me procese natyrore të erozionit si dhe me ndihmën e vetë njeriut me prerjen e pyjeve.

Fatkeqësisht në komunën tone egzistojn deponi të mëdha ilegale të mbeturinave si dhe kanale të hapura të fekaleve të cilat paraqiten si vatra të infektimit ku mundë të jenë edhe si vatra të paraqitjes së zjarrit, pluhurit etj. Për këtë arsye nevojitet një depo sanitare ku hidhen mbeturinat dhe pastaj mbulohen me një shtresë të dheut , ku kjo hapësirë pastaj mbillet me vegjetacion ku shëndrrohet në terrene rekreative.

Komuna e Vushtrrisë karakterizohet me një llojllojshmëri të tokave duke u bazuar në gjenezën e krijimit të tyre dhe karakteristikave pedologjike, fizike dhe kimike. Sipërfaqja tokësore e Komunës së Vushtrrisë është e përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Llojet e tokave që më së shpeshti i hasim në Vushtrri janë: humusore, toka aluviale dhe deluviale, toka shkëmbore, etj.

Faktorët kryesor që dëmtojnë cilësinë e tokave në Vushtrri janë:

- Vendbanimet (ndërtime të paplanifikuara);
- Industria (mbeturinat industriale, mbetjet bujqësore, guroret, ejt);
- Mbeturinat shtëpiake dhe deponitë;
- Shpyllzimi;

- Erozioni;
- Eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit;
- Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

Prerja dhe asgjësimi i pyjeve

Si problem ekologjik në komunën tone është prerja dhe asgjësimi i pyjeve.

Vushtrria si komunë në shtrirjen e saj territoriale ka dy komplekse ose masive pyjore, kompleksi pyjor(Sllakovc – Vesekovc që shtrihet në pjesën veri- lindore të kësaj komune në një sipërfaqe prej 4938,40 hektarë. Kompleksi tjetër në komunë është ai i Çyçavices që shtrihet në pjesën jug – perëndim të komunës së Vushtrrisë dhe që përfshinë një sipërfaqe prej 2 237 hektarë.

Deri sa kemi një larmi të përhapjes së bimëve në masivin pyjor të kësaj komune , në anën tjetër gjendja e këtyre pyjeve nuk është aspak e mire. Nga gjithsejtë 7174,50 hektarë sa është sipërfaqja disponuese me pyje në sektorin shtetëror, toka të mbuluara me pyje janë 5 278,10 ha, apo 73,50 % të kësaj sipërfaqe, ndërsa pjesa tjetër prej 1 896,40 ha, apo 26,50 % janë toka të pa mbuluara me pyje. Përveç kësaj edhe struktura e fondit pyjor ekzistues nuk është e mire, nga e gjithë sipërfaqja me pyje, kultura pyjore (halorë) janë 189,40 hektarë apo shprehur në përqindje 3.60 % të kësaj sipërfaqe, pyje të larta janë 296.00 ha apo 5.40 % të sipërfaqes, ndërsa pjesa më e madhe prej 4 792,70 ha apo 91.00 % të sipërfaqes së pyjeve janë pyje të ultë.

Në sektorin privat janë 5 987 ha sipërfaqe me pyje që përbëhen kryesisht nga pyje të ahut dhe dushqeve dhe që gjendja e tyre është më e mire se e atyre në sektorin shoqëror.

Duke pasur parasysh gjendjen e rendë në fushën e mbrojtjes së pyjeve që ka mbretëruar para dhe pas luftës , gjendja e pyllit tashmë është gati alarmante.

Aktivitetet që duhet të merren për kultivimin e pyjeve të larta dhe pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura janë:

- Zvogëlimi i shkallës së prerjes së pakontrolluar dhe të pa planifikuar të pyjeve.
- Pyllëzimi i pyjeve të asgjësuar dhe sipërfaqeve të zhveshura
- Rritje të nivelit dhe efikasitetit në kontrolle
- Përkujdesja më e madhe në ruajtjen e sipërfaqeve të po sa pyllëzuara
- Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara ha/në vit

BIODIVERSITETI

Flora dhe vegetacioni i territorit të Komunës së Vushtrrisë

Territori i komunës së Vushtrrisë zë një vend të rëndësishëm në Kosovë nga aspekti floristik dhe vegetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Vushtrrisë i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshinë viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regjionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër. Ky regjion i Vushtrrisë, prezentohet me dy province fitogjeografike të cilat janë Provinca Mezike:

1. **Provinca Mezike**, e cila përfshinë shpatet e Malit të Çyçavicës dhe Kopaonikut në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territory paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (*Quercus – Carpinetum Rud.*) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (*Fagetum montanum Rud.*), dhe
2. **Provinca Mezike**, brez më i ulët ku përfaqësohet me Aleancën Quercion frainetto Ht. 1954. Kjo province përfshinë pjesën më të madhe të territorit të K. K. të Vushtrrisë. Nëse e vështrojmë realisht kësaj province i takon:
 - e tërë sipërfaqja bujqësore, e cila dikur i ka takuar bashkësive pyjore të qarrit e që më vonë në vazhdimësi është shëndrruar në sippërfaqe bujqësore, si dhe
 - sipërfaqet kodrinore të shpateve të Çyçavicës nga ana jugperëndimore dhe Kopaonikut nga ana veri – lindore.

Në bazë të kësaj që u përmend më lart, mund të konstatohet se në territorin e K. K. të Vushtrrisë janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezentuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike.

Në territorin e Vushtrrisë janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore:

- *Ass. Carpinetum orientalis scardicum, Krasniqi* (Bashkësia e shkozë së zezë),
- *Ass. Quercetum farnetto – cerris scardicum, Krasniqi* (Bashkësia e shpardhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m,
- *Ass. Quercetum montanum, Çer. et Jov.* (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (*Quercus petraea*),
- *Ass. Fagetum montanum Rud.* (Bashkësia e ahut), në pjesët e larta të degëve të Kopaonikut, ndërsa në Çyçavicë është degraduar në shkallë alarmante.

Në bazë të kësaj pasqyre floristike dhe vegetative të territorit të Vushtrrisë mund të konstatohet se:

- *Territori i K. K. të Vushtrrisë posedon florë dhe vegjetacion relativisht të mirë mirëpo në degradim e sipër si pasojë e veprimit negative të faktorit antropogjen (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe*
- *Në shumë lokalitete të territorit të K. K. Vushtrri do të ishte mirë të bëhen intervenime positive drejt normalizimit të gjendjes natyrore duke bërë pyllëzimin me llojet adekuate.*

Fauna në territorin e Vushtrrisë

Ato që e karakterizojnë faunën në territorin e Vushtrrisë janë ndryshimet e ndërlikuar dhe të mëdha të cilat me intenzitet të shtuar vazhduan për një kohë relativisht të gjatë me shndërrimin e hapësirës natyrore në territor agrikulturor, industrial, territor për banim etj. Si rezultat i këtyre veprimeve disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto terrene janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më pare nga këto terrene janë: dreri, dhia e egër, ariu, luqerbulli, gjelegri etj.

Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe të këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e K. K. të Vushtrrisë janë: ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Vulpis vulpis*), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), ketri (*Sciurus vulgaris*), sqarhi (*Martes foina*), vidra, lepuri (*Oryctolagus cuniculus*), disa lloje të brejtësve të vegjël, gjeraqina, skifteri i përhimtë, petriti (*Falco tinnunculus*), kukuvajka, huti (*Bubo bubo*), harabeli, thëllënza (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (*Dendrocopus major*), qyqja (*Cuculus canorus*), lauresha, borësi, rosat e egra (*Anser anser*), patat e egra (*Anas platyrhynchos*), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhimë, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (johelmues), picrraku (*Salamandra atra*), tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krapë (*Cyprinus caprio*), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurizorëve etj.

3. LISTA E OBJEKTEVE TË EVIDENCUARA GJATË REKOGNOSIMIT

Nr.	Vendi	Objekti	Komuna
1	Sllatinë	<i>Uji mineral</i>	Vushtrri
2	Bajskë	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
3	Bajskë	<i>Burimi i ujit termal 1</i>	Vushtrri
4	Bajskë	<i>Burimi i ujit termal (Qeshmja e zotnisë) 2</i>	Vushtrri
5	Karaçë	<i>Burimi i ujit natyral</i>	Vushtrri
6	Skromë	<i>Burimi i ujit natyral</i>	Vushtrri
7	Skromë	<i>Shpella</i>	Vushtrri
8	Vesekovcë	<i>Kompleksi i trungjeve të ahut (Fagus sp.)</i>	Vushtrri
9	Kurillovë	<i>Kompleksi i trungjeve të ahut (Fagus sp.)</i>	Vushtrri
10	Shtitaricë	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
11	Ashlan	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
12	Ceceli	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
13	Samadregjë	<i>Parku i ketrit</i>	Vushtrri
14	Dumnicë e Mesme	<i>Trungu i qarrit (Quercus cerris L.)</i>	Vushtrri
15	Dumnicë e Mesme	<i>Trungu i rrënjës (Quercus robur L.)</i>	Vushtrri
16	Taraxhë	<i>Ligatinat</i>	Vushtrri
17	Taraxhë	<i>Kompleksi i pishave</i>	Vushtrri
18	Galicë	<i>Kompl. i trungjeve të bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
19	Galicë	<i>Shpella</i>	Vushtrri
20	Dubovc	<i>Kompleksi i trungjeve të ndryshme</i>	Vushtrri
21	Brusnik	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
22	Brusnik	<i>Trungu i bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
23	Rreznik	<i>Trungjet e bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
24	Druar	<i>Trungjet e bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
25	Zhilibodë	<i>Trungjet e bungut (Quercus sp.)</i>	Vushtrri
26	Bivolak	<i>Ligatinat</i>	Vushtrri

Zhurma

Aktualisht në komunën e Vushtrrisë nuk realizohet monitorimi i nivelit të zhurmave. Niveli i zhurmave urbane (LAeq) është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjitha burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Degradim të mjedisit paraqet Gurëthyesi në fshatin Sumë (Pasomë). Kjo kompani punon pa asnjë kriter për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë detonimit të shkëmbinjve shtëpitë e banimit që jetojnë në atë rrethin janë të qara

Kapitulli IV

Identifikimi i problemeve mjedisore me prioritet

Çështjet mjedisore sipas mendimit të Grupit Punues të PLVM të harmonizuara me rezultatet e hulumtimit të opinionit publik për gjendjen mjedisore të Komunës së Vushtrrisë janë:

1. Menaxhimi i mbeturinave komunale;
2. Furnizimi me ujë të pijes dhe trajtimi i ujërave të zeza;
3. Ndotja e ajrit;
4. Toka dhe degradimi i tokës;
5. Zhurma;
6. Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit.

VLERËSIMI I PROBLEMEVE PRIORITARE

Vlerësimi i problemeve prioritare është bërë sipas kësaj metode:

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë fizike dhe njerëzor).	Shkalla e ndikimit E lartë E mesme dhe e Ultë	Popullsia që preket (Numri i banorëve ose përqindja e popullsisë së prekur).	Ndikimi (Paraqet ndikimin negative në: Mjedis, Shëndet, Mirëqenie).	Prioritarizimi (I matur me shkallën: * = Pak i rëndësishëm ** = Mesatarisht i rëndësishëm *** = Shumë i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme).
----------	-------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Menaxhimi i mbeturinave komunale

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
Mungon sistemi i përpunimit dhe riciklimi i mbeturinave komunale.	1. Mungesa e fondeve dhe interesimi jo i mjaftueshëm i sektorit privat.	E mesme	I tërë komuniteti.	Rritet volumi i mbeturinave që duhet deponuar.	**
Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për mbeturinat dhe ndarjen e tyre.	1. Niveli jo i mjaftueshëm i vetëdijes të komunitetit mbi sistemin e organizuar të menaxhimit të mbeturinave; 2. Edukimi mjedisor është i pamjaftueshëm për shumë arsye: mungesa e materialeve të shkruara, mungesa e aktiviteteve të përbashkëta.	E lartë	I tërë territori i Komunës, me rreth 71000 banorë.	Asgjësimi jo i duhur i mbeturinave nga qytetarët krijon erëra, dhe rrezik për shëndetin rreth zonës së kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit të mbeturinave. Përfshirje e ulët në sistemin e organizuar për trajtimin e mbeturinave.	** *

Furnizimi me ujë cilësorë të pijes dhe trajtimi i ujërave të zeza

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
Furnizim me ujë jo cilësor nga puset individuale.	Disa fshatra ende nuk kanë sistem të ujësjellësit.	E lartë	Disa fshatra të Komunës	Mungesa e ujit të pijshëm të kontrolluar çon në rritjen e të sëmurëve me sëmundje infektive.	***
Mungesa e sistemit të rrjetit të kanalizimit në vendbanimet rurale.	Mjetet financiare Mungesë e fondeve për studimin e fizibilitetit të kësaj fushe dhe ndërtime të këtyre rrjeteve.	E mesme	... banorë.	Rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit. Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë. Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore.	***
Sistemi i rrjetit të kanalizimeve është shumë i amortizuar dhe nuk është në gjendje të përballojë tendencat e reja të zhvillimit të qytetit.	Dëmtimi i kanaleve për shkak të ndërhyrjeve në të. Amortizimi i sistemit për shkak të moshës së tij. Shtimi i ndërtesave dhe i popullsisë.	E mesme	50 % e qytetit.	Rrezik epidemish nga dalja në sipërfaqe e ujërave të përdorura. Aromat që dalin nga pusetat janë helmuese për kalimtarët.	** *

Mungesa e një impianti të përpunimit të ujërave të zeza që shkarkohen në lumenjtë Sitnicë	Mungesë investimesh. Mungesë e fondeve për studime dhe investime. Mungesë bashkëpunimi ndërinstucional.	E lartë	- Gjithë Komuna dhe popullsia vendase.	Rritë nivelin e ndotjes së lumenjve. Shkakton ndotje të peizazhit dhe të burimeve natyrore.	* * *
-------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------	----------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------	-------

Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
Mungon strategjia për zhvillimin e bujqësisë në territorin e Komunës	Ka mungesë të kapaciteteve profesionale.	E lartë	I tërë komuniteti.	Zhvillim i pakontrolluar në sektorin e bujqësisë.	***
Humbja dhe degradimi i tokës bujqësore.	Ndërtimet në tokat bujqësore me bonitet të lartë. Zgjerimi i mihjeve sipërfaqësore të linjtit.	E lartë	60 % e popullsisë.	Humbje tokës bujqësore me bonitet të lartë.	***
Njohuri të pamjaftueshme të fermerëve për përdorimin e plehrave dhe pesticideve adekuate.	Mungesa e trajnimeve të nevojshme për përdorimin e drejtë të plehrave dhe pesticideve.	E mesme	I tërë komuniteti.	Ndotja e mjedisit-tokës bujqësore.	***
